

V

Dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd

ËRTETËSIA

Botim i Xhematit Mysliman Ahmadia të Shqipërisë

Viti II

Nr. 3

Tri pyetje rreth Zotit

Si është gjendja e sotme për besimin në Zot?
Nëse Zoti është, pse nuk duket?
Pse duhet ta kërkojmë Zotin?

>> f. 20

Katër attribute
themelore të Zotit

>> f. 7

Realiteti i lutjes

>> f. 12

Bekimet e Allahut mbi
Xhematin Ahmadia

>> f. 72

“Zoti është drita e qiejve dhe e tokës.”

Pse jetojmë
në këtë
botë?

f. 3



E ardhmja
e shoqërisë
perëndimore

f. 36



Duke
vendosur
paqe
ndërfetare

f. 42



Xhemati
Ahmadia
dhe ndihma
e tij në
Shkodër

f. 88



Humanity First

A sheh ndonjë të metë?



I Bekuar është Ai, në duart e të Cilit është gjithë mbretëria dhe Ai ka fuqi mbi çdo gjë.

Ai që krijoi vdekjen dhe jetën me qëllim që t'ju provojë se cili prej jush është më mirë në vepra, Ai është i Plotfuqishëm dhe Mëkatfalës.

Ai që ka krijuar shtatë qiej shtresë pas shtrese. Ti s'mund të shohësh asnjë të metë në krijimin e të Gjithëmëshirshmit, andaj, vështroje mirë e mirë! A sheh ndonjë të metë?

Vështro edhe një herë! Shikimi yt do të kthehet te ti, i hutuar dhe i lodhur.

(Kurani Famëlartë 67:1-5)

VËRTETËSIA

Botim i Xhematit Mysliman Ahmadia të Shqipërisë

Janar - Prill 2010 • Viti II • Nr. 3

"Erdhi e vërteta dhe u zhduk e pavërteta. Sigurisht, e pavërteta gjithnjë zhduket." (Kurani i Shenjtë 17:82)

PËRMBAJTJA



Pse jetojmë në këtë botë?

Editorial

3



Katër attribute themelore të Zotit

• Rrab, Rrahman, Rrahim dhe Malik Jeumiddin

• Komentimi i Kuranit Famëlartë

7



Nga poezia e Hazret Kalifit të Dytë të Mesihut të Premtuar r.a.

11



Rëndësia dhe realiteti i lutjes

• Nga ajetet e Kuranit të Shenjtë

• Hadithe të Profetit Muhammed s.a.v.s.

• Thënie dhe përvoja të Hazret Mesihut të Premtuar a.s.

12



Një lutje e përulur e Hazret Mesihut të Premtuar a.s. për të kërkuar faljen e mëkateve

19



Tri pyetje rreth Zotit

• Si është gjendja e sotme për besimin në Zot?

• Nëse Zoti ekziston, pse nuk duket?

• Pse duhet ta kërkojmë Zotin?

20



Dëgjoni Ajshtajnin

33



Fillimi i ezanit në Islam

34



E ardhmja e shoqërisë perëndimore

36



Xhamia e parë e Xhematit Mysliman Ahmadia në Berlin

41

• Ndërtuar vetëm nga sakrificat e grave ahmadiane



	Duke vendosur paqe ndërftetare • Fjalimi i Hazret Kalifit të Pestë a.t.b.a. me rastin e pesëdhjetëvjetorit të xhamisë “Nur”, në Frankfurt të Gjermanisë	42
	Një diamant i shkëlqyer dhe i paçmueshëm • Thënie e Hazret Mesihu i Premtuar a.s.	49
	Paqja politike (pjesa II) • Fjamili i Kalifit të IV “Përgjigja e Islamit ndaj çështjeve bashkëkohore”	50
	Jeta e Hazret Umerit r.a.	62
	Bekimet e Allahut të Lartësuar mbi Xhematin Mysliman Ahmadia • Rrëfime besimnxitëse të disa ahmadianëve arabë e të tjerë • Veprimtaria e Xhematit gjatë vitit 2008-09 në fushën e humanizmit • Anëtarësime të reja në Xhemat gjatë këtij viti • Shembulli i pashoq i sakrificës financiare për hir të Zotit nga Xhemati Mysliman Ahmadia	72
	Organizata humanitare e Xhematit Ahmadia dhe ndihma e saj për zona të përmybytura të Shkodrës	88
	Lutjet e Kryetarit Ndërkombëtar të Xhematit Mysliman Ahmadia a.t.b.a. rreth përmybytes në veri të Shqipërisë	94
	Shkurtime dhe shpjegime	96



Pse jemi në këtë botë?

Editorial

Enigma më e madhe që ka munduar racën njerëzore, që nga krijimi i parë e deri më sot, përmbledhet në pyetjen: “*pse ekzistojmë ne dhe gjithësia? Nëse do të gjejmë përgjigjen e kësaj pyetjeje*”, thotë Stiven V. Hoking, kozmologu dhe fizikani më i madh i këtij shekulli, “*ky do të jetë triumfi përfundimtar i arsyes njerëzore: atëherë ne do të kuptojmë se çfarë mendon Perëndia*”.

(Stiven V. Hoking, “*Një histori e shkurtër e kohës*”, f. 175, Tiranë, 1997, “Toena”)

Ky shkencëtar i madh i kohës sonë, e mbyll librin e tij, nga më të botuarit në botë, me këtë pyetje tronditëse për të dhe për shumë shkencëtarë, filozofë e njerëz të thjeshtë. Pse Zoti e ka krijuar gjithësinë? Ka edhe të tjerë që i mundojnë mendimet për makinerinë që generon dritën e diellit dhe që e bën të mundur jetën në Tokë; për gravitetin që na tërheq drejt Tokës i cili po të mungonte, ne do të flakeshim në hapësirë; ose për atomet e qelizat prej të cilave jemi

ndërtuar dhe nga qëndrueshmëria e të cilave varet jeta jonë!

Sigurisht që shkencëtarët po bëjnë përpjekje kolosale për të argumentuar këtë enigmë, përpjekje këto, që e kanë çuar jetën përpara në zhvillimin e mendimit dhe teknologjisë, por mundimi i tyre do të ishte më i lehtë po të orientohesh edhe nga drita hyjnore dhe shkencëtarët të bindeshin plotësisht me Krijuesin, qëllimin e krijimit të Tij. Le t’i drejtohem pak Kuranit të Shenjtë, duke bërë pyetje dhe njëkohësisht duke kërkuar përgjigje:

Pyetja:

- O Kuran i Shenjtë, a ka pasur Zoti qëllim kur krijoi gjithësinë dhe njeriun?

Përgjigja:

- “*Ne krijuam qiejt dhe Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre me qëllim të plotë dhe me afat të caktuar.*” (El-Ahkaf 46:4)
“*Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e* ▶

VËRTETËSIA

REDAKSIA ADRESA

Kryeredaktor: Samad Ahmed Ghorri
Zv. Kryeredaktor: Shahid Ahmad Butt
Redaktorë: Rexhep Hasani, Muhamet Peci, Petrit Bezhani
Anëtarë: Javaid Iqbal Nasir, Bujar Ramaj, Çapajev Zera
Grafika: 
 Shtypur në shtypshkronjën: Gent-grafik, Tiranë 2010

Xhemati Mysliman Ahmadia i Shqipërisë, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 1, Kutia Postare 8176, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355(0)682974992, 0692994966, 0672168054,
Fax: +355(0)48302523
E-mail: vertetesia@gmail.com

Faqja web: www.alislam.al

Shkarkoni revistën në pdf tek: www.alislam.al/vertetesia.html

të ditës, ka shenja për mendarët.” (Ale-Imran 3:191)

Pyetja:

- O Kuran i Shenjtë, cili është qëllimi i krijimit të gjithësisë?

Përgjigja:

- Thojeni vetë (o njerëz): “Qoftë lavdëruar Ai që i nënshtrroi këto për ne, se vetë ne këto nuk do të mund t’i kishim nën pushtet.” (Ez-Zuhruf 43:14)

Pyetja:

- O Kuran i Shenjtë, cili është qëllimi i krijimit të njeriut?

Përgjigja:

- “Njerëzit dhe xhindet i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” (Edh-Dharijat 51:57)

Krijimi i universit, fillimi i jetës në Tokë, krijimi i njeriut në këtë botë dhe nënshtrimi i gjithçkaje për të, nuk mund të realizoheshin falë shanseve të paplanifikuara dhe pa ndonjë Krijues të Përsosur, fakt ky që, për shkak të zhvillimit të shkencës, po vërtetohet gjithnjë e më shumë. Udhëtimi i verbër i jetës në këtë planet, kurrë nuk mund të krijonte jo vetëm njeriun e përsosur, por qoftë edhe një qelizë të vogël që përbëhet me po atë sistem universal që gjendet në univers.

Ajetet e Kuranit e sfidojnë njeriun për të gjetur ndonjë të metë në krijimin e Zotit:

Ti s’mund të shohësh asnjë të metë në krijimin e të Gjithëmëshirshmit, andaj, vështroje mirë e mirë! A sheh ndonjë të metë? Vështro edhe një herë! Shikimi yt do të kthehet te ti, i hutuar dhe i molisur.” (El-Mulk 67:4-5)

Çfarë nënkupton Kurani kur deklaroi se në këtë gjithësi nuk ka asnjë të metë? Sigurisht, ka larmi të

pafund përsosmërisht në të, por, ajo që duhet t’i interesojë njeriut është: nëse qëllimi kryesor i krijimit të gjithësisë ka qenë jeta e njeriut në këtë botë. Atëherë lind pyetja; si paska e arritur evolucioni nga një udhëtim 15 miliard vitesh, qëllimin e tij në mënyrën më të përkryer, pa gabuar në asnjë vend, pavarësisht nga mijëra e mijëra pengesa që haste ajo, gati në çdo hap gjatë udhëtimit të tij?

Isak Njutoni konsiderohet si një nga shkencëtarët më të mëdhenj që ka nxjerrë bota. Sipas tij universi nuk mund të shpjegohet pa besimin te Zoti. Ai thotë:

“Ky sistem më i bukuri i diellit, planetëve dhe kometave vazhdon vetëm nga këshilla dhe dominimi i një Qenieje të fuqishme dhe inteligjente.”

(Charles Whyte, “Our Solar System and the Stellar Universe”, f. 131 Charles Griffin & Co Ltd. Londer, 1923)

Astronomi i shquar anglez, Fred Hoyle, duke sqaruar krijimin e universit në mënyrë rastësore, shkruan:

“Kjo ndodhi është po aq e pabesueshme, aq sa mund të dalë një boing (avion) 747 nga një dyqan vjeturinash falë një shakulline të tërbuar”.

(HORGAN, J. (shkurt, 1991) “In the Beginning”, “Scientific American”, f. 118)

Një biolog i shquar i Universitetit të Princeton-it prof. Edwin Conklin, thotë:

“Mundësia e fillimit të jetës në mënyrë rastësore është e barabartë me mundësinë e shtypit të një fjalori të madh, falë një shpërthimi në shtypshkronjë”.

(KORNTELD, E.C. (1968) God – Alpha and Omega. In: The Evidence of God in an Expanding Universe, nga Monsma, J.C. botuesi Thomas Samuel, Bombay, f. 174)

E vërteta është se në gjithë këtë univers, nuk ka asnjë të metë, siç e kanë pohuar edhe shumë shkencëtarë të mëdhenj. Por, e meta shfaqet menjëherë kur përjashtohet Krijuesi i Përsosur nga krijimi i Tij.

Mjafton të shohësh vetëm udhëtimin e jetës në këtë planet, që kur kanë lindur gjallesat e para e gjer te njeriu. Evolucioni sigurisht që u bë, por, në çdo kryqëzim të udhës, vetë gjallesat kurrë nuk zgjodhën rrugën e tyre. Pa ndonjë Krijues të Mençur e të Përsosur, në asnjë mënyrë nuk mund të përfytyrohej dot destinacioni aktual. Jeta mund të merrte hap në cilindo drejtim, kishte shumë pak gjasa që të hidhej qoftë një hap në drejtimin e duhur. Pra, nëse nisja e çdo hapi, gjithmonë në drejtimin e duhur dhe miliona herë përsëritja e këtij fenomeni, për të shkaktuar më në fund lindjen e njeriut, është e rastësishme, atëherë kjo duket aq e çuditshme dhe e pabesueshme sa që as fantazmat e përrallave nuk do ta besonin. Megjithatë, disa filozofë dhe shkencëtarë e besojnë këtë, por e besojnë vetëm ata që më parë janë ateistë dhe pastaj janë shkencëtarë apo filozofë. Çdo përsosmëri e pashpjegueshme, sipas tyre, shpjegohet me termin *Seleksionim natyror*. Shkurt, këta njerëz e quajnë veprën mahnitëse të krijimit të gjithësisë thjesht një rastësi, mendim ky, jo vetëm që është i palogjikshëm, por gjithashtu i verbër, i shurdhër dhe memec.

Nëse njeriu ndërgjegjësohet për të vrarë mendjen në kërkimin e Krijuesit të tij, ai gjen shenja të panumërta që kanë lidhje me çdo fushë të dijes. Astronomi mund ta kërkojë Zotin në fushën e tij, po ashtu edhe një fizikan, gjeolog, ekonomist, mjek, gjuhëtar, etj. Ky realitet, falë zhvillimit të

shkencës dhe teknologjisë, sot është shumë më i qartë sesa kurdoherë më parë. Marrim vetëm dy tre shembuj të përgjithshëm. Jeta nga jashtë me të vërtetë është shumë e paqte dhe ajo gëzon ambientin më të rehatshëm për të lulëzuar. Por, realiteti, nga një pikëpamje tjetër, është shumë më i frikshëm se sa mendohet. Nëse asaj do t’i jepej aftësi për të konstatuar lirisht dhe imtësisht atë ambient që rrethon, mbijetesa e saj, për të mos thënë e pamundur, do të bëhej tejet e vështirë. Për fat të mirë, vdekja i vjen heshtur dhe kështu ajo shpesh rri e qetë nga rreziku. Nëse njeriu do t’i shihte bakteret e ujit të pijshëm, atëherë shuarja e etjes, në vend të kënaqësisë, do të bëhej një ndëshkim për të. Frymëmarrja do të ishte vërtetë torturuese për të, nëse ai fillon të shikojë bakteret që hyjnë bashkë me ajrin e pastër. Madje, shumë lloj bakteresh që gjenden në ajër janë kaq të dëmshme sa që nëse fillojnë të zënë vend në trupin e njeriut, ato do t’i shkaktojnë sëmundje të rënda si tuberkulozi, pneumonia, kanceri në mushkëri e mëlçi, septicaemia, ekzema e shumë sëmundje të tjera që mund të dëmtojnë organet kryesore të njeriut. Fakti është se këto lloje bakteresh me të vërtetë hyjnë bashkë me ajrin në trupin tonë, por prapë se prapë, ne nuk rrezikohemi nga ato. Qindra rreziqe të tilla ngrenë kryet kundër jetës së njeriut që kur është vendosur ardhja e tij në këtë botë dhe e shoqërojnë deri në fund, megjithatë, ai vjen i pajisur me një sistem mbrojtjeje jashtëzakonisht të sofistikuar që e mbron atë nga çdo anë, pa e lajmëruar as për rreziqet. Ky është ai sistem që është vënë për ta garantuar mbijetesën, duke përmbushur nevojën më jetike të njeriut.

Edhe këtë, Kurani Famëllartë e jep si argument me fjalë shumë të përsosura:

“Ai i di gjërat e dukshme dhe të padukshme. Ai është i Madhi, i Larti. (Për Atë) njëllon është: si ai prej jush që flet me vete edhe ai që flet me zë të lartë, si ai që fshihet natën edhe ai që ecën ditën. Njeriu ka përcjellës, para tij dhe pas tij, që e mbrojnë atë me urdhrin e Allahut. Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç’kanë në vetvete. Kur Ai dëshiron ta ndëshkojë një popull, askush nuk mund ta pengojë Atë; dhe ata, përveç Tij, s’kanë asnjë ndihmës.” (Er-Ra’d 13:10-12)¹

Megjithatë, enigma e shkencëtarëve për ekzistencën e Zotit, nuk zgjidhet vetëm nga shkenca, sepse në fund të fundit, hulumtimi i njeriut për gjithësinë dhe logjika e tij mund ta çojnë atë vetëm deri te pohimi se “duhet të ketë një Zot”. Ndërsa, besimi i vërtetë që tregon se “Ai është”, mund të arrihet kur Ai vetë na thotë: “Unë jam”. Kurani i Madhërishëm deklaroi se pikërisht Ai të çon nga pohimi shkencor deri te besimi i vërtetë, me kusht që ti ta kërkojë Atë me dashuri, si një fëmijë që kërkon nënën e tij.

Ajo që dëshirojmë të spikasim, në këtë numër të *Vërtetësisë*, janë pikërisht përgjigjet e pyetjeve të tilla që pengojnë kërkuesin për të arritur te Zoti; përse duhet ta kërkojmë Zotin? Çfarë dobie do të fitojmë nëse e gjejmë Atë? Pyetje të tilla kanë rëndësi shumë të madhe nëse njeriu ka arritur të mendojë për mundësinë e qenies së Zotit. A nuk është absurde të përcaktosh, në njërin anë, një qëllim

1. Një libër fenomenal në anglisht, i titulluar “Revelation, Rationality, Knowledge and Truth” i Hazret Mirza Tahir Ahmadit, Kalifit të Katërt i Mesihut të Premtuar, e shtjellon mjaft mirë këtë çështje.

qoftë vetjak, familjar, shoqëror apo kombëtar për jetën dhe ardhjen tënde në këtë botë, ndërsa në anën tjetër të mbyllësh sytë për ta konstatuar qëllimin e përgjithshëm të krijimit të gjithë njerëzve? Si është e mundur që të përmbushen qëllimet e tua në këtë botë, ndërsa Krijuesi i Lartë të mos mendojë përmbushjen e qëllimit të krijimit të gjithë universit? Allahu i Madhërishëm, në Kuranin Famëllartë, thotë:

“Ne nuk e kemi krijuar qiellin dhe Tokën e ç’gjendet në mes tyre thjesht për të lozur. Sikur të donim argëtim, Ne do ta bënim me gjërat pranë Nesh. Por Ne e godasim të pavërtetën, me të vërtetën, e cila e shkatërron atë dhe ajo zhduket. Dhe, mjerë për ju, për atë që shpikni (për Allahun!)”

(El-Enbija 21:17-19)

Sipas Kuranit Famëllartë, qëllimi i krijimit të njeriut është që ai ta adhurojë Zotin, çka do të thotë, të pasqyrojë atributet e Tij dhe të përfitojë komunikimin me Të nëpërmjet lutjes dhe shpalljes hyjnore. Po në këtë numër, të “Realiteti i lutjes” do të lexoni nevojën, esencën dhe dobitë e lutjes. Veç kësaj, ky numër i *Vërtetësisë*, përmban edhe fjalimin e Hazret Kalifit të Pestë të Mesihut të Premtuar, në të cilin na paraqet edhe rrëfime të besimtarëve ahmadianë që në kohën aktuale u udhëzuan në mënyrë hyjnore për ta gjetur rrugën e drejtë dhe për ta përqaftuar fenë e vërtetë, që është **Islami**, të cilin në këtë epokë, e ka paraqitur në mënyrë më të pastër Hazret Mesihu i Premtuar, Themeluesi i Xhematit Mysliman Ahmadian.

Samad Ghori

JANAR - PRILL 2010

KATËR atribute themelore të ZOTIT

Çdo lavdërim i takon
Zotit (*Rrab*) të botëve

të Gjithëmëshirshmit
(*Rrahman*)

dhe Mëshirëplotit
(*Rrahim*)

Sunduesit (*Malik*) të
Ditës së Gjykimit.

Komentimi i sures El-Fatiha


nga Hazret Mirza Ghulam Ahmadi,
Mesihu i Premtuar paqja qoftë mbi të

“Duhet ta dini se kjo *sure* është kapitulli i parë i Kuranit të Shenjtë dhe quhet *El-Fatiha*, (“*Hapja*”) ngaqë me këtë fillon ai. Kjo *sure* gjithashtu quhet “*Ummul Kitab*” (“*Nëna e Librit*”), ngase ajo është përmbledhja dhe esenca e gjithë Kuranit. Në këtë *sure*, Zoti na mëson që lutja është e domosdoshme për t’i gjetur bekimet e Tij. Ajo fillon me fjalët “*Elhamdulillah*”, që do të thotë se çdo lavdërim i takon asaj Qenieje që quhet “**Allah**”. Duke e nisur këtë *sure* me këto fjalë, duhet të dimë se adhurimi i Zotit të Madhërishëm, që është plot me dashuri e me sinqeritet, duhet bërë me gjithë zemër e shpirt, gjë që nuk mund të bëhet derisa mos të provohet se Ajo Qenie është përmbledhje e të gjitha atyre vetive të përsosura,

të cilat zemra jonë, duke i parë ato, t’i lavdërojë vetvetiu.

Lavdërimi i plotë bëhet për dy lloje vetish; njëri për bukurinë e përsosur dhe tjetri për mirësinë apo favorin e përsosur. Nëse dikush i ka të dyja këtotribute, atëherë zemra e njeriut dashurohet në të dhe humbet pas tij. Njëri ndër qëllimet më të mëdha të Kuranit të Shenjtë është pikërisht shfaqja e këtyre veçorive për kërkuesit e së vërtetës, në mënyrë që ata pastaj të jepen pas Atij që është i Pashembullt dhe i Pashoq dhe me gjithë shpirt të bëhen robërit e Tij. Andaj, Kurani i Shenjtë, që në *suren* e parë, jep një skicë të bukur dhe na tregon se çfarë atributesh ka Ai Zot që përmendet në Kuran. Për këtë arsye kjo *sure* fillon me fjalët “*Elhamdulillah*”, që

do të thotë, të gjitha lavdërimet i përkasin vetëm Atij që quhet "Allah". Sipas terminologjisë së Kuranit, Allah quhet ajo Qenie, vetitë e të cilit, për sa i takon bukurisë dhe mirësisë së tyre, ndodhen në pikën më të lartë të përsosmërisë dhe nuk gjendet asnjë lloj mangësie në Të. Prandaj, sipas Kuranit të Shenjtë, vetëm



Hazret Mirza Ghulam Ahmadi,
Mesihu i Premtuar *paqja qoftë mbi të*

emri "Allah" është përmbledhësi i të gjithatributeve të Tij. Kjo tregon se emri "Allah" mund të ekzistojë vetëm atëherë kur ai i mbledh të gjitha vetitë e përsosura, kështu që, Ai është më i Bukuri, pasi cilësohet si përmbledhja e të gjitha bukurive. Pikërisht për shkak të kësaj bukurie të Tij, Allahu gjithashtu quhet "Nur" (Dritë), siç është përmendur në Kuranin e Shenjtë: Allahu është drita e tokës dhe e qiellit dhe çdo dritë tjetër është pasqyrimi i saj.

Gjithashtu, ka shumë veti të mirësisë së Allahut të Madhërishëm, ndër të cilat katër janë më kryesoret. Sipas renditjes së natyrshme të tyre, **atributi i parë** është ai që përmendet në *suren El-Fatiha* me fjalët "Rab-bul Aemin" (Rab-il i

Rab është atribut i Zotit që do të thotë Ai që

botëve). Atributi *Rrab* i Zotit të Madhërishëm gjithnjë është në veprim në të gjitha botët, ndërkohë *Rrab* do të thotë se Ai krijon diçka dhe e çon për të arritur qëllimin më të lartë të krijimit. Kjo do të thotë se bota qiellore, bota tokësore, bota fizike, bota shpirtërore, bota shtazore, bota kimike, bota botanike,

bota e sendeve dhe të gjitha llojet e botëve janë nën kujdesin e Tij. Edhe vetë njeriu që kur ndodhet në gjendjen fillestare – në atë të spermës, madje edhe më përpara e më tej, deri në vdekje dhe më pas në botën tjetër, është gjithnjë nën kujdesin e kësaj vetie të Tij. Prandaj kjo veti e *Rrab-it* mund të quhet **bekimi më i përgjithshëm**, përderisa çdo gjë që ekziston në këtë gjithësi, qofshin shpirtat, qofshin trupat, qofshin kafshët apo bimët ose sendet, jo vetëm që morën jetë nga atributi i *Rrab-it*, por vazhdimisht përfitojnë nga ai. Megjithatë, njeriu është krijesa që përfiton më së shumti nga atributi *Rrab*, pasi ai shfrytëzon çdo krijesë tjetër për veten. Andaj,

krijon diçka, pastaj e zhvillon dhe e shpion shkallë-shkallë drejtë përsosmërisë. (Mufradati i Imam Ragibit dhe Lane)

Kurani i Shenjtë e kujton njeriun se Zoti i tij është *Rrab* i të gjitha botëve, në mënyrë që ai të ketë shpresë dhe besim që Zoti ka fuqi të mëdha dhe mund të krijojë një botë tjetër mjetesh për t'i ardhur në ndihmë atij.

Atributi i dytë i Zotit është "i Gjithëmëshirshëm". Ky atribut është mirësia apo favor i shkallës së dytë, që mund të quhet "bekim i përgjithshëm". Kurani i Madhërishëm e quan këtë veti "Rrahman" dhe sipas terminologjisë së tij, Zoti quhet *Rrahman*, pasi Ai i dha çdo gjallesë një trup dhe karakter të përshtatshëm, duke e përfshirë këtu edhe njeriun. Me një fjalë, Ai krijoi gjithçka në atë mënyrë, sa që çdo gjallesë, qoftë ajo zog, kafshë apo njeri, ka ato aftësi, fuqi dhe organe të tjera që i nevojiten dhe gjithashtu i përshtaten trupit të secilit. Madje, për mbijetesën e tyre u mundësoi çdo gjë që u duhet. Për më tepër, mijëra e mijëra vite para krijimit të këtyre gjallesave, për shkak të atributit të Tij *Rrahman*, Ai krijoi të tillë trupa qiellorë dhe tokësorë, që do t'u shërbenin si mbrojtës të jetës së tyre. Nga ky hetim nxirret në pah që atributi *Rrahman* (i Gjithëmëshirshëm) i Zotit të Madhërishëm nuk vepron për shkak të veprës së mirë të dikujt, pasi Ai është vetëm Mëshirë, që është aktiv edhe para krijimit të gjallesave. Megjithatë, vetëm njeriu është ajo gjallesë që mori më shumë pjesë nga mëshira e këtij atributi të

Zotit, sepse çdo gjë në këtë botë po sakrifkohet për suksesin e tij. Prandaj, Kurani i Shenjtë e

kujton njeriun se Zoti yt është *Rrahman*.

Atributi i tretë i Zotit është "Rrahim" (Mëshirëplotë), që është mirësia apo favor i shkallës së tretë, dhe që është përmendur në *suren El-Fatiha* me fjalën "Er-Rrahim". Sipas terminologjisë së Kuranit të Shenjtë, Allahu i Madhërishëm quhet *Rrahim*, atëherë kur Ai ua pranon lutjet, përgjërimit dhe veprat robërve të Tij dhe gjithashtu i shpëton nga fatkeqësitë, problemet dhe nga humbja e frytit të veprave të tyre. Ky favor, me fjalë të tjera, mund të quhet "bekim i veçantë" dhe është vetëm për njeriun. Gjallesave apo sendeve të tjera Zoti nuk u dha aftësinë e lutjes, të përgjërimit apo të kryerjes me ndërjegje të veprave të mira. Vetëm njeriut i është dhënë ky privilegj. Vetëm ai është një gjallesë që flet dhe mund të përfitojë nga bekimi i Allahut të Madhërishëm edhe me gjuhën e tij. Kjo tregon që lutja (*dua*) është një aftësi e veçantë e njeriut, e cila gjendet vetë në instinktin e tij. Siç e pamë më lart, nga atributet *Rrab* dhe *Rrahman* kemi bekime të posaçme, gjithashtu edhe nga atributi i Tij *Rrahim* kemi një bekim të veçantë. Ndryshimi i vetëm është ky: dy të parat nuk kërkojnë lutje, pasi ato janë të përgjithshme dhe nuk janë vetëm për njeriun, madje vetia e parë që është *Rrab* është aq e gjerë sa që asnjë gjë në univers nuk gjendet jashtë funksionimit të saj. Ndërsa ai i fundit (d.m.th. atributi *Rrahim*) është një dhuratë e veçantë vetëm për njeriun. Dhe në qoftë

se një njeri, duke pasur një favor kaq të madh, nuk përfiton nga ky atribut i Zotit, atëherë ai është i barabartë me kafshët, madje edhe me sendet. Pra, Zoti i Madhërishëm ka katërtribute kryesore për të dhënë katër lloj bekimesh, dhe me atributin e tretë që është *Rrahim*, Allahu kërkon që njeriu t'i lutet Atij. Kjo tregon se Allahu i Madhërishëm ka një bekim të veçantë, nga i cili mund të përfitosh vetëm nëse i lutesh Atij. Kështu ka qenë ligji e praktika e Tij dhe që nuk mund të ndryshojnë. Për këtë arsye profetët e mëparshëm, *paqja qoftë mbi ta*, vazhdimisht janë lutur për popujt e tyre. Shikoni në Bibël, sa herë bijtë e Izraelit gjendeshin afër ndëshkimit, duke merituar mospëlqimin e Zotit, nuk faleshin, veçse çdoherë kur Hazret Musai, *paqja qoftë mbi të*, iu lut Zotit dhe i përvuajtur bëri *sexhde* para Tij, megjithëse shpesh Zoti i premtonte që do t'i shkatërronte ata.

E gjitha kjo tregon se lutja nuk është diçka e kotë dhe ajo nuk është një adhurim i thjeshtë, që nuk mund të përfitojë nga bekimi i Zotit. Ky është mendimi i atyre njerëzve që nuk e vlerësojnë Zotin ashtu siç duhet vlerësuar, dhe që nuk mendojnë thellë për fjalët e Tij e nuk e marrin parasysh as ligjin e natyrës. Realisht, me anë të lutjes patjetër zbret një bekim për të na shpëtuar dhe ai quhet **bekim i Rrahimit**, me të cilin njeriu përparon vazhdimisht. Vetëm me anë të këtij bekimi, ai arrin në statusin e *eulijave* (miqve të Zotit), dhe fiton aq shumë besim në Të saqë sikur e shikon

vetë me sytë e tij. Çështja e *shifa'atit* (ndërmjetësimit në oborrin e Zotit) gjithashtu është rrjedhojë nga ky atribut.

Favori i katërt i Allahut të Madhërishëm është Atributi i Tij "**Maliki Jeumiddin**" (d.m.th. "Sunduesi i ditës së gjykimit"), i cili mund të quhet **favori më i veçantë** dhe që është përmendur gjithashtu në *suren El-Fatiha*, në vendin e katërt sipas renditjes sëtributeve të Zotit. Ndryshimi midis këtij atributi dhe atributit *Rrahim* është se me anë të këtij të fundit shkaktohet sukcesi i lutjes dhe ai i adhurimit të një robi, ndërsa me anë të *Maliki Jeumiddin-it* jepet fryti i tyre. Shembulli i kësaj ideje është si i atij studenti që mëson shumë dhe hyn në një provim të shtetit dhe pastaj e kalon. Kështu që, vendosja e një sukcesi me anë të atributit *Rrahim* është sikurse kalimi i studentit në provim.

Ndërsa gjetja e gjithë atyre gjërave apo stativeve, për të cilat ai kishte dhënë provimin, është sikur marrja e bekimeve nga atributi *Maliki Jeumiddin*. Këto dytribute të Zotit tregojnë se *Rrahimi* vjen nga mëshira e Zotit, ndërsa favorin që vjen nga *Maliki Jeumiddin-i* është një bekim i veçantë prej Zotit. Megjithatë, atributi i fundit, në mënyrë të përsosur do të manifestohet vetëm në botën tjetër."

(*Ruhani Khazain vol. 14, Ejjamus Suleh, f. 20-25, Londër, 1984*)

غير ممکن کو یہ ممکن میں بدل دیتی ہے
اے مرے فلسفیو! زورِ دعا دیکھو تو

Edhe të pamundurën
e bën të mundur
provoni fuqinë e lutjes,
o filozofët e mi!

*Hazret Mirza Mahmud Ahmadi^{r.a.}
Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar*

Rëndësia dhe realiteti i LUTJES

Nga ajetet e Kuranit të Shenjtë

Allahu i Madhërishëm, në Kuranin e Shenjtë, thotë:

“Kur robërit e Mi të pyesin për Mua, (thua ju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjes së lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, (edhe robërit e Mi) duhet t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe të më besojnë Mua, që të jenë në rrugë të drejtë.”

(El-Bekare 2:187)

“Thuaj: Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj. Por ju e keni përgënjeshtuar (mesazhin e Tij), prandaj dënimi për ju do të jetë i pashmangshëm.”

(El-Furkan 25:78)

“Zoti juaj tha: Më thërrisni Mua, Unë do t’ju përgjigjem. Por ata që

sillen me arrogancë ndaj adhurimit Tim, do të hyjnë në xhehenem të poshtëruar.”

(El-Mumin 40:61)

“A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij dhe Ai ia largon mjerimin, dhe ju bën juve trashëgimtarë në tokë?! Vallë a ka ndonjë zot tjetër përveç Allahut?! Sa pak që reflektoni!”

(En-Neml 27:63)

“Thuaj: Thirrni Allahun ose thirrni të Gjithëmëshirshmin, me cilin do emër që ta thirrni ju Atë, Ai ka emrat më të bukur. Gjatë namazit mos ngri zërin e as mos e ul shumë, por merr rrugën e mesme.”

(Beni Israil 17:111)



JANAR - PRILL 2010

Disa hadithe të Profetit Muhammed s.a.v.s. rreth realitetit të lutjes

Hazret Xhabir bin Abdillahu r.a. tregon: “Unë kam dëgjuar Hazret Profetin Muhammed s.a.v.s. duke thënë se kujtimi më i mirë është “Lailaha ill-llah”, (d.m.th. s’ka zot tjetër përveç Allahut), dhe lutja më e mirë është “Elhamdulillah”, (d.m.th. lavdërimi i takon Allahut)”

(Tirmidhi, Kitabud Da’vat, Bab da’vatil muslimi mustaxhabah)

Hazret Abu Musa Esh’ari r.a. thotë se Hazret Profeti M u h a m m e d s.a.v.s. ka thënë: “Shembulli i atij njeriu që kujton Zotin dhe i atij që nuk e kujton, është si shembulli i të gjallit dhe i të vdekurit.”

(Sahih Buhari Kitabud Da’vat, Bab fadli dhikrillah)

Hazret Xhabir bin Abdillahu r.a. thotë: Një herë Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s. erdhi te ne dhe na tha: “O njerëz, ushqehuni në kopshtet e Xhenetit.” Ne e pyetëm: “Ç’janë kopshtet e Xhenetit, o i Dërguar i Allahut?” Ai tha: “Tubimet për kujtimin e Allahut janë kopshtet e Xhenetit. Veçanërisht në mëngjes e në mbarim, kujtojeni Allahun. Nëse

dikush dëshiron të dijë se si vlerësohet ai te Zoti i tij, atëherë ai duhet të shqyrtojë se si e vlerëson Zotin dhe ç’status i jep Atij, sepse Allahu e vlerëson robin e Tij, sipas vlerësimit që ka ai për Allahun në zemrën e tij.”

(Keshirijah, Babudh-dhikr, f. 111)

Hazreti Abuhurejrah r.z. tregon se Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s.

ka thënë: “Çdo natë, Zoti ynë zbret në qiellin e tokës, (dhe qëndron) derisa vjen pjesa e tretë e natës kur Ai thotë: Ka njeri që të më thërrasë Mua e t’i përgjigjem atij? Ka njeri që të më kërkojë Mua diçka që t’i jap atij? Ka njeri që të më kërkojë faljen që ta fal atë.”

(Tirmidhi, Kitabud Da’vat)

H a z r e t Abuhurejrah r.a. tregon se Hazret

Profeti Muhammed s.a.v.s. ka thënë: “Robi ndodhet më afër Zotit të tij, atëherë kur ai është në sexhde. Prandaj, lutuni sa më shumë në sexhde.”

(Muslim Kitabus Salah, ma jekulu fir-ruku ves-suxhud) ▶



VËRTETËSIA

Hazret Selman Farsi r.a. tregon se Profeti Muhammed s.a.v.s. ka thënë: “Allahu është i Gjallë, shumë Bujar dhe i vjen keq ta refuzojë robin e vet dhe ta kthejë atë duarbosh kur ai zgjat duart e tij duke kërkuar prej Tij.”

(Tirmidhi, Kitabud Da'vat)

Hazret Abuhurejrah r.a. tregon se Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s. ka thënë: “Ai që dëshiron që Zoti t'i pranojë lutjet gjatë vështirësive dhe shqetësimeve, atëherë ai duhet të lutet shumë gjatë rehatisë.”

(Tirmidhi, Kitabud Da'vat)

Hazret Uthman bin Affani r.a. tregon se Profeti Muhammed s.a.v.s. ka thënë: “Asgjë nuk i sjell dëm atij që i lutet Zotit tri herë, çdo ditë në agim dhe në mbrëmje me këto fjalë: Në emrin e Allahut, në emrin e të Cilit asgjë nuk mund të dëmtojë, as në tokë as në qiell. Me të vërtetë Ai dëgjon shumë dhe është i Gjithëdijshëm.”

(Tirmidhi, Kitabud Da'vat)

Hazret Ibni Umeri r.a. tregon se Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s. kur çohet nga tubimi, lutej për eshabët e tij me këto fjalë: “O Zoti ynë, dhurona frikë prej Teje që të bëhet pengesë midis nesh dhe gjynaheve tona; falna bindjen ndaj Teje që na çon drejt Xhenetit Tënd; jepna besimin që na lehtëson shqetësimet e kësaj bote; mundësona që t'i përdorim veshët, sytë, fuqitë dhe aftësitë tona në mënyrën më të mirë, ashtu siç të pëlqen Ty. O Zoti ynë,

ai që na bën mizori, Ti Vetë merri hakun atij; ai që ka armiqtë me ne, ndihmona kundër tij; mbron besimin tonë nga sprovat; bota mos të bëhet gjithçka për ne dhe dija jonë mos të kufizohet vetëm me këtë botë; mos na cakto ndonjë autoritar që nuk na mëshiron.”

(Tirmidhi, Kitabud Da'vat)

Hazret Umeri r.a. tregon: Një herë i mora leje Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s. për të bërë *Umrah*. Duke më dhënë leje, ai më tha: “O vëllai im, mos na harro në lutjet e tua.” Hazret Umeri r.a. thotë: Nuk do të gëzohesha kaq shumë edhe po të më jepej e gjithë bota në vend të këtyre fjalëve.

(Tirmidhi, Kitabud Da'vat; Musnad Ahmad)

Hazret Abuhurejrah r.a. tregon se Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s. ka thënë: “Tri

lutje pranohen pa asnjë pengesë: lutja e atij që i bëhet mizori, lutja e udhëtarit dhe lutja e babait për fëmijën e tij.”

(Tirmidhi, Kitabud Da'vat)

“Hazret Ajshja r.a. (gruaja e Profetit s.a.v.s.) tregon: I Dërguari i Allahut s.a.v.s. shpesh çohet natën dhe falte namaz aq shumë sa që i ënjteshin këmbët. Një ditë i thashë: O i Dërguari i Allahut, pse mundohesh kaq shumë, kur Allahu t'i ka falur të gjitha gabimet e tua të mëparshme dhe të ardhshme? Ai më tha: “A nuk duhet të kem dëshirë të jem rob mirënjohës i Zotit!”

(Sahih Buhari, Kitabut Tefsir, Suretul Fet'h; Muslimi)

JANAR - PRILL 2010

Thënie dhe përvoja të Hazret Mesihut të Premtuar^{a.s.} në lutje

**Hazret Mesihu i Premtuar a.s.
duke treguar realitetin e lutjeve
thotë:**

“Realiteti i lutjes është ekzistenca e një lidhjeje tërheqëse midis robit të sinqertë dhe Krijuesit të tij. Domethënë, së pari mëshira e Zotit të Lartësuar e tërheq robin e Tij drejt Vetes. Pastaj joshja që del nga sinqeriteti i robit bën që Zoti t'i afrohet më shumë dhe mbasi që krijohet një lidhje e veçantë në çastin kur bëhet lutja, shfaqen rezultate të çuditshme. Kështu që, kur robi ndodhet në ndonjë vështirësi shumë të madhe dhe ai, me besim të përsosur, me shpresë të përsosur, me dashuri të përsosur, me besnikëri të përsosur dhe me guxim të përsosur, përulet para Zotit duke qenë shumë i vetëdijshëm e duke i grisur perdet e errësirës, përparon në gjendjen e qenies së tij të hiçit, atëherë ajo që shikon para syve të tij do të jetë pragu i Zotit ku nuk shoqëron askënd me Të. Në atë moment shpirti i tij e vë kokën në pragun e Tij. Dhe ajo fuqia tërheqëse, që i është dhuruar robit, fillon ta tërheqë mirëbërësinë e Zotit. Atëherë Zoti i drejtohet për t'ia plotësuar qëllimin dhe efektin e lutjes së tij, ia shpërndan të gjitha atyre mjeteve materiale me të cilat krijohen ato mjete që janë të nevojshme për qëllimin e lutësit.”

(Barakat-ud-Du'a, Ruhani Khazain, vol. 6, f. 9-10)

“Realiteti i disa kategorive të mrekullisë, në fakt është pranimi i lutjes. Ato mijëra mrekulli që kanë treguar profetët si dhe të gjitha gjërat e jashtëzakonshme që kanë treguar *evlijatë* (njerëzit e Zotit) deri më sot, kanë rezultuar se burimi i tyre në të vërtetë është lutja. Efekti i lutjes shpesh ka shfaqur gjëra të çuditshme e të jashtëzakonshme të krijimtarisë së Zotit. Ajo ngjarje e çuditshme që ndodhi në shkretëtirën e Arabisë kur u rijetësuan qindra mijëra të vdekur në një periudhë të shkurtër kohe. Ata që ishin të keqduhëhequr përgjatë brezave të tërë, veshën ngjyra Hyjnore; ata që ishin të verbër, fituan pamjen; ata që ishin memecë, filluan të flasin për kuptimin e Hyjnores, dhe bota pësoi një revolucion, i cili nuk ishte parë a dëgjuar më parë. A e dini se çfarë e shkaktoi këtë? Ishin përgjërimit gjatë netëve të errëta të dikujt që ishte i përhumur pas Allahut, lutjet e të cilit lëshuan një britmë në gjithë botën dhe shfaqën të tilla mrekulli sa që dukeshin të pamundura në rastin e një të paarsimuarit e të pa përkrahurit. O Allah zbrit mbi të dhe ndjekësit e tij bekimet dhe paqen Tënde sipas dhimbjes dhe ankthit që ai ndjeu për umetin e tij dhe hidh mbi të përgjithmonë dritën e mëshirës Tënde.”

(Barakat-ud-Du'a, Ruhani Khaza'in, vol. 6, f. 10-11) ▶

Duke treguar përvojën e tij në pranimin e lutjeve, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

“Unë them edhe nga përvoja ime që efekti i lutjeve është shumë më i fortë sesa efekti i tipareve të ujit apo të zjarrit. Madje asgjë nga gjërat natyrore nuk është më shumë efektive sesa është lutja.”

(*Barakat-ud-Du'a, Ruhani Khazain, vol. 6, f. 11*)

Ai gjithashtu tha:

“Gjatë provave të ndryshme shihen tiparet dhe efektet e çuditshme të lutjeve. E vërteta është që Zoti ynë njihet vetëm me anë të lutjeve.”

(*Malfuzat, vol. 2, f. 147*)

Mandej, efektin dhe fuqinë e lutjes që ndjeu Hazret Mesihu i Premtuar a.s.

e përmendi me këto fjalë:

“Ajo lutje që bëhet mbas njohjes së përsosur të Zotit dhe lind me anë të bekimit të Tij, tiparet dhe ngjyrat e saj janë krejtësisht të tjera. Ajo është një gjë vdekjeprurëse; një zjarr i ndjeshëm; një fuqi magnetike për ta tërhequr mëshirën e Zotit; një vdekje që përfundimisht të ringjallë, një përmbytje e fortë, por në fund shndërrohet në varkë. Çdo problem rregullohet me të dhe çdo

helm bëhet shërues me anë të saj. Të bekuar janë ata të burgosur që nuk lodhen duke u lutur, sepse do të lirohen një ditë. Të bekuar janë ata të verbër që nuk ngathen duke u lutur, sepse do të fitojnë të pamurit një ditë, Të bekuar janë ata që janë të varrosur, të cilët me anë të lutjes

I bekuar je ti kur nuk lodhesh duke u lutur, kur shpirti yt shkrihet dhe sytë e tu lotojnë duke bërë lutje, mandej ajo të ngjall një zjarr në gjoksin tënd, dhe për të gjetur kënaqësinë e vetmisë të çon në kasolle të errëta e në vende të shkreta dhe të çmend e të shqetëson ty jashtë mase, kështu ndodh, sepse më pas ti do të bekohesh. Ai Zot, drejt të Cilit ne të ftojmë ty, është shumë Bujar, shumë i Mëshirshëm, shumë i Hijshëm, shumë Besnik dhe i Vërtetë, që mëshiron ata që janë të paaftë. Prandaj edhe ti bëhu besnik dhe lutu me gjithë besimin dhe besnikërinë, sepse Ai do të të mëshirojë ty.

i kërkojnë ndihmën Allahut, sepse do të nxirren nga varret një ditë. I bekuar je ti kur nuk lodhesh duke u lutur, kur shpirti yt shkrihet dhe sytë e tu lotojnë duke bërë lutje, mandej ajo të ngjall një zjarr në gjoksin tënd, dhe për të gjetur kënaqësinë e vetmisë të çon në kasolle të errëta e në vende të shkreta dhe të çmend e të shqetëson ty jashtë mase,

kështu ndodh, sepse më pas ti do të bekohesh. Ai Zot, drejt të Cilit ne të ftojmë ty, është shumë Bujar, shumë i Mëshirshëm, shumë i Hijshëm, shumë Besnik dhe i Vërtetë, që mëshiron ata që janë të paaftë. Prandaj edhe ti bëhu besnik dhe lutu me gjithë besimin dhe besnikërinë, sepse Ai do të të mëshirojë ty.”

(*Lekçer Sialkot, f. 26-28, Ruhani Khazain, vol. 20 f. 222-223*)

Duke folur rreth realitetit dhe rëndësisë së lutjes në vende të ndryshme, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

“Ata (po fliste për disa njerëz) nuk dinë realitetin e lutjes dhe janë injorantë në efektin e saj. Dhe kur shohin që dëshirat e tyre boshe nuk u plotësohen, thonë se lutja është e kotë dhe pastaj e braktisin.”

(*Malfuzat, vol. 2, f. 150*)

“Edhe njeriu ka një helm siç e ka gjarpri. Shërimi i tij është lutja, me anë të cilës hapet një burim në qiell. Ai që është injorant në lutje është i vdekur. Ai që ka kaluar një ditë dhe një natë pa u lutur, i afrohet shejtanit. Çdo ditë duhet ta kontrollosh veten se “a e kam plotësuar detyrën e lutjes për sot apo jo?!”

(*Malfuzat, vol. 3 f. 591*)

“Nëse dëshironi që ju të jeni mirë dhe të keni paqe në shtëpitë tuaja, atëherë është mirë që të luteni sa më shumë. Mbushini shtëpitë tuaja me lutje, se Zoti nuk e shkatërron atë shtëpi në të cilën luten shumë.”

(*Malfuzat, vol 3, f. 232*)

“Mendova që t’ju tregoj burimin e bekimeve të Zotit. Ndërkohë Zoti më njoftoi duke diktuar në zemrën time që burimi i tyre është (ky ajet) “*Ud’uni Astaxhib lakum*” [d.m.th. “*Më thërrisni Mua, Unë do t’ju përgjigjem.*” (El-Momin, 40:61)] Askush nuk mund të shpëtojë nga mëkatet përveç me anë të bekimit të Zotit.”

(*Malfuzat, vol. 3, f. 333*)

“Rrënja e shenjës (mrekullisë) është lutja. Ajo është *Ism-e-Azemi* (Emri më i lartë) dhe mund ta ndryshojë botën krejtësisht. Ajo është arma e besimtarit dhe patjetër që është.

Dhe është e sigurt që së pari ai duhet të kalojë gjendjen e përvuajtjes.”

(*Malfuzat, vol. 3, f. 202*)

“Ata që hyjnë në këtë Xhemat, gjëja më e mirë që fitojnë është kjo që unë do të lutem për ta. Lutja është një gjë e tillë që mund të gjallërojë edhe një degë të thatë dhe mund të ringjallë një të vdekur. Ajo ka shumë fuqi.”

(*Malfuzat, vol. 3, f. 100*)

“Lutja është një gjë shumë e dobishme. Nëse do Zoti, ajo mund të bëhet edhe mjete i faljes së mëkateve. Nëpërmjet saj, dalëngadalë Zoti i tregon mëshirë lutësit. Ai që nuk i lutet Zotit, së pari i ndryshket zemra, pastaj i ngurtësohet, më pas fillon ta mohojë Atë, pastaj armiqësohet me Të dhe përfundimisht mbetet pa besimi.”

(*Malfuzat, vol. 3, f. 628*)

“Nëse ndonjë fat (i keq) është ende pezull atëherë lutja dhe *sadakaja* mund ta largojnë atë, mandej Zoti me bekimin e Tij e ndryshon atë fat.”

(*Malfuzat, vol. 3, f. 24*)

“E vetmja derë që Zoti i Madhëruar ka lënë hapur për të mirën e krijesave të Tij është lutja. Kur një njeri, me përgjërime e me të qara hyn në këtë derë, Zoti Bujar e mbulon me çarçafin e pastërtisë e të çiltërsisë.”

(*Malfuzat, vol. 3, f. 315*)

“Rruga më e mirë për të gjetur bekimin e Zotit është lutja. Ajo lutje ... që është plot me përulësi, përvuajtje dhe me zemër të prekur, ajo e sjell bekimin e Zotit të Madhëruar... Edhe për lutjen e vërtetë duhet lutja.”

(*Malfuzat, vol. 3, f. 397*)



**Hazret Mirza Tahir Ahmadi r.t.a.,
Kalifi i Katërt i Mesihut të Premtuar**

JANAR - PRILL 2010

Dashuri për të gjithë

NJË LUTJE E PËRULUR e Hazret Mesihut të Premtuar ^{a.s.} PËR TË KËRKUAR FALJEN E MËKATEVE

Hazret Mesihu i Premtuar a.s., në një letër ngushëllimi, duke iu drejtuar me shumë modesti Maulana Nuruddin Sahibit (Kalifit të Parë të Mesihut të Premtuar) të cilit i kishte vdekur djali, (më gusht 1885), i tërheq vëmendjen për këtë lutje. Ai shkruan:

“Kjo lutje është zakoni i këtij robi modest dhe në të vërtetë është tamam për gjendjen time.”

Ai gjithashtu e këshilloi: “Është mirë që kur do ta bëni këtë lutje, të keni parasysh që lutësi me gjithë zemër duhet ta pranojë gabimin e tij dhe gjithashtu favorin e bekimin e Zotit të tij. Sepse s’ka dobi nëse thuhet vetëm me gojë, andaj duhet një pasion në zemër bashkë me mallëngjim e me të qarë.”

Pastaj ai i tregoi se si duhet bërë kjo lutje duke thënë: “Zgjuhuni në pjesën e fundit të natës, merrni abdes dhe me shumë sinqeritet falni dy *nafile*, pastaj bëni këtë lutje me shumë përlujtje e me shumë dhimbje:

O Mirëbërësi im, o Zoti im, unë jam një rob Yti, i paaftë, shumë mëkatar dhe shumë përtac. Unë bëja mizori pas mizorie dhe Ti më dhe bekime mbi bekime. Unë bëja mëkat pas mëkati dhe Ti më bëre mirësi pas mirësie. Ti gjithmonë m’i mbulove mëkatet e mia dhe më dhurove bekimet e Tua të panumërta. Prandaj, edhe tani, më mëshiro mua të kotë dhe mëkatar, dhe më fal gabimin dhe mosmirënjohjen time e më liro nga ky mëkat imi, se s’ka ndihmës tjetër përveç Teje. Amin! Amin!”

(Maktubat-e-Ahmadia, vol. 5, nr. 2, f. 3)

VËRTETËSIA

urreetje për askënd

Tri PYETJE rreth ZOTIT

Hazret Mirza Bashir Ahmadi (1893 – 1963)

Kjo është një pjesë e shkëputur nga libri “Zoti ynë”, i Hazret Mirza Bashir Ahmadit ^{rt.a.}, në të cilin, autori trajton çështjen e besimit në Zot në mënyrë shumë të thjeshtë, por shumë të bukur. Ai u përgjigjet të gjitha pyetjeve që shtrohen zakonisht në kohën tonë, sidomos nga të rinjtë, madje edhe nga shtresa e intelektualëve.

GJENDJA E SOTME PËR BESIMIN NË ZOT

Në fillim desha të shprehja pikëllimin dhe brengën time për gjendjen e sotme të njerëzve për besimin në Zot, në përgjithësi. Sa për të thënë, të gjitha fetë që janë në botë, besojnë në qenien e Zotit.

Otë dashur! Zgjuhuni dhe nisuni në kërkimet e këtij Zoti. Zgjuhuni dhe vraponi drejt atij burimi, i cili është burimi i jetës suaj. Zgjuhuni dhe nxitohuni për të kapur atë thesar, i cili do t’ju lirojë nga varësitë e botës. S’kam mundësi që t’ua përshkruaj me fjalë se çfarë mund të arrini nëse e gjeni Atë.

Njerëzit që u përkasin feve të ndryshme, thonë se janë besimtarë të Tij, përveç një pjese të vogël që e mohojnë kategorikisht Zotin. Por, nëse do të vështrosh në thellësi dhe ta studiosh gjendjen e tyre të besimit, atëherë do të shohësh se ky besim është vetëm një trashëgim traditash që nuk ka asnjë lidhje me të vërtetën. Ngaqë fetë e tyre u

mësojnë dogmën se “ju keni një Zot” dhe po ashtu ata, brez pas brezi, e dëgjojnë thënien se “kemi një Zot” edhe vetë ata e ndiejnë që duhet të jemi të bindur në fenë tonë, sa të mos shtihet gërshetimi i shoqërisë; për më tepër atyre u ngjallet herë pas herë zëri i instinktit të tyre që u thotë se ndoshta në të vërtetë ► ne kemi një Zot, ndaj ata nuk

guxojnë ta mohojnë kategorikisht Zotin dhe e quajnë veten besimtarë. Por në të vërtetë ata nuk besojnë në Zot dhe zemrat e tyre janë boshe për nga besimi, ashtu si një shtëpi e braktisur nga njerëzit e saj.

Unë nuk e them këtë për ndonjë popull të caktuar ose për njerëzit e ndonjë feje të caktuar, por e them për të gjithë njerëzit dhe për të gjitha fetë e botës. Sepse unë shoh që ndjekësit e feve të ndryshme, d.m.th. zorastrianët, budistët, hindutë, hebrenjtë, krishterët, myslimanët etj, të gjithëve u është futur thellësisht ky helm, i cili mund të quhet "helmi i mosbesimit". Erërat përvëluese të materializimit s'kanë lënë asnjë kopsht të besimit pa e zhuritur. Nëse dikush më kërkon prova për mendimin tim atëherë, me bekimin e Zotit, mund të nxjerr mjaft arsye që nuk mund t'i mohojë ndonjë i mençur. Por, këtu unë dua t'ia shtroj pyetjen atyre që dyshojnë në këtë se; a mund të thonë ata me sinqeritet, pasi të kenë shqyrtuar zemrat e tyre dhe të kenë analizuar njerëzit që jetojnë rreth tyre, se a besojnë ata në Zot në të vërtetë? Nuk flas për besim ritual, të trashëguar nëpërmjet gojëdhënave, por e kam fjalën për besimin e vërtetë dhe të gjallë. Qenia e Zotit, a është aq e ndjeshme dhe e dëshmuar për ta, ashtu siç i shikojnë dhe i dëshmojnë gjërat materiale të kësaj bote? Domethënë a besojnë ata në Zot ashtu siç kanë besim, për shembull, se ky është dielli, kjo është hëna, ky është mali, ky është lumi, kjo është shtëpia jonë, këta janë prindërit tanë, ky është miku im? Nëse ata nuk kanë besim të tillë atëherë duhet të kuptosh se ky s'është besim, por

është vetëm një lloj dyshimi dhe kjo është sikur ata kanë përqafuar një të vdekur dhe të kalbur duke menduar atë si të gjallë.

Nëse thoni se ky nivel i besimit është niveli më i lartë, të cilin shumë pak njerëz e arrijnë dhe ata janë njerëz të zgjedhur, atëherë unë ju them se edhe kjo është një dëshmi për paditurinë tuaj. Sepse niveli më i lartë i besimit është ai, shijen e të cilit nuk e dini fare dhe ndoshta shumë prej jush as nuk mund ta imagjinojnë. Niveli i besimit që kam përmendur më lartë, që duhet të besosh në Zot në mënyrë të atillë siç beson në gjërat materiale të kësaj bote, faktikisht është një nivel mesatar. Në një *Hadith* (thënie e Profet Muhammedit ^{s.a.v.s.}) që një nga dukuritë e përgjithshme të besimit është se besimtarit i pëlqen të hidhet në zjarr dhe të digjet, por nuk e lë besimin e tij. Por unë ju them se nëse ju jeni larg prej kësaj dukurie, atëherë dua t'ju pyes vetëm kaq: më thoni sinqerisht se a ndikon besimi juaj si diçka e vërtetë dhe e gjallë mbi jetën tuaj të përditshme? A e ndieni në të vërtetë dashurinë ndaj Zotit dhe frikën e zemërimit të Tij? A ju nxit realisht besimi juaj për të mirën dhe a ju largon nga e keqja? Në të gjitha çështjet, a keni besim të vërtetë tek Zoti apo te mjetet materiale?

Nuk e kam fjalën që a ndieni ndonjë lidhje në zemrën tuaj ndonjëherë me Zotin, apo kujtimi i Tij, ndonjëherë, ju ndalon nga mëkatet dhe ju nxit për vepra të mira, ose nëse kur bindja juaj shkon te Zoti duke mos menduar për mjetet materiale? Sepse ndodhi të tilla ngandonjëherë, nuk mund të

thuhet se janë pasojë e besimit. Në një gjendje të tillë mund të bie edhe ai, që jo vetëm që nuk e mohon Zotin, dhe herë pas here i shkon mendja se "ndoshta në të vërtetë ka një Zot, që më ka krijuar mua dhe që drejton tërë sistemin e gjithësisë, para të Cilit unë duhet të paraqitem një ditë". Një njeri i tillë, deri në një farë mase, sigurisht do të ndiejë një lidhje me përfytyrimin e Zotit, i krijuar nga vegimi i tij, i cili nganjëherë e largon atë nga mëkatet dhe e nxit rrallëherë për të mirën, dhe shikimi i tij disa herë i kapërcen edhe mjetet materiale dhe shkon te Zoti dhe ai fillon të mendojë se qenia më e besueshme është qenia e Zotit. Kjo nuk është gjendja e besimit, por mund të quhet vetëm një gjendje dyshimi, e cila e bën të lëkundet si lavjerrës. Besimi i vërtetë është vetëm ai që bëhet një pjesë e pakëputshme e jetës së njeriut, bëhet ushqimi i shpirtit të tij dhe që vepron si një fener udhëzimi, që gjithmonë e largon nga rrugët e zymta të mëkateve, nëpërmjet këtij feneri, para syve të tij, shfaqen rrugët e veprave të mira dhe të gjitha mjetet materiale nuk i vlejnjë asgjë për të, d.m.th. të mos ketë besimin e vërtetë në ato, por ta ketë vetëm në qenien e Zotit të Madhërishëm që është krijuesi i të gjitha mjeteve. Dhe pastaj zjarri i dashurisë ndaj Zotit gjithmonë të jetë i ndezur në zemrën e tij, si dhe frika e zemërimit të Tij ta ndalojë atë nga rrugët e këqija.

A gjeni një besim të këtyllë në zemrat tuaja? Nëse jo, dhe ka shumë mundësi që jo, atëherë duhet të turpëroheni që të quani veten besimtarë, andaj nisuni në kërkim të atij besimi që zbret nga qielli dhe

si një llambë e ndritshme i ndriçon edhe skajet më të errëta të zemrës suaj. Atëherë, qenia e Zotit nuk mbetet si një idhull i përfytyruar, i krijuar nga mendja juaj, por Ai do t'ju shfaqet i Gjallë, i Përrjetshëm, Sundues i Gjithëfuqishëm por edhe i Gjithëmëshirshëm dhe Dashamirës, mbretëria e të Cilit do t'ju duket shumë më e besueshme se mbretëritë e kësaj bote.

Pra, ky realitet nuk mund të mohohet që besimi i vërtetë në këtë kohë mungon në botë. Ai mungon jo vetëm në zemrat e njerëzve të thjeshtë, por edhe në zemrat e atyre që quhen klerikët e feve dhe që kujtojnë se janë kujdestarë të besimit të njerëzve, pra edhe ata janë bërë pre e ateizmit. Ata, ose po e mashtrojnë botën, ose vetë janë të mashtruar, sepse fjalët e tyre janë të pasura, por zemrat janë të zbrazëta. Sot, në të vërtetë, bota është e kapluar nga një errësirë e thellë në lidhje me besimin, dhe nuk duket asnjë dritë e dobët në ndonjë skaj të botës, që mund t'i ndriçojë disi rrugën ndonjë udhëtari të lëkundur. A nuk do të ishte e nevojshme, që në një kohë të tillë të errët, sipas praktikës së hershme të Zotit të Mëshirshëm, dielli i paraqitjes së Tij të lindej nga horizonti i zemrës së ndonjë robi të Tij të pastër dhe ta ndriçonte botën? O të dashurit e mi! Zgjohuni, dhe vendoseni ballin tuaj të përulur para pragut të Zotit, se Ai e pa gjendjen tuaj dhe e ka ngritur diellin e Tij shpirtëror nga Lindja për ju. Tani, hapni dritaret e zemrës suaj dhe lini këto rreze shpirtërore të futen në to, sa t'i largojnë errësitat e dyshimeve nga zemrat tuaja dhe sa të shndërrohet nata juaj në ditë. ►

NËSE ZOTI EKZISTON, PSE NUK DUKET?

Tani, para së të filloj temën kryesore, dua të heq një dyshim që zakonisht lind në zemrat e njerëzve: nëse ka Zot, atëherë pse nuk duket? Faktikisht ky dyshim nuk është i sotëm, por atë mund ta gjejmë në çdo kohë. Kështu që, në Kuranin e Madhërishëm është përmendur se

edhe ateistët e shkretëtirës së Arabisë, i kishin bërë të njëjtën pyetje Hazret Muhammedit⁵.

(Beni Isra'îl, 17: 93) dhe i kishin kërkuar: "Nëse na tregon Zotin, atëherë do ta besojmë". Por unë gjithnjë kur e dëgjoj këtë pyetje, ose e lexoj diku, më vjen

shumë keq për ata që e shtrojnë atë. Pikëllim! Kur njeriu fillon të lëkundet, për shkak të perdes që mbulon mendjen e tij, ai nis të mohojë edhe gjërat shumë të qarta. Kjo pyetje nëse shtrohet në kohët e kaluara të hershme, ndonëse është e palogjikshme dhe e rreme, mund të ngatërronte përkohësisht njerëz të pamend, por në kohën tonë të shtrohet kjo pyetje është shumë e habitshme. Madje unë çuditë për gjendjen mendore

të atij njeriu, që përpiqet të ndiejë kënaqësi duke bërë një pyetje të tillë. Sipas mendimit tim pyetje të tilla mund t'u shkojnë përshtat vetëm fëmijëve ose atyre që janë me të meta mendore. Megjithatë, ngaqë kjo quhet një pyetje e zakonshme prandaj edhe duhet sqaruar. Unë

shkurt do t'i përgjigjem kësaj pyetjeje dhe pastaj do të kthehem në temën kryesore.

Ne kemi mjete të ndryshme, për të njohur gjëra të ndryshme. Për shembull ka shumë gjëra që mund t'i njohim duke i parë, duke i dëgjuar,

duke i shijuar, duke i nuhatur ose duke i prekur ato. Të gjitha këto mjete janë njësoj të besueshme. Nuk kemi të drejtë të themi për një gjë të caktuar të cilën mund ta njohim vetëm nga një shqisë e caktuar, në mënyrë këmbëngulëse të kërkojmë ta njohim prej një shqisë tjetër. Për shembull ngjyrat mund t'i dallojmë vetëm duke i parë, aromën mund ta njohim vetëm duke e nuhatur, po ashtu për zërin kemi veshët. Do të

Ne kemi mjete të ndryshme, për të njohur gjëra të ndryshme. Për shembull ka shumë gjëra që mund t'i njohim duke i parë, duke i dëgjuar, duke i shijuar, duke i nuhatur ose duke i prekur ato. Të gjitha këto mjete janë njësoj të besueshme. Nuk kemi të drejtë të themi për një gjë të caktuar të cilën mund ta njohim vetëm nga një shqisë e caktuar, në mënyrë këmbëngulëse të kërkojmë ta njohim prej një shqisë tjetër.

jetë budallallëk nëse do të thuash se nuk do ta besoj këtë ose atë aromë derisa të mos e shoh; ose derisa të mos e nuhas ndonjë ngjyrë ose derisa të mos e prek ndonjë zë nuk do të besoj në të. Ai që bën pyetje të tilla do të quhet i pamend dhe nëse nuk do të shtrohet në çmendinë, ai do të mbetet si qesharak për njerëz çapkënë. Por, është shumë e habitshme që njerëzit shpesh herë bëjnë pyetje të tilla edhe për Zotin, prapë këta mbahen si të mençur në shoqëri. Pse asnjë rob i Zotit nuk i pyet këta, se cili është shkaku i kësaj çmendurie! Vallë, a vetëm qenia e Zotit ka mbetur për t'u tallur me një përbuzje të këtillë?!

Deri këtu unë i kam përmendur vetëm ato gjëra të cilat mund t'i dallojmë me anë të shqisave. Por, në këtë botë, ka gjëra të panumërta të cilat ne nuk mund t'i dallojmë me anë të tyre, por prapë ne besojmë në to mu ashtu, siç besojmë në gjërat e tjera që mund t'i dallojmë me anë të shqisave. Për shembull fuqinë magnetike, as nuk mund ta shihni me sy, as nuk mund ta dëgjoni, as nuk mund ta nuhasni, as nuk mund ta shijoni dhe as nuk mund ta preknin atë me dorë. Por a ka njeri prej jush që do të guxojë ta mohojë këtë fuqi? Unë patjetër them se jo. Sepse ju e shihni veprimin dhe rezultatet e saj, edhe pse nuk mund ta konceptoni këtë fuqi drejtpërdrejt me anë të ndonjë shqisë. Asnjëherë nuk ju shkon mendja që "ngaqë nuk e kemi parë këtë fuqi, as nuk e kemi dëgjuar e as nuk e kemi nuhatur apo shijuar, por edhe nuk e kemi prekur atë, prandaj nuk mund ta besojmë". Në mënyrë të ngjashme është edhe

fuqia elektrike, e cila nuk duket fare, por mbizotëron në jetët tuaja. Pra edhe këtë nuk mund ta mohoni, ndonëse s'mund të dëshmoni asgjë për të nëpërmjet asnjërës prej shqisave tuaja, por ju besoni në qenien e saj ashtu siç besoni, për shembull, në diell, në hënë, në mal etj.

Mendoni edhe për ndjenjën e dashurisë. A ka ndonjë që mund ta ketë parë, dëgjuar, nuhatur apo prekur atë? Unë nuk e di nëse ndër lexuesit e këtij libri, ka ndonjë prej tyre që e ndien fort dashurinë; nëse ka, atëherë unë do ta pyesja se a nuk e sheh ai që një zemër kaq e vogël, që ndoshta nuk mund të peshojë as një çerek kile, mban një oqean të pafundmë të dashurisë, e cila kur arin të dallgëzohet, mbase, bëhet më e fuqishme ndër të gjitha krijesat e Zotit të Madhërishëm. Është dashuria, ajo që një njeriu të dobët dhe të paafatë i jep një fuqi të tillë që ai, për dashurinë e tij, sfidon edhe male të larta, kalon shkretëtirat, bëhet gati të ndeshet edhe me egërsirat ose të hidhet i gjallë në zjarr dhe me furi përballon edhe dallgët e fuqishme të detit, por nuk dorëzohet. Ai kalon netët pagjumë dhe ditën bredh si i çmendur; dhe gjakun e tij e derdh duke e shndërruar në lot, por nuk këputet. A ka njeri në botë që mund të pretendojë se kjo fuqi nuk ekziston? Por kush e ka parë këtë fuqi? Kush e ka dëgjuar? Kush e ka nuhatur? Kush e ka shijuar ose kush e ka prekur? Të ngjashme janë edhe ndjenjat e tjera të fuqishme si për shembull, mëshira, zemërimi, epshi, etj. të cilat ekzistojnë, edhe pse nuk i keni dëshmuar drejt-

përdrejtë nëpërmjet ndonjëres nga shqisat. Është një mendim fëmijësh, të kërkosh një gjë të caktuar me anë të një shqise të caktuar. Qëllimi është që ta perceptosh atë, me anë të çfarëdo lloje shqise. ... Sa dëshpërim i madh! “Vëma Kadarullaha Hakka Kadrihi” “Njerëzit nuk e vlerësuan Zotin ashtu siç duhej vlerësuar”. (El-Haxh, 22:75)

Miq të mi të dashur! Duhet të kuptojmë se sa më e trupëzuar të jetë një gjë, aq më lehtë mund të kapet me anë të shqisave dhe sa më e patrupëzuar të jetë, aq më i vështirë është perceptimi i saj me anë të tyre. Pikërisht për këtë arsye, kur përpiqemi të mësojmë për gjërat e patrupëzuara, ne duhet të mbështetemi në cilësitë dhe veprimet e tyre më shumë sesa në vëzhgimin e drejtpërdrejtë.

Si është e mundur atëherë që Zoti që është Qenia më e patrupëzuar (El-Letif) dhe gjithashtu Krijuesi i çdo gjëje të patrupëzuar të perceptohet nga sytë tanë fizikë? Kundërshtimi i kritikëve është absurd, që thonë se nuk do të besojmë në Zot përderisa nuk mund ta shikojmë Atë me sytë tanë. Kjo do të nënkuptonte se këta kritikë ose besojnë se Zoti është një qenie e trupëzuar, ose së paku dëshirojnë që Zoti të marrë një trup tillë, të cilin ata ta shikojnë me sytë e tyre.

Por, problemi është se në këtë botë ka miliona njerëz të verbër. Atëherë edhe ata kanë të drejtë të kërkojnë që Zoti duhet të marrë një formë tjetër fizike, e cila mund të preket, nuhatet ose shijohet. A nuk arrin kjo deri në atë shkallë sa të tal-

lemi me Zotin? Sa e turpshme për një njeri që pretendon se ka mendje dhe zemër e që thotë se ne nuk mund ta besojmë Zotin përderisa të mos shohim gjithçka. Mbajeni mend se nëse Zoti do të shihet nga sytë e dikujt, atëherë nuk do t’ia vlente të besojë në Të. Për shembull, Zoti është i patrupëzuar, por në këtë rast Ai do të bëhej i trupëzuar. Zoti është i pakufizuar, por në këtë rast do të bëhej i kufizuar. Për më tepër nëse Zoti do të merrte pamje trupore dhe të kufizuar për botën tuaj, atëherë cila do të ishte garancia se ju nuk do ta kundërshtonit Atë, duke thënë se ju nuk besoni në një Zot të trupëzuar dhe të kufizuar?

O Zot im! Sa të përsosura dhe të patëmeta janë vetitë e Tua! Çdo veti Jote siguron përsosmërinë e vetisë tjetër. ... I mjerë është ai që nuk e kupton këtë të vërtetë, sepse është në prag të shkatërrimit.

Shkurt, madhështia e Zotit qëndron në patrupëzimin dhe pakufizimin e Tij nga shikimi fizik i njeriut. Dhe s’ka vend të dyshohet për qenien e Tij nëse ne nuk e shikojmë, pasi ka edhe mënyra të tjera më të sigurt dhe më bindëse, nëpërmjet të cilave ne mund ta njohim Atë. Pra, o miq të dashur! A do të ndiqni ata njerëz të cilët kanë besuar në fuqinë magnetike, në energjinë elektrike, që u dorëzuan para fuqisë së kohës e të hapësirës dhe u nënshtruan para epsheve ose ndjenjave të tjera, edhe pse nuk i kanë parë me sy, por nuk u bënë gati që ta adhuronin Zotin dhe të përuleshin para Tij. Jo! Ju nuk do të bëni gjëra të tilla!!

PSE DUHET TA KËRKOJMË ZOTIN?

Tani, le të fokusohemi në temën kryesore. Pyetja e parë që neve mund të na dalë është, pse duhet të kërkojmë rreth Zotit? Domethënë, pse duhet të futemi në këtë hetim se a ka Zot apo jo? Atij që mohon qenien e Zotit, deri në një farë mase, është normale që t’i lindë kjo pyetje dhe të mendojë pse duhet të harxhojë kohën dhe aftësitë e tij rreth kësaj çështjeje. Prandaj kësaj pyetjeje duhet t’i përgjigjemi.

Për domosdoshmërinë e të fituarit të njohurive për çdo gjë ne duhet të nisemi nga dy kritere. Së pari, duhet të marrim parasysh se, nëse e përvetësojmë një gjë, a është ajo e dobishme për ne apo jo? Nëse ajo, për shumë arsye, është e leverdishme, atëherë e përvetësojmë atë, përndryshe e lëmë.

Kriteri i dytë që marrim parasysh është se mos ajo gjë është e dëmshme për ne. Nëse dyshojmë se mund të kemi ndonjë pasojë nga ajo, atëherë nuk është e nevojshme që ta marrim atë, përndryshe e marrim. Pra, nëse dihet që një gjë është e dobishme atëherë duhet ta marrim atë dhe nëse ajo është e dëmshme, nuk do ta marrim. Mbi bazën e këtij kriteri vlerësohet edhe shkalla e nevojës dhe e domosdoshmërisë së një gjëje. Domethënë nëse ajo është shumë e dobishme për ne që ta marrim, atëherë ne nuk e lëmë pa e marrë atë dhe anasjelltas.

Tani le ta diskutojmë pyetjen që shtruar më sipër mbi bazën e

këtij kriteri. Me fjalë të tjera, duhet të dimë se; nëse ka Zot a është e dobishme që të besojmë në Të, po ashtu a është e dëmshme nëse nuk do të besojmë në Të? Për të vendosur, duhet të dimë edhe natyrën e kësaj pyetjeje që parashtruar rreth Zotit. Nëse qenia e Zotit na shtrohet para nesh si një tezë apo çështje shkencore, që nuk ndikon në jetën tonë drejtpërdrejt, atëherë ajo u takon vetëm specialistëve të fushës së dijes, dhe të gjithë njerëzit e tjerë kanë të drejtë të mos pranojnë që të futen në këtë hetim dhe ta kufizojnë dijen e tyre deri tek ato gjëra të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre. Për shembull, nëse dikush na njofton se “unë kam zbuluar një yll të ri që është kaq larg nga toka e që nuk ndikon mbi planetin tonë dhe as nuk ka ndonjë lidhje me Sistemin Diellor”, atëherë ky njoftim mund t’u hyjë në punë vetëm atyre që janë dijetarë të fushës së astronomisë, por të tjerëve nuk u intereson fare. Por nëse dikush thotë se “unë kam zbuluar një gjë që i jep njeriut një fuqi të atillë që ia shton moshën në mënyrë jo të zakonshme dhe që pasojat e pleqërisë i shfaqen shumë më vonë”, dhe nëse ai njeri që e ka zbuluar këtë është ndonjë shkencëtar i famshëm, atëherë njerëzit me shumë kënaqësi e dëgjojnë atë.

Nëse ne do të shikojmë Zotin në këtë mënyrë atëherë kjo çështje na shtrohet para nesh

nga tri drejtime. **Së pari**, instinkti ynë na e shtron këtë pyetje. **Së dyti**, e shtron edhe mendja jonë dhe **së treti** na e parashtron edhe feja. Dhe të tria këto na e paraqesin këtë çështje në mënyrë të atillë sa që ne assesi nuk mund t'i shmangemi.

Si fillim unë do të trajtoj fenomenin e instinktit. Çdo njeri që është i aftë të mendojë, dhe veprat e këqija akoma nuk e kanë mbuluar instinktin e

tij me perde të mendjema dhësisë dhe të errësirës, mund të ndiejë se instinkti i tij, herë pas here, e shtyn të mendojë se "ndoshta unë kam një Zot, që më ka krijuar dhe që e kontrollon tërë sistemin e gjithësisë."

Njëkohësisht

na lind edhe mendimi, po që se dikush na ka krijuar dhe ne vetë nuk kemi ardhur në këtë botë, atëherë Krijuesi ynë patjetër duhet të ketë ndonjë qëllim të caktuar në krijimin tonë. Pothuajse, instinkti i çdo njeriu, herë pas here, e nxit atë të bëjë pyetje të tilla. Këtu unë nuk do të përmend se instinkti iu përgjigjet ose jo këtyre pyetjeve, sepse kjo çështje do të diskutohet më vonë. Por, gjithsesi kjo është e vërtetë, se instinkti ynë shpesh na shtron këto pyetje dhe i shtron në atë mënyrë

që ne nuk mund t'u shmangemi lehtësisht. Pasi që mbarojmë hetimet, patjetër ne kemi të drejtë të nxjerrim si përfundim se pyetje të tilla të instinktit janë të pabazuara dhe se nuk ka ndonjë zot dhe i tërë ky sistem i gjithësisë që u krijua vetë dhe po zhvillohet vetvetiu. Por duhet të mendoni mirë se, pasi ju lindën këto pyetje, ju nuk keni asnjë të drejtë të thoni se ne nuk duam

t'u futemi fare këtyre hetimeve.

Ashtu është edhe gjendja e mendimit të njeriut. Edhe mendja, le të shprehet pas hetimeve se nuk ka Zot; por ajo, me ngulm na i shtron neve këto pyetje. Madje, ajo i shtron më qartë dhe me më hollësi se instinkti ynë.

Mendja jonë shpesh na thotë: Kujdes! Shikoje dhe mendoje mirë! A mos ke vallë ndonjë Zot që ty të ka dërguar në këtë botë me një qëllim të caktuar, kurse ti je i pakujdesshëm ndaj qëllimit të Tij dhe në atë gjendje pastaj të vdesësh? Zgjohu! Nëse ka një Zot, atëherë kërkoje! Mendoje mirë se në këtë botë a ke ardhur vetëm sa të hash dhe të pish dhe t'i plotësosh kënaqësitë e tua trupore dhe kur të të vijë vdekja, t'i lësh fëmijët pas që të luajnë në këtë botë të njëjtin rol si ti? Hapi sytë

dhe shiko mirë se a u krijove vetë? I gjithë trupi yt i përsosur dhe i ndërlikuar, a është i vetëkrijuar? E gjithë kjo hapësirë, me kaq përsosmëri, mendon se mund të jetë një ngjarje e rastit? Nëse nuk është kështu, atëherë të gjitha këto i ka krijuar një Zot i Gjithëfuqishëm dhe i Urtë, por a i ka krijuar Ai këto vetëm për lojë dhe dëfrim? Mos ndoshta mendojmë që, Ai, duke parë krijimin e vet të pasosur, sa për argëtim e t'i kënaqë sytë e Tij, t'i japë fund argëtimit të Tij dhe ta zhdukë këtë krijim me një goditje kolosale nga dora e Tij madhështore dhe pastaj të fillojë një lojë tjetër? A nuk ka shumë gjasa që njeriu të jetë krijuar me një qëllim dhe që ai duhet të përgjigjet para dikujt për veprat e tij të kësaj bote? Këto janë ato pyetje të cilat i shtron mendja e çdo njeriu të mençur para vetes së tij. Tani më thoni sinqerisht, a janë këto pyetje të atilla, të cilat duke i quajtur të kota, ju mund t'u shmangeni e të heshtni? Unë nuk ju pyes ju se si do t'ju përgjigjeni këtyre pyetjeve, sepse përgjigjet do të gjenden mbi bazën e hulumtimeve të çdo njeriu, dhe asnjë hulumtues i sinqertë nuk mund të nxjerrë ndonjë përfundim para kohe. Unë dua t'ju them se mënyra sesi ju shtrohen juve këto pyetje, kërkon nga ju që me aftësitë tuaja t'i gjeni përgjigjet e tyre dhe ju nuk duhet të reshtni së kërkuari derisa të arrini të nxirrni një përfundim të sinqertë.

Shkurt, edhe instinkti dhe mendja e njeriut na e paraqesin çështjen e qenies së Zotit në atë mënyrë që ne kurrsesi nuk mund t'i mbyllim sytë pa e zgjidhur atë. A është pa

lidhje për ne pyetja se a ekziston Krijuesi ynë apo jo? A është pa lidhje për ne pyetja se nëse dikush na ka krijuar atëherë kush është Ai? Ku gjendet Ai? Cilat janë atributet e Tij? A është pa lidhje për ne pyetja se nëse dikush na ka krijuar, atëherë cili është qëllimi i krijimit tonë? Si mund të arrihet ai qëllim? Nëse këto pyetje nuk janë pa lidhje për ne, dhe me siguri se nuk janë, atëherë cili i mençur mund të mohojë që t'i kërkojë përgjigjet e tyre?

Në vendin e tretë është feja. Të gjitha fetë që janë në këtë botë, na parashtrojnë çështjen e qenies së Zotit. Për më tepër, në qendër të mësimave të tyre është qenia e Zotit. Fetë, pasi u themeluan, u pranuan nga miliona njerëz të kësaj bote. Burimi i tyre është i njëjtë, Zoti i Lartësuar. Bazën e tyre e kanë pasur tek shpallja Hyjnore, që në çdo kohë ka ndriçuar një botë të madhe. Por, ndonëse mësimet e këtyre feve, për shkak të ndërhyrjes njerëzore, ndryshuan shumë, edhe sot ne mund të gjejmë në to shumë prova dhe sqarime rreth qenies së Zotit të Lartësuar që mund të na bindin dhe që pasqyrojnë zërin e instinktit të njeriut. Domethënë, mesazhin që mbante instinkti dhe mendja, e ka sqaruar shpallja Hyjnore. Madje feja nuk na thotë vetëm kaq, që mund të kemi një Zot, siç na thonë instinkti dhe mendja, por ajo kategorikisht na njofton se në të vërtetë kemi një Zot që është Krijuesi dhe Udhëheqësi ynë dhe që na ka dërguar në këtë botë me një qëllim të caktuar. Fetë e ndryshme të kësaj bote, sado që të jenë kundërthënëse njëra me tjetrën

në mësimet e tyre, kanë një pikë të përbashkët se gjithësia ka një Krijues dhe Udhëheqës, në zotërimin e të Cilit janë edhe jetët tona dhe Ai na ka caktuar një qëllim në këtë jetë dhe Vetë na ka treguar edhe rrugën, nëpërmjet së cilës mund të arrihet ky qëllim. Këto fe na lajmërojnë se jeta jonë nuk mbaron mbas vdekjes por kemi edhe një jetë tjetër pas kësaj, ku njeriu do të shohë vlerësimin e veprave të tij të kësaj bote etj. Kjo dëshmi, që është e përbashkët në çdo fe, çështjen e qenies së Zotit na e parashtron aq fort sa që ne jemi të detyruar ta hetojmë për të arritur në një përfundim. Sepse informacionet që japin këto fe rreth Zotit nëse janë të vërteta, atëherë të qenit i pavetëdijshëm ndaj Tij është humbja më e madhe nga të gjitha ato humbje që mund pësojmë në këtë botë, sepse, duke qenë i paditur rreth qenies së Tij, jeta jonë shkon kot dhe pavlerë. Në anën tjetër, nëse ne e njohim vërtet Zotin dhe lidhemi me Të, atëherë kjo është dobia më e madhe nga të gjitha dobitë që mund të përfitojmë në këtë botë. Sepse njohja e Tij dhe lidhja me Të, do të thotë se, kemi arritur qëllimin e jetës sonë për të cilin ne kemi ardhur në këtë botë. Andaj çështja e kërkimit të qenies së Zotit është shumë e rëndësishme, ndaj së cilës, asnjë njeri i mençur, për asnjë çast, nuk mund të tregohet i pavëmendshëm.

Mbas kësaj dëshmie të përbashkët në çdo fe, unë dua t'ju tregoj edhe mësimet e veçanta të Islamit në lidhje me këtë. Pra, o miq të dashur! Dëgjoni mirë se Islami ju thotë se ju keni një Zot, që është

Krijuesi dhe Udhëheqësi juaj, që ju ka krijuar nga asgjëja dhe në duart e Tij është jeta juaj. Islami ju thotë se Zoti juaj është *Rrab-i* juaj, që do të thotë Ai dëshiron t'ju çojë ju në një pozitë të lartë duke ju pajisur me të gjitha aftësitë e nevojshme për arritjen tuaj deri atje. Islami ju thotë se ju keni një Zot, i Cili është *Rrahman*, (i Gjithëmëshirshëm) që do të thotë, Ai duke i parashikuar të gjitha nevojat tuaja të vërteta, jua ka dhënë Vetë ato, pa qenë nevoja që t'ia kërkoni dhe pa patur nevojë që të mundoheni dhe të lodheni për t'i gjetur ato. Islami ju tregon se keni një Zot, që është *Rrahim*, (Mëshirëplotë) domethënë, Ai ju jep shpërblimet më të mira për përpjekjet tuaja dhe nuk lë asnjë vepër tuaja të sinqertë t'ju shkojë kot. Islami ju thotë se Zoti juaj është *Maliki Jeumiddin* (Sundues i Ditës së Gjykimit), domethënë Ai i vlerëson veprat tuaja. Kur një njeri ecën në rrugën e drejtë, ai shpërblehet me të mirën dhe kur ai shkon në një rrugë të gabuar atëherë atij i duhet të shikojë pasojat e tij, sa të zgjohet dhe mos ta harrojë qëllimin e jetës së tij, të cilin ia ka caktuar Ai. Sepse një ditë ai duhet të paraqitet para Zotit. Islami ju thotë se ju keni një Zot, që është *Gëfurr*, (Mëkatfalës) që do të thotë se kur ju bëni lajthitje ose gabime duke u përpjekur në rrugën e Zotit, Ai jua mbulon ato me mantelin e mëshirës së Tij, dhe duke u kujdesur për përpjekjet tuaja ju shpëton nga pasojat tyre. Islami ju thotë se ju keni një Zot, që është *Teuvab* (Pendimpranues), domethënë, kur ju bëni ndonjë gabim dhe pastaj me zemër të sinqertë pen-


doheni dhe përzemërsisht filloni të përmirësoheni dhe vendosni që mos ta përsërisni atë gabim, madje do ta shlyeni atë me vepra të mira, atëherë edhe Zoti juaj zbret për t'ju ndihmuar dhe duke pranuar pendimet tuaja jua mbulon mëkatit tuaj me mantelin e Tij të faljes. Gjithashtu, Islami ju thotë se ju keni një Zot që është *Kadir* (i Plotfuqishëm), domethënë sado që të jetë e vështirë ose e pamundur diçka për ju, nuk është e pamundur për Atë. Islami ju thotë se Zoti juaj është *Semi*, (i Gjithëdëgjueshëm), domethënë Ai i përgjigjet thirrjes së çdo njeriu dhe nuk ka asnjë zë që nuk arrin tek Ai. Islami ju thotë se Zoti juaj është *Elim*, (i Gjithëdijshëm), domethënë asnjë fjalë ose asnjë gjë, e mbuluar apo e zbuluar, nuk është e fshehur për Të. Islami ju thotë se Zoti juaj është *Nasir* (Ndihmëtar), domethënë ju ndihmon në të gjitha kohët e vështira dhe në krizat tuaja të rënda, me kusht që edhe ju të keni një lidhje të sinqertë me Të. Islami ju thotë se Zoti juaj është i Amshueshëm, domethënë, Ai s'ka fillim dhe s'ka mbarim dhe koha nuk mund ta ndikojë Atë. Islami ju thotë se Zoti juaj është *Xhemil* (i Bukur), Ai është përmbledhja e të gjitha bukurive dhe vetëm Ai është i denjë që ju t'i paraqisni lulet tuaja të dashurisë në këmbët e Tij. Islami ju thotë se Zoti juaj është *Vadud*, (i Dashuruar) domethënë Ai i do robërit e Tij dhe në veçanti ata që lidhen me Të, i do më shumë se të gjithë dashuruarit e tyre dhe tregohet besnik ndaj tyre nga të gjithë besnikët e tjerë. Islami ju thotë se ju keni një Zot, që është *Mukellim*, (Gjithëfolës), domethënë

Ai i shpërblet ata që janë të lidhur me Të edhe me fjalët e Tij Hyjnore. Dhe meqenëse ai është i Patrur, Ai nuk shihet nga sytë fizikë, por Ai u spërkat sherbetin e fjalëve të Tij të dashurve, që mos të bëhen ato zemra hi nga zjarri i dashurisë, të cilat janë të përflakura me dashurinë e Tij. Sa bukur e ka shprehur Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.}, themeluesi i Xhematit Mysliman Ahmadia (në një poezi të tij):

Po të mos e kisha mirësinë Tënde, unë do të kisha vdekur dhe isha bërë dhé,

Pastaj, vetëm Zoti e di se ku do të ishte hedhur ky pluhur.

Të dashur miq! Ky është Zoti që paraqet Islami. Momentalisht, unë nuk do t'ju them të besoni në Të, por do t'ju them patjetër se Islami thotë se ju keni një Zot, që ka këtotribute dhe ai gjithashtu thotë se ju, duke u përpjekur, mund ta gjeni Atë. A mund të thoni së përpjekjet për ta gjetur Atë janë të kota dhe nuk ju interesojnë? Nëse ju keni mendjen dhe zemrën e ndershme e të ndjeshme, atëherë kurrsesi nuk mund ta konsideroni të kotë këtë kërkim. O të dashur! Zgjohuni dhe nisuni në kërkimet e këtij Zoti. Zgjohuni dhe vraponi drejt atij burimi, i cili është burimi i jetës suaj. Zgjohuni dhe nxitohuni për të kapur atë thesar, i cili do t'ju lirojë nga varësitë e botës. Nuk kam mundësi që t'ua përshkruaj me fjalë se çfarë mund të arrini nëse e gjeni Atë. Dëgjoni fjalët e bekuara të Hazret Mesihut të Premtuar a.s. Ai (në një poezi të tij) thotë: ►



Ty të takojnë të gjitha fuqitë e aftësitë, o Zot!
Nëse të gjej Ty, e gjej çdo dëshirë.

Çdo dashurues ka krijuar një idhull
Por në zemrën time banon vetëm Ti, o i Dashur.

Ti je rehati e shpirtit tim e zemrës sime i pëlqeve vetëm Ti
Vetëm Ti je Krijuesi i të gjitha krijesave.

Ti m'u shfaqe mua Vetë,
I Shenjtë je Ti, që poshtërove armiqtë e mi.

Unë kam lidhje jetësore me Ty, o i Dashur,
Vetëm Ti je parajsja ime, vetëm Ti je shtëpia e paqes sime.


S'kam fuqi si të shpjegoj rreth Teje
Veç po rrjedh një lumë i dashurisë.

Ç'favore të mëdha më dhe Ti, o Udhëheqësi im!
I Shenjtë je Ti, që poshtërove armiqtë e mi.


Nuk ka asnjë mangësi në mëshirën Tënde
Në asnjë çast nuk më mungon.

S'mundem të numëroj mëshirën dhe bekimet
Unë s'kam më fuqi të të falënderoj Ty.

Ç'favore të mëdha më dhe Ti, o Udhëheqësi im!
I Shenjtë je Ti që poshtërove armiqtë e mi.




Nëse ju do të humbisni në këtë kërkim, atëherë vetë humbja juaj do të provojë që jeta juaj s'ka ndonjë qëllim. Sepse ajo që ndodh rastësisht, nuk mund të ketë ndonjë qëllim. Në këtë rast, të paktën ju do të keni kaluar jetën tuaj të paqëllimtë për t'ia gjetur ndonjë qëllim. Por prapë, kjo humbje a nuk do të ishte më e vlefshme se të gjitha ato fitore, të cilat ju do t'i gjenit pa ndonjë qëllim në jetën tuaj të paqëllimtë? Por unë ju siguroj se ju kurrësi nuk mund të humbni në këtë kërkim. Ju nisuni për këtë punë me singëritet, me dashuri të përzemërt e me gjithë përkushtim dhe ju do të shikoni që flladi i këndshëm i suksesit do t'ju përqafojë duke ju mirëpritur. Vallë, sikur të keni dëgjuar zërin e Mesihut të Premtuar a.s.!:



Kush të ka thirrur Ty në këtë botë
Dhe pastaj u kthye duarbosh, i mjerë!


Sa i sigurt është ai atëherë
Që Ti je më i Dashuri i tij!



Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për të mençurit, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjgur dhe shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (dhe thonë:) "O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë!) Prandaj ruana nga ndëshkimi i zjarrit."
(Kurani Famëlartë 3:191-192)



Dëgjoni Ajshtajnin!



Albert Ajshtajin
14 mars, 1879 - 8 prill, 1955

Dr. Albert Ajshtajin (Albert Einstein) është një nga shkencëtarët më të mëdhenj të shekullit të njëzetë. Me 1921 mori çmimin Nobel në fushën e fizikës. Dr. Infeld, që kishte rastin të punonte me të, shkruan për Ajshtajnin si më poshtë:

Kur ai kishte një ide të re, ai pyeste veten: A mundet Zoti të ketë krijuar botën në këtë mënyrë? Apo: A është kjo strukturë matematikore e denjë prej Zotit?

(Pyetje. nga Leopold Infeld, f. 212)

I ngazëllyer nga bukuria dhe madhështia e universit dhe mençurisë së thellë që gjendet në themel të tij, Ajshtajni thotë:

Emocioni më i bukur dhe më i thellë që ne mund të përjetojmë është ndjesia e mistikës. Është mbjellësi i gjithë shkencës së vërtetë. Ai, te i cili ky emocion është i panjohur, që nuk mund të habitet më dhe të qëndrojë i mahnitur në frikë e nderim, është pothuaj i vdekur. Të njohësh që ajo çka është e padepërtueshme te ne, ekziston realisht, duke u shfaqur si mençuria më e lartë dhe bukuria më rrezatuese që vetitë tona të topitura të mund të kuptojnë vetëm në format e tyre më primitive të kësaj njohje, kjo ndjenjë është në qendër të gjithë besimtarisë.

Feja ime konsiston në një admirim të përlulur të një shpirti superior e të pakufizuar, që shfaqet në detaje të imta që ne jemi në gjendje të perceptojmë me mendjet tona të brishta dhe të dobëta. Kjo bindje thellësisht emocionale e pranisë së një fuqie të arsyeshme superiore, që është nxjerrë në shesh, në universin e pakuptueshëm, formon idenë time të Zotit.

("The Universe and Dr. Einstein", nga Lincoln Bsrnett, f. 118, Mentor, 1950)

Hazret Ibni Umeri r.a. thotë:
Kur myslimanët erdhën në Medinë, ata tuboheshin me vështirësi për faljen e namazit, sepse nuk thirrej për të. Ata një ditë diskutuan rreth kësaj dhe disa thanë të merrej kambana ashtu siç është te krishterët!, ndërsa të tjerët sugjeruan, të merrej buria ashtu siç është buria e hebrenjve. Atëherë Umeri tha ‘Pse nuk e caktoni një njeri që të ftojë për në namaz’. Pastaj i Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: “O Bilal, ngrihu dhe thirr për namaz.”

[Buhariu, libri i ezanit, kap. Fillimi i ezanit, hadithi 604]

Në ditët e konsultimeve për mënyrën e lajmërimit të kohëve të faljes, Ebu Abdullah bin Zejdi kishte parë në ëndërr se një njeri sillet rreth tij me kambanë në dorë dhe ai e pyeti:

- O rob i Zotit, a do të më shesësh atë kambanë?

- Ç’do të bësh me këtë? Pyeti ai.
- Duke i rënë kambanës, ne do të lajmërojmë për faljen e namazit me xhemat.

- A të tregoj diçka më të mirë se kjo? – tha ai.

- Sigurisht – u përgjigja.

Atëherë ai më shqiptoi: “Allahu ekber, katër herë; esh-hedu en-la ilahe il-lal-llah, dy herë; esh-hedu enne Muhamederr resulullah, dy herë; hajje eles selaah – dy herë; hejje el el felaah, dy herë; Allahu ekber, një herë; La ilahe il-lal-llah, një herë.

Pastaj tha: “Kur të duash të falësh namazin, (bëhet fjalë për ikametin) këndo: “Allahu ekber” dy herë, fjalitë e tjera nga një herë dhe në fund “Allahu ekber” dy herë.

Fillimi i ezanit në Islam

اللَّهُ اكْبَرُ اللَّهُ اكْبَرُ
اللَّهُ اكْبَرُ اللَّهُ اكْبَرُ

اشْهَدُ اِلَّا اِلَهَ اِلَّا اللهُ
اشْهَدُ اِلَّا اِلَهَ اِلَّا اللهُ

اشْهَدُ اَنَّ مُحَمَّدًا رَّسُولُ اللهِ
اشْهَدُ اَنَّ مُحَمَّدًا رَّسُولُ اللهِ

حَيَّ عَلَى الصَّلَاةِ
حَيَّ عَلَى الصَّلَاةِ

حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ
حَيَّ عَلَى الْفَلَاحِ

اللَّهُ اكْبَرُ اللَّهُ اكْبَرُ
لَا اِلَهَ اِلَّا اللهُ

Të nesërmen Ebu Abdullah bin Zejdi ia tregoi Profetit të shenjtë s.a.v.s. ëndrrën e tij, e ai i tha “Ajo ëndërr, dashtë Allahu, do të jetë e vërtetë. Mësoji Bilalit atë që ke parë dhe ai ashtu do të këndojë ezanin, sepse ai ka zë më të bukur se ti.” Bilali pasi që e mësoi tekstin e lartpërmendur, e thirri ezanin. Kur Umer bin Hat-tabi dëgjoji ezanin në shtëpinë e tij, ai, me pallto të hedhur krahëve, nxitoi për të ardhur në xhami dhe i tha Profetit të shenjtë s.a.v.s. “O i Dërguar i Allahut! Pasha Atë, i Cili të ka dërguar me të vërtetën, edhe unë kam parë në ëndërr një tekst të tillë.”

- Lavdi Allahut – tha Pejgamberi s.a.v.s.

[Tirmidhi, Ibne Maxhe, Muvetta Ahmad bin Hanbal]

Në përmbledhjen e haditheve Ebu Davud shtohet:

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. mendonte për mënyrën e thirrjes, që njerëzit të mblidheshin për faljen e namazit me xhemat. Disa sugjeruan nxjerrjen e flamurit, të tjerët për t’i rënë borisë dhe dikush për t’i rënë kambanës. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. nuk e pëlqeu asnjë prej tyre. Në këtë diskutim i pranishëm ishte edhe Abdullah bin Zejdi, i cili gjithashtu mendonte për mënyrën e mbledhjes së myslimanëve për kohën e faljes. Ai nën ndikimin e këtyre mendimeve ra në gjumë, ku pa një ëndërr. Në këtë ëndërr iu tregua teksti i ezanit, të cilin të nesërmen ai ia tregoi Profetit të shenjtë s.a.v.s.

Umerit në të njëjtën mënyrë i ishte kallëzuar teksti i ezanit para njëzet ditësh, por ai nuk ia paraqiti askujt dhe kështu ia kaloi këtë Abudullah bin Zejdi.

[Sunen Ebu Davud]



E ARDHMJA e shoqërisë PERËNDIMORE

Pyetje:

Si e shikoni të ardhmen e shoqërisë perëndimore, nga pikëpamja juaj fetare?


Përgjigje:

Kjo është një pyetje shumë interesante për të cilën i gjithë njerëzimi duhet të jetë i interesuar më seriozisht se sa është aktualisht. Është fakt se kërkimi i kënaqësisë dhe ndjenja e lirisë së bashku, e kanë bërë shoqërinë perëndimore

ajo që është sot. Liri nga çfarë? Liri nga të gjitha detyrimet që lidhin njeriun me Krijuesin e tij. Kjo është ajo çka unë shikoj në konceptin perëndimor të lirisë sot. Liri nga gjithçka që është fisnike, që të jep përgjegjësi, që të lidh ty dhe që t'i kufizon rrugët e tua të kërkimit të kënaqësisë.

Kjo është liria që Perëndimi ka arritur sot dhe që ende po kërkon; një kërkim i çmendur i kënaqësisë pa marrë parasysh se ku ju çon ai,

Kjo është ajo çka unë shikoj në konceptin perëndimor të lirisë sot. Liri nga gjithçka që është fisnike, që të jep përgjegjësi, që të lidh ty dhe që t'i kufizon rrugët e tua të kërkimit të kënaqësisë. Kjo është liria që Perëndimi ka arritur sot dhe që ende po kërkon; një kërkim i çmendur i kënaqësisë pa marrë parasysh se ku ju çon ai, duke harruar se nuk ka mundësi për njeriun të ketë gjithçka që ai kërkon dhe në çfarëdo mase që ai dëshiron t'i ketë ato.



Hazret Mirza Tahir Ahmadi ^{r.t.a.}
– Kalifi i Katërt i Mesihut të Premtuar

(Ky është transkriptim i një pyetje-përgjigje sesioni të mbajtur nga Hazret Mirza Tahir Ahmadi r.t. Kalifi i Katërt i Xhematit Mysliman Ahmadi me 30 shtator të vitit 1983 në West Ferry të Australisë)

duke harruar se nuk ka mundësi për njeriun të ketë gjithçka që ai kërkon dhe në çfarëdo mase që ai dëshiron t'i ketë ato.

Njeriu ka lindur me aftësi të kufizuara dhe burime të kufizuara. Ai ka lindur me imaginatë të kufizuar dhe arritje të kufizuar. Kështu që, është e pamundur për njeriun të arrijë kënaqësi të pakufizuar, siç e dëshiron ai me atë lloj rezultati, që më shpesh se kurrë, disa rrugë përfundojnë me

asgjë. Pas kërkimeve të çmendura të dëshirave materiale, ka mbetur vetëm ndjesia e një veljeje, që ka efekte të tjera anësore të dëmshme, ndaj dhe shoqëria po bëhet gjithnjë e më e shqetësuar.

Do ta shpjegoj këtë: në shoqëritë orientale, për shembull, veçanërisht ato nën ndikimin e fesë myslimane, gratë dhe burrat në përgjithësi janë të veçuar dhe atje, ekzistojnë mësimet për të kontrolluar, në një farë mase rrjedhën e

veprimtarisë seksuale midis burrave dhe grave. Si me telat me rrymë të elektricitetit, poli negativ është me ngarkesë të ndryshme nga ngarkesa e polit pozitiv. Nëse nuk ka veçim midis tyre, çfarë do të ndodhë? Rrjedha e energjisë, në vend që të marrë kursin më të vështirë dhe të kalojë nëpër disa makineri dhe aparate për ta arritur qëllimin e saj, do të bëjë një qark të shkurtër dhe do të shkatërrojë veten.

Kështu, Islami i shikon nxitjet njerëzore me dëshirën për t'i shfrytëzuar ato dhe për t'i vënë ato në dobinë e duhur. Islami beson se nëse jepet liri e pakufizuar, nxitjet dhe dëshirat do të "shpërthejnë" dhe do t'i shkatërrojnë kërkuesit e kënaqësisë.

Në kontrast, në shoqëritë ku zonjat mbahen të veçuara, vetëm një shikim për një çast i një fytyre të bukur jep kënaqësi të tillë të njerëzit e kësaj shoqërie, që juve nuk mund t'ju japë në ditët e sotme një person i/e zhveshur lakuriq, sa do i/e bukur që të jetë ai/ajo, ju jeni të mësuar tashmë me gjithnjë e më shumë lakuriqësi. Ndërsa ju avanconi në një gjendje kënaqësie, ju ndjeni gjithnjë e më pak kënaqësi, siç ndodh me alkoolin. Gllënjka e parë e alkoolit jep një kënaqësi të madhe tek ata që e përdorin atë për herë të parë, por pastaj, gradualisht përdoruesit arrijnë relativisht më pak kënaqësi. Ata bëhen përdorues gjithnjë e më të mëdhenj, deri sa bëhen alkoolistë. Alkooli pastaj bëhet vetë një burim sëmundjeje se sa një burim kënaqësie.

Kjo është saktësisht ajo që ka ndodhur te shoqëria perëndimore,

në kërkim të kënaqësisë. Ata shpikën mënyra të reja në emër të lirisë, në emër të emancipimit nga të gjitha mendimet e vjetra. Por ku kanë përfunduar ata?

Unë e kam studiuar shoqërinë amerikane. Për shembull: Ajo që ka ndodhur atje ishte, se pas pak kohe ata filluan të shpiknin mënyra të reja të kënaqësisë. Gjithë revistat iu kushtuan këtyre gjërave; gjithë studimet psikologjike u preokupuan me këto gjëra. Në emër të shkencës ata u thanë njerëzve të kërkonin kënaqësi në drejtime të ndryshme – të shkonin në sadizëm, të shkonin në këtë, të shkonin në atë, të lejonin homoseksualitetin, për të lejuar çfarëdo lloj shpërftyrimi që njeriu mund të mendojë dhe t'i sjellë kënaqësi. Atyre iu thanë se nuk ka dëm, nuk ka tabu – ky ishte mesazhi i shoqërisë moderne – dhe ata e realizuan atë! Por në çfarë mase? Ata gjithmonë gjetën një fund të verbër ndaj çdo mënyre që ata ndoqën. Rrjedhimisht, një lloj çmendurie filloi të zërë vend në shoqëri. Ata ndoqën bohemianizmin; ata eksperimentuan hipizmin [hipitë]; nganjëherë ata qethin kokat, thjesht për të arritur një kënaqësi nga jeta. Dhe kjo kënaqësi filloi të dështonte pas pak kohe. Disa njerëz filluan të përdorin droga dhe i kërkonin ato kudo që mund t'i gjenin. Megjithatë, nuk ishte e mundur që tërë vendi të lejohej e të jepej pas drogës, kështu që, qeveria ushtroi forcën e saj pas një farë tolerimi dhe lufta vazhdoi dhe përfundimisht këta të droguar e fituan atë. Tani shoqëria amerikane është plotësisht pa përkrahje dhe

në duart e njerëzve të mafias. Krimi u bë i shfrenuar në një shkallë të atillë sa që njerëzit që kërkonin një kënaqësi, do të vrisnin thjesht për hir të trillit të tyre.

Në Amerikë, kur unë isha atje pak vite më parë, ishte një stacion radioje i kushtuar tërësisht njoftimeve të vrasjeve dhe thuhej se mesatarisht çdo pesë minuta, bëhej një vrasje. Njerëzit grabiteshin dhe vriteshin, jo për arsye të urisë, e as për arsye nevojash të jetës, por thjesht për argëtim të njerëzve të mafias. Ata kërkonin kënaqësi kudo ku mund ta gjenin atë. Kjo është sëmundja e shoqërisë. Në emër të lirisë, ata vihen në pranga dhe prej tyre (për fat të keq) nuk do të çlirohen më kurrë.

Këta njerëz ecin drejt shkatërrimit përfundimtar, sepse ky kërkim, ky kërkim i çmendur i kënaqësisë, i ka bërë ata plotësisht "të pavarur sipas mendimit të tyre" nuk them "të pavarur" por më saktë "të pavarur sipas mendimit të tyre" nga Zoti.

Dëshiroj të bëj një dallim të qartë ndërmjet kuptimit të fjalëve "të pavarur" (independent) dhe atij "të pavarur sipas mendimit të tyre" (undependent). Askush nuk mund të jetë i pavarur nga Zoti, por disa njerëz mund të mendojnë se ata nuk janë të varur më prej Tij, kështu që,

për ata unë përdor fjalët "të pavarur nga askush" (undependent). Këta nuk kanë nevojë më për ndonjë Zot dhe materializmi i tyre po i udhëheq në shkatërrim të mëtejshëm. Ata po luftojnë për një betejë të humbur. Kërkimi i kënaqësisë që ata kanë adaptuar tashmë ka arritur në fund, dhe në vend të kënaqësisë po u jep atyre tashmë trishtim dhe asgjë tjetër.

Kënaqësia e vërtetë, kënaqësia e qëndrueshme, lumturia e vërtetë dhe përmbushja e saj, mund të zotërohet duke vendosur marrëdhënie të secilit me Krijuesin e tij. Kjo është ajo për të cilën është krijuar njeriu. Shoqëria ka humbur drejtimin. Njeriu i ka humbur koordinatat e orientimit. Ai ka humbur qëllimin e krijimit të tij. Kështu që, përse Zoti duhet të interesohet ende për shpëtimin e njeriut, kur ai nuk i shërben qëllimit të krijimit të tij?

Në Amerikë, për shembull, kanë lindur sëmundje të reja veneriane për të cilat mjekët nuk e kishin idenë më parë. Ato po përhapen me shumë shpejtësi dhe janë kaq rezistente ndaj çdo gjëje që njeriu mund të përdorë kundër tyre, sa që ato kanë dalë plotësisht jashtë kontrollit. Po flas për urdhjen që është e lidhur me ndonjë sëmundje veneriane dhe tani, sipas

fakteve të fundit dhe shifrave të publikuara nga Departamenti Amerikan i Shëndetit, 30% e popullsisë amerikane vuan nga urdhja dhe në një fazë tjetër, këta të sëmurë mund të arrijnë në 60% - dhe më pastaj, kjo sëmundje mund të përfshijë tërë shoqërinë. Pra kjo do të thotë se kërkimi i kënaqësisë është bërë një burim terrori për ta. Asnjë amerikan nuk mund të ndihet i

sigurt në shoqërinë e një amerikani tjetër, sepse ai nuk e di kur dhe si mund ta marrë këtë sëmundje, që po i torturon dhe po i çmend ata, që luan me nervat e tyre.

Kjo është gjendja kritike e gjërave që njerëzit nuk dëshirojnë ta shikojnë. Gjithçka që transmetohet në televizion, kudo, janë lodra dhe vallëzim i çmendur dhe shfaqje të bukurisë. Nuk më duhet t'jua shpjegoj këto gjëra juve, sepse ju mund t'i shpjegoni këto më mirë vetë. Nuk kam shumë përvojë në këto gjëra, por po përpiqem t'jua tregoj juve vetëm atë që kam parë këtu. Thjesht për t'u treguar drejtimin e këtyre gjërave këta shembuj janë plotësisht të mjaftueshëm.

Pra, cila është përgjigja? Përgjigja e vetme është kjo: kënaqësia e vërtetë, kënaqësia e qëndrueshme, lumturia e vërtetë dhe përmbushja e saj, mund të zotërohet duke vendosur marrëdhënie të secilit me Krijuesin e tij. Kjo është ajo për të cilën është krijuar njeriu. Shoqëria ka humbur drejtimin. Njeriu i ka humbur koordinatat e orientimit. Ai ka humbur qëllimin e krijimit të tij. Kështu që, përse Zoti duhet të interesohet ende për shpëtimin e njeriut, kur ai nuk i shërben qëllimit të krijimit të tij? Gjithçka është krijuar për një qëllim të caktuar dhe sipas Kuranit të Shenjtë njeriu është krijuar për t'u njohur me Zotin e tij.

Në stadet e mëparshme të jetës asnjë kafshë nuk ishte aq e zhvilluar sa të kuptonte gjërat që vetëm njeriu mund t'i kuptojë. Specia e parë që mundi të vinte në kontakt

me Krijuesin e saj, ishte në formën e njeriut, domethënë kontakti i drejtpërdrejtë dhe i ndërgjegjshëm. Ja se çfarë na thotë Kurani i Shenjtë: të ndjekim këtë qëllim, të arrijmë Zotin sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të qëndrojmë me Të; të jetojmë me Të; të ndiejmë afërsinë e Tij; e kështu me radhë. Kurani i Shenjtë na mëson se kjo është përmbajtja e kënaqësisë, kjo është kënaqësia. Ai na mëson gjithashtu se duke jetuar pranë Zotit ju bëheni fisnikë, sepse Ai është Fisnik.

Mënyra e vetme për të përmirësuar një shoqëri është duke e sjellë këtë shoqëri më pranë Zotit, sepse Zoti u përket të gjithë njerëzve, të çdolloj ngjyre qofshin ata. Kështu që, ata që i përkasin Allahut kanë dhembshuri për të gjithë njerëzit. Ata nuk bëjnë dallim midis të bardhëve dhe të zinjve, midis jugorëve dhe veriorëve, midis perëndimorëve dhe lindorëve, sepse ata i përkasin Zotit. Kështu që mënyra e vetme për të edukuar njerëzimin është të kthehet te Zoti. Ky është mesazhi im për ju, bëjeni atë tashti, sa më shpejt që të jetë e mundur!

Unë shikoj gjithashtu një betejë të humbur në këto pak ditë që kam qenë edhe në Australi. Por nuk e kam humbur shpresën, sepse nuk është në natyrën e njeriut ta humbasë atë për aq kohë sa ai mund të lutet; për aq kohë sa Allahu mund të na dëgjojë me mëshirë, ne nuk mund ta humbasim shpresën aspak, por gjërat janë në gjendje shumë të keqe për të thënë më të paktën.

JANAR - PRILL 2010

Dashuri për të gjithë

Xhamia e parë e Xhamatit Mysliman Ahmadia në Berlin

Ndërtuar vetëm nga sakrificat e grave ahmadiane


Xhamia Khadixha është ndërtuar nga gratë ahmadiane që kontribuan një milion e shtatëqind mijë euro (1,700,000.00 €).

Kjo xhami u përrua nga Hazret Mirza Masroor Ahmadi, Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar (*Allahu e ndihmoftë fuqimisht*) më 17 tetor, të vitit 2008. Ai, në fjalimin e tij, thotë:

“Është një gjë shumë e çuditshme që sot kur bota po pëson një rënie të madhe në ekonominë e saj, çmimet po rriten në gjithë Evropën, megjithëkëtë Allahu i Madhëruar i mundësoi gratë ahmadiane për këtë sakrificë të madhe dhe pastaj Ai ua mundësoi edhe suksesin e sakrificës së tyre, rezultatin e së cilës ne po e shikojmë sot. Allahu i Madhërishëm i shpërbleftë në mënyrë të panumërt këto sakrificëbërëse. Ua shtoftë pasuritë dhe njerëzit. Këta shembuj ne shikojmë në gjithë botën. Ahmadianët, burra dhe gra, përparojnë e konkurrojnë në bërjen e sakrificave, që njeriu mahnitet nëse i shikon.”

(Fjalimi i së premtës i Hazret Kalifit të Pestë, më 17 tetor, 2008, Berlin)

Xhamia KHADIXHA^{r.a.}



Sipërfaqja e tokës: 4790 m²

Sipërfaqja e ndërtesës: 1008 m²

Lartësia e mineresë: 13 m. urrejtje për askënd

Fjalimi i Hazret Mirza Masroor Ahmadit (Allahu e ndihmoftë fuqimisht), Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar më 19 dhjetor të vitit 2009, gjatë një pritjeje VIP, të organizuar në Ratskeller am Romer, me rastin e pesëdhjetëvjetorit të xhamisë “Nur”, Frankfurt të Gjermanisë.

Të nderuar miq,

Es-salam alejkum va rrahmatullah

paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!

Së pari, do të doja të falënderoja të gjithë miqtë që erdhën sot për të marrë pjesë në pesëdhjetëvjetorin e xhamisë “Nur”, që ndodhet këtu në Frankfurt. Fakti që jeni prezentë këtu tregon qartazi që jeni njerëz mendjegjerë. Ju erdhët këtu

edhe pse, sot në shoqëri, ka një propagandë anti-islamike, jo vetëm kundër myslimanëve por kundër gjithë fesë islame. Dhe pasi kam dëgjuar fjalimet e të gjithë miqve të nderuar, jam akoma më i bindur që mendimi im është shumë i drejtë që ju të gjithë që jeni ulur këtu, jeni mendjegjerë. Gjithsesi, kjo fushatë nga kundërshtarët e Islamit, tregon Islamit si një fe ekstremiste, gjë që është shumë larg nga mësimet e vërteta të Islamit.

Njerëzit që nuk e njohin Islamit, kur dëgjojnë deklarime të tilla dhe dëgjojnë lajme për terroristë, kamikazë myslimanë që kanë një besim fanatik e të ashpër, ata fillojnë të besojnë që vërtet Islami është një fe që nxit terror dhe që myslimanët ndjekin urrejtje dhe çdo jomusliman e konsiderojnë të pavlefshëm. Për më tepër, ata besojnë se në të vërtetë janë mësimet e fesë islame që kërcënojnë paqen globale. Por, jam i gëzuar kur shoh që ata që janë këtu, nuk e kanë këtë mendim. Por ka një numër të paktë njerëzish që ende janë të këtij mendimi. Fatkeqësisht, gjithë ky nocion i gabuar është rrënjësor thellë. Sidoqoftë, unë do të qartësoj këtu disa nga keqkuptimet e tilla,

në përputhje me mësimet e vërteta të Islamit.

Sikundër thashë pak më parë, fakti që jeni këtu pavarësisht nga akuza të tilla kundër fesë islame, provon që ju nuk dëgjoni vetëm nga një këndvështrim, por duke respektuar kërkesat e drejtësisë dhe të paanësisë, erdhët për të parë se çfarë thotë Xhemati Mysliman Ahmadi për mësimet e Islamit.

Unë gjithmonë kam thënë se nuk ndihem i turpëruar duke pranuar se disa grupe ekstremiste “myslimane” kanë bërë shumë rrëmujë në botë. Megjithatë, kjo mungesë paqeje ekziston më shumë se kudo në vendet e atyre myslimanëve

Duke vendosur paqe ndërfetare



Xhamia Nur, në Frankfurt të Gjermanisë

sesa në Evropë apo diku tjetër në botë. Kjo ilustron shumë qartë që kjo betejë nuk është kundër ndonjë feje të caktuar, por është veprimtari e një grupi të vogël njerëzish që nuk i shërbejnë askujt tjetër përveç vetes dhe që krijojnë çrregullim dhe sulmojnë me etiketën e fesë. Nëse do ta analizoni situatën e sotme, do të kuptoni se këta njerëz, që punojnë vetëm për interesat e tyre, më shumë kanë vrarë myslimanë, sesa njerëz që u përkasin feve të tjera. Ndër jomyslimanët, që po vriten, janë ata që u dërgojnë trupa ushtarakë vendeve myslimane, gjoja për të vendosur paqe atje.

Nuk dua të bëj koment nëse asistenca ushtarake (në ato vende) është e drejtë apo jo, ose nëse vlerësimet e

vendeve perëndimore në lidhje me planet e ardhshme të terroristëve janë të shëndosha. As nuk dua të komentoj mbi pozitën strategjike të Pakistanit, Afganistanit dhe Irakut apo nëse terroristët po përpiqen t'i mbizotërojnë këto vende, apo atë që zgjidhja përfundimtare duhet të jetë lufta kundër terrorizmit. Të gjitha këto janë çështje të veçanta mbi të cilat nuk kam ndërmend të flas këtu. Megjithatë, si Kryetar i Xhematit Mysliman Ahmadia, unë do të doja të heq keqkuptimet e ngritura rreth Islamit, në dritën e mësimeve të tij të vërteta dhe t'ju paraqes fytyrën e bukur dhe reale të Islamit, siç e shohim ne.

Tani, do t'ju tregoj disa shembuj të mësimeve të fesë islame që janë për-

mendur në Kuranin Famëlartë lidhur me vendosjen e paqes globale.

Nëse ne do të shikojmë arsyet themelore për armiqësi fetare që lind në zemrat e ndjekësve të feve të ndryshme, ndër më kryesoret janë kur njerëzit mohojnë e refuzojnë themeluesin e fesë së tjetrit duke e konsideruar atë gënjeshtar dhe e përbuzin atë, rrjedhimisht, tallen edhe me ritet dhe ritualet e fesë së tij përkatëse.

Le të shohim se çfarë na mëson Islami në lidhje me profetët apo themeluesit e të gjitha feve. Në surenë 3, ajetin 85, Kurani i Madhërishëm deklaron:

Thuaj (o Muhamed): "Ne besojmë Allahun, atë që na është shpallur neve, atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit, dhe bijve të tij dhe në atë që i është dhënë Musait, Isait dhe profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë asnjë dallim midis tyre dhe Ne vetëm Atij (Allahut) i përulemi."

Ky është mësimi i bukur i Islamit.

Një mysliman që i bindet Allahut, detyra e tij kryesore është të besojë në të gjithë profetët, në atë masë për të cilën Allahu i Madhërishëm thotë në Kuranin Famëlartë, që Ai ka dërguar te çdo popull të dërguar të Tij, të cilët reformuan popujt e tyre. Gjithashtu Kurani sqaron se ai përmend vetëm disa prej tyre. Kështu që, Islami ka vënë gurthemelin për paqe, harmoni dhe pajtim, duke i bërë të gjithë themeluesit e feve të botës të denjë për t'u respektuar.

Nëse do t'i hedhim një vështrim historisë së hershme të Islamit, do të shohim që myslimanët u detyruan të mërgonin nga Meka

në Medinë për shkak të mizorisë së ashpër të mekasve. Myslimanët e gjerë u ndoqën dhe u përndoqën edhe në Medinë nga jobesimtarët e Mekës, pasi ata kishin vendosur t'i shfarosnin me çdo kusht. Vetëm atëherë, Allahu i Madhërishëm i dha leje Profetit Muhammed s.a.v.s. dhe ndjekësve të tij për të mbrojtur veten e tyre. Kjo gjithashtu është përmendur në ajetet 40 e 41, në surenë 22 të Kuranit të Shenjtë. Përkthimi i tij është në vijim:

"Atyre që janë sulmuar, u lejohet (që të mbrohen), sepse u është bërë padrejtësi. Në të vërtetë Allahu është i Fuqishëm që t'i ndihmojë ata, që janë dëbuar nga shtëpitë e tyre padrejtësisht, vetëm sepse thanë: "Zoti ynë është Allahu." Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t'u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut. Vërtet, Allahu e ndihmon atë që e ndihmon Allahun. Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm." (El-Haxh 22:40-41)

Pra, sikundër dëgjuat, kjo nuk është vetëm e drejta e fesë islame që myslimanët janë urdhëruar jo vetëm për të mbrojtur të drejtat e tyre, por ata, në fakt, janë urdhëruar t'i çrrënjoshin qëllimet djallëzore të atyre që adhuronin dikë tjetër në vend të Allahut, ndërkohë situata ishte nëse myslimanët nuk do të merrnin këtë hap, armiqtë ishin të gatshëm t'i zhduknin të gjitha fetë e tjera.

Myslimanët ishin urdhëruar ta mbronin shenjtërinë e faltoreve të të gjitha feve. Ata gjithashtu ishin urdhëruar që nëse fe të

tjera do të jenë në nevojë për këtë qëllim, ata duhet t'i ndihmojnë. Nëse ju do të veproni sipas dëshirës së Zotit, edhe Ai do t'ju ndihmojë ju.

Allahu i Madhërishëm e sqaron që në krye se për të ndaluar mizorinë e keqbërësve, luftoni kundër tyre nëse duhet; dhe ndihma e Zotit do të jetë me ju. Historia dëshmon për këtë fakt. 313 *shahabët* e Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s. të paarmatosur ranë në luftë kundër ushtrisë së jobesimtarëve të armatosur mirë dhe e fituan luftën, ndërkohë trupat e ushtrisë së jobesimtarëve ishin tri herë më shumë se myslimanët. Me të vërtetë kjo ishte dëshmi e qartë se Zoti e përkrah të vërtetën. Çdo mysliman që vepron kundër mësimëve të sapopërmendura, vepron kundër urdhrave të Zotit.

Pasi i dëgjuat këto mësimet të Kuranit, vendosni vetë nga zemrat tuaja: a mund të ngrihet ndonjë akuzë e drejtë kundër Islamit? Veprimet e një grupi të vogël myslimanësh, të ushtruara vetëm për interesat vetjake, pse duhet ta torturojnë gjithë botën myslimane? Sigurisht, çdo njeri i ndershëm që do paqe në botë, patjetër do të dëshirojë që ai të mos bëhet shkak i shqetësimit të tjetrit.

Siç e thashë më parë, ashtu sikundër edhe ju e dini, që ne po zhvillojmë këtë ceremoni me rastin e pesëdhjetëvjetorit të xhamisë sonë, që quhet xhamia Nur. Pesëdhjetë vite me radhë, po ai mesazh është përcjellë nga kjo xhami që xhamitë janë qendra për të përhapur dashuri, paqe, dhembshuri dhe adhurim ndaj Zotit të Vetëm.

Sot, Xhemati Mysliman Ahmadia ka gati 35 deri 40 xhami vetëm në Gjermani. Kurrresi ju nuk do të dëgjoni nga asnjëra prej tyre slogane të urrejtjes dhe përhapjes së çrregullimit në shoqëri. Nëse do të dëgjoni diçka, atëherë ajo do të jetë vetëm thirrje për adhurimin e Zotit Një dhe për t'i përmbushur detyrat që kemi ndaj Tij. Dhe kjo nuk ndodh vetëm në Gjermani. Xhemati Mysliman Ahmadia ka mijëra xhami në mbarë botën. Nuk mund të provohet kurrresi që po përhapet urrejtje nga ndonjëra prej tyre, ose ajo të ketë shkaktuar qoftë dhe një shqetësim të vogël dhe me të vërtetë nuk ndodhur kurrë një gjë e tillë.

Megjithatë, duhet të them me shumë keqardhje që një rrymë po përhapet në disa vende të Perëndimit, nëpër disa shoqëri të caktuara, që pa dallim çdo mysliman e konsiderojnë terrorist dhe se Islami mëson për terrorizmin. Herë pas here ata ngrënë zërin e tyre kundër fesë islame.

Shembulli më i fundit është referendumi i mbajtur në Zvicër dhe kjo ka qenë cituar nga dy folësit e nderuar, duke vënë një ndalim mbi minaret e xhamive. Sipas njoftimeve të gazetave, ata ishin zviceranë gjermanisht-folës që hodhën shumicën e votave në favor të ndalimit.

Unë nuk mund ta kuptoj se si ndryshimi i formës apo i pamjes së xhamisë do të mund ta ndryshojë edhe karakterin e njerëzve që do ta frekuentojnë atë xhami për të adhuruar. Nëse me të vërtetë

mendoni që xhamitë janë ara ku kultivohet mësimi i urrejtjes, atëherë mosndërtimi i minareve a mund të ndalë përhapjen e urrejtjes prej tyre? Urrejtja dhe armiqësia nuk marrin fund në këtë mënyrë, përkundrazi, akte të tilla do të shkaktojnë shqetësim midis myslimanëve paqedashës që janë në shumicë, ndjenjat e të cilëve janë duke u luajtur me këtë veprim.

Nga njëra anë ato pretendojnë, e kam fjalën për qeveritë perëndimore, për të qenë sekulare, dhe nga ana tjetër ato po vënë kufizimet mbi lirinë fetare. Duke vepruar kështu ato janë përpjekur për të luftuar ekstremizmin me ekstremizëm. Kur aplikohen këto lloje zgjidhjesh të pamenduara, sigurisht që edhe reaksioni do të jetë i pakuptimtë.

Xhemati Mysliman Ahmadia nën mbikëqyrjen e Kalifatit kurrë nuk reagon në mënyrë të gabuar. Ne edhe abuzimeve u përgjigjemi me anë të lutjeve. Në disa shtete myslimane, xhamitë tona nuk lejohen që të kenë minare dhe harqe, prapë ne mbetemi të heshtur. Megjithatë, myslimanët joahmadianë mund të reagojnë në një mënyrë ekstreme, gjë që ka ndodhur në të kaluarën.

Kështu që, unë ju lutem gjithë juve që jeni nga shtresë e edukuar e Gjermanisë, të vazhdoni të tregoheni zemërgjerë siç u treguat më parë. Ju patjetër që merrni gjëra të mira nga fqinjët tuaj, por mos i imitoni për gjëra të këqija. Minaret e xhamive janë vetëm simbole për të shpërndarë dritë dhe mjete për të ngritur thirrjen që Zoti është i Madhi; nuk ka zot tjetër përveç Atij;

Muhammedi, paqja dhe bekimet qofshin mbi të, është i Dërguari dhe Robi i Tij; ejani në xhami për të adhuruar, sepse ju mund të vendosni paqe në këtë botë duke krijuar një lidhje me Krijuesin tuaj, Allah; ejani drejt suksesit, sepse vetëm duke e adhuruar Atë dhe duke mbajtur paqe në këtë botë mund të arrihet sukcesi.

Pra, ky është qëllimi i minares, dhe nëse do të bëhet ndonjë thirrje tjetër prej ndonjë minareje tjetër, atëherë ajo është kundër mësimëve të Islamit. Është përgjegjësi e qeverisë për të ndëshkuar kriminelët e tillë, në vend që të ndëshkojë çdo njeri paqedashës për krimet e një individi të keqduhëhequr.

Paqe botërore nuk mund të arrihet në këtë mënyrë. Muret e urrejtjes me siguri janë ngritur për shkak të kësaj. Por për t'i rrëzuar këto mure të urrejtjes, Kurani Famëlartë na mëson në ajetin nëntë të suresë së pestë:

O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmuar me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër bindjes dhe frikësohuni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që bëni ju.

Ky është mësimi i bukur i fesë islame që thotë kur marrëdhëniet mes njerëzve dhe vendeve ndonjëherë acarohen, kjo nuk do të thotë që ju mund të hiqni dorë nga kërkesat e drejtësisë. Nëse do të bëni një gjë të tillë, atëherë ju do të jeni shumë larg nga bindja, rrjedhimisht ai që largohet nga bindja, largohet

edhe nga Zoti. Një njeri i tillë nuk vepron për hir të Zotit, sepse Zoti thotë nëse ti dëshiron t'i afrosh Atij, atëherë duhet të kryesh detyrat që ke ndaj të tjerëve duke përbushur kërkesat e drejtësisë. Madje, as edhe armiku yt nuk duhet të shqetësohet kot nga ti.

Në një vend tjetër, Kurani i Shenjtë thotë se kompensimi i ndonjë lëndimi duhet të jetë aq sa është vetë lëndimi, por nëse dikush zgjedh që t'ia fal autorit, duke ditur se falja e tij i sjell përmirësim, atëherë ajo është më e mira dhe shpërblimi i saj do të vijë vetë nga Zoti. Këto janë metoda për reformimin e shoqërisë dhe këto janë mjete për të vendosur paqe, të cilat ne i njohëm nga feja islame. Dhe sipas besimit tonë, për t'u dhënë një rifreskim mësimëve të Islamit, Allahu i Madhërishëm dërgoi Themeluesin e Xhematit Mysliman Ahmadi në këtë kohë, që proklamoi konceptin e dashurisë, dhembshurisë dhe paqes, për t'u sjellë fund luftërave fetare. Ai na udhëzoi në mënyrë të theksuar që të kujdesemi për ndjenjat e tjerëve fetare. Dhe kjo është pikërisht në përputhje me mësimet e fesë islame që një njeri nuk duhet të thotë diçka kot edhe kundër idhujve të jobesimtarëve, pasi edhe ata, duke reaguar, do të thonë diçka kundër Zotit tuaj, dhe kjo do të prishë paqen e shoqërisë.

Siç thashë më parë, të folurit keq kundër themeluesve të feve të ndryshme dhe mësimëve fetare, krijon urrejtje dhe shkatërron paqen. Sot bota është e ngatërruar pikërisht me këto probleme.

Problemet ekonomike e sociale kanë shkaktuar trazira që luajnë një rol mjaft negativ për të krijuar çrregullim në botë. T'ia shtosh këtij jostabiliteti edhe çështjen e fesë, nuk është ide e mençur, aq më tepër, duke ditur që në fakt është vetëm një grup njerëzish që krijon çrregullim për interesin vetjak.

Kështu që, me rastin e kësaj ceremonie, për hir të paqes shoqërore, do t'ju lutesha që ne të kujdesemi për ndjenjat fetare të njëri-tjetrit. Në këtë kohë, fal tregut ndërkombëtar, kontakteve të medias dhe mjeteve të shpejta të transportit, bota mund të quhet tashmë "një fshat global". Prandaj, në çdo shtet, çdo fe duhet të ketë liri të plotë deri sa ajo nuk e dëmton paqen e vendit.

Ndjekësit e çdo feje duhet të ushtrojnë lirisht zakonet e tyre fetare, përndryshe, nëse qeveria ndërhyt në çështjen e fesë, atëherë në këtë botë të civilizuar ndërhyrja e tillë do të mohojë pretendimin e tyre për të qenë sekular dhe përbushjen e të drejtave të tjerëve.

Do të përfundojë fjalën time duke thënë se çdo njeri, në vend që t'u heqë të tjerëve të drejtat e tyre, duhet të përpiqet të plotësojë detyrat që ka ai ndaj Krijuesit si dhe ato që ka ndaj krijesave të Tij, në mënyrë që paqja të vendoset në këtë botë.

Së fundmi, do të doja t'ju falënderoj edhe një herë të gjithë ata që morën pjesë në ceremoninë tonë dhe në këtë mënyrë treguan zemërgjerësinë e tyre.

Shumë faleminderit!



Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

"Sot, për të dhënë mesazhin tim në mënyrë konkluzive, dëshirova të botoj dyzet njoftime për të ftuar ata që më mohojnë dhe kundërshtojnë, në mënyrë që në Ditën e Gjykimit të mund të mbrohem para Zotit të Vetëm, se unë e kreu detyrën time me të cilën isha i ngarkuar. Prandaj, me shumë respekt e modesti, ua dërgoj këtë mesazh të nderuarve dijetarë myslimanë, të krishterë, hindu dhe arjë, duke i njoftuar që unë i jam dërguar botës për t'i ndrequr gabimet dhe dobësitë morale, doktrinare e shpirtërore. Hapi im është me hapin e Hazret Isait a.s., prandaj, jam quajtur Mesih i Premtuar, sepse jam urdhëruar që të përhap të vërtetën me shenja të mrekullueshme dhe mësim të pastra. Jam kundër përdorimit të shpatës për fenë dhe të vrasjes së robërve të Zotit. Jam i caktuar që, sipas mundësisë sime, t'i heq këto gabime nga

Një diamant i shkëlqyer dhe i paçmueshëm

myslimanët dhe t'i thërras ata drejt moraleve të pastra, këmbënguljes, drejtësisë dhe devotshmërisë. Unë deklaroj për të gjithë myslimanët, të krishterët, hindutë dhe arjët se unë nuk kam asnjë armik në këtë botë. Unë i dua njerëzit me atë dashuri që mund ta ketë një nënë e mëshirshme për fëmijët e saj, madje edhe më shumë. Vetëm se jam armik i doktrinave të pavërteta që përdhosin të vërtetën. Dashamirësia për njerëzimin është detyra ime,

ndërsa shpërfillja ndaj gënjeshtrës, *shirkut*, mizorisë dhe çdo veprë të keqe, padrejtësisë e keqsjelljes, janë parime të mia.

Shkaku kryesor i nxitjes së dashamirësisë sime është se unë zbulova një minierë floriri dhe gurësh të çmuar e për fat të mirë aty gjeta një diamant të shkëlqyer e të paçmueshëm. Çmimi i tij është aq i lartë, sa që nëse do t'ua shpërndaj të gjithë njerëzve, atëherë të gjithë, pa përjashtim, do të bëhen më shumë të pasur sesa ai që ka maksimumin e floririt dhe argjendit sot në botë. Çfarë është ai diamant? Ai është **Zoti i Vërtetë**, gjetja e Tij, njohja e Tij, bindja e vërtetë ndaj Tij, lidhja me Të me dashuri të sinqertë dhe gjetja e bekimeve të vërteta prej Tij. Prandaj, duke gjetur kaq shumë pasuri do të jetë një mizori shumë e madhe nëse ua fsheh njerëzve, ndërkohë ata të vdesin nga uria e unë të jetoj në luks. Këtë kurrë nuk mund ta bëj dot. Po më përvëlohet zemra vetëm duke e parë urinë dhe varfërinë e tyre. Po më zihet fryma vetëm duke e parë terrin dhe prapambetjen e tyre. Dua që shtëpitë e tyre të mbushen plot me pasuri shpirtërore dhe ata të sigurojnë kaq shumë diamante të së vërtetës dhe besimit, sa që t'ua plotësojnë tërësisht kapacitetet e tyre."

(Ruhani Khazain, vol. 17, f. 343-345; Arbain 1, f. 1-3)

PAQJA POLITIKE

Pjesa e dytë

Hazret Mirza Tahir Ahmadi, Kalifi IV i Xhematit Mysliman Ahmadi

Në numrin e kaluar ishte botuar pjesa e parë e temës “Paqja politike” në të cilën ishin trajtuar dhjetë temat e para të dhëna në përmbajtjen e mëposhtme. Në pjesën e dytë do të trajtohen pesë temat e fundit. “Paqja politike” është marrë nga “Islam’s Response to Contemporary Issues” (“Përgjigja e Islamit ndaj çështjeve bashkëkohore”), fjalimi i famshëm i Hazret Mirza Tahir Ahmadi Kalifi i IV i Xhematit Mysliman Ahmadi që ishte mbajtur në Sallën e Konferencës së Mbretëreshës Elisabetë II, në Londër më 24.02.1990

Përmbajtja

1. Paqja politike duhet të ekzaminohet me kujdes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
2. Islami nuk hedh poshtë tërësisht ndonjë sistem politik
3. Monarkia
4. Përkufizimi i demokracisë
5. Përkufizimi islamik i demokracisë
6. Dy shtyllat e konceptit islamik të demokracisë.
7. Parapëlqehen konsultime të ndërsjella
8. Konfuzioni për natyrën e vërtetë të qeverisjes islamike
9. Autoriteti Hyjnor
10. Mullahizmi
11. Ndarja e besnikërive midis shtetit dhe fesë
12. A duhet të ketë feja autoritet legjislativ ekzekutiv?
13. Drejtim i shtetit islamik
14. Marrëdhëniet ndërkombëtare; parimi i drejtësisë absolute i zbatueshëm njëlloj për të gjithë
15. Roli i Organizatave të Kombeve të Bashkuara

Ndarja e besnikërive ndërmjet shtetit dhe fesë

Nuk ka kontradiktë ndërmjet Fjalës së Zotit dhe Veprimit të Zotit. Nuk ka përplasje midis besnikërisë së një shteti dhe fesë në Islam. Por kjo çështje nuk ka të bëjë vetëm me Islamin.

Ka shumë episode në historinë njerëzore ku më shumë se një shtet i stabilizuar është konfrontuar për këtë çështje.

Perandoria Romake, veçanërisht, gjatë tre shekujve të parë të periudhës së krishtere, fajësoi Krishterimin për ndarjen e besnikërisë midis Perandorisë dhe Krishterimit. Kjo shpallje nga shteti përfundoi në persekutim jashtëzakonisht barbar dhe jonjerëzor të të krishterëve të hershëm në shtëpitë e tyre për krimin e supozuar të tradhtisë dhe pabesisë ndaj Perandorit.

Lufta e tillë midis Kishës dhe shtetit ka qenë gjithmonë një faktor i rëndësishëm në dhënien e formës së historisë evropiane. Napolon Bonoparti, për shembull, fajësoi Katolicizmin romak për ndarjen e besnikërisë dhe kërkoi që besnikëria e parë të ishte ndaj popullit francez dhe qeverisë së Francës, ndërsa Papës së Vatikanit mos t’i lejohej të drejtonte çështjet e katolikëve romakë në Francë dhe as Katolicizmi romak mos të lejohej të përzihej në punët e shtetit.

Në historinë e kohëve të fundit, komuniteti im, Xhemati Mysliman Ahmadi, në Pakistan hasi probleme serioze mbi baza të ngjashme. Duke qenë se ndikimi i klerit Mesjetar

filloi të ngrihej nën patronazhin e Gjeneralit Muhammad Zia-ul-Haq, diktator ushtarak që sundoi gjatë në Pakistan, ahmadianët u bënë përherë e më shumë viktime popullore të kësaj akuze të epokës së vjetër të ndarjes së besnikërive. Qeveria e Pakistanit, nën Gjeneralin Zia, madje arriti të nxjerrë një lloj Dekreti, që e quajti *Letra e Bardhë*, kundër ahmadianëve, duke shpallur se ahmadianët nuk ishin as besnikë të Islamit, as edhe të shtetit të Pakistanit.

Ishte e njëjta frymë çmendurie që zinte nënshtetasit e rinj. Vera mbeti e njëjtë, ndonëse kupa ka ndryshuar.

Kohët e fundit, gjatë çështjes së njohur të Selman Ruzhdiut, myslimanët në Britani dhe në shumë pjesë të Evropës, hasën të njëjtin problem, të akuzoheshin se kishin ndarje të besnikërive. Ndonëse intensiteti i kësaj nuk arriti një nivel etheje, megjithatë, dëmi i fuqishëm që kjo shtriu në marrëdhëniet ndër-komunitare, nuk duhet nënvlerësuar.

A duhet të ketë feja autoritet legjislativ ekskluziv?

Është një dukuri universale, si pasojë, nuk ka qenë hetuar kurrë seriozisht. As politikanët, as udhëheqësit fetarë nuk e kanë zgjidhur ndonjëherë vijën ndarëse të patrullimit ndërmjet fesë dhe shtetit.

Për sa i përket të krishterëve, ►

kjo çështje duhej të ishte zgjidhur njëherë e përgjithmonë, kur Jezusi, paqja qoftë mbi të, u dha përgjigjen e tij historike Farisenjve:

“Atëherë ai u tha atyre: Jepini, Cezarit atë që është e Cezarit, por Zotit atë që është e Zotit” (Mateu 22;21)

Këto fjalë të pakta janë thellësisht të pasura me mençuri; gjithçka që duhej të thuhej është thënë.

Feja dhe drejtimi i shtetit janë dy nga rrotat e shumta të vagonit të shoqërisë. Në realitet, është e pavend të diskutohet nëse janë dy, katër apo tetë rrota për aq sa ato mbajnë orientimin e tyre korrekt dhe vërtiten brenda orbitave të tyre. Nuk mund të bëhet fjalë për konflikt të ndërsjellë apo konfrontim.

Në marrëveshje të plotë me mësimet e tij të mëparshme hyjnore, Kurani i Shenjtë e përpunon këtë temë duke caktuar qartësisht kufijtë e sferës së veprimtarive të çdo komponenti të shoqërisë, që nuk u kundërvihen mësimave të tjera, megjithëse nuk mund të thuhet se feja dhe shteti nuk kanë asnjë fushë të përbashkët, që e ndajnë me njëra tjetrën. Sigurisht që përkojnë në disa fusha, por shkojnë vetëm me një frymë bashkëpunimi. Nuk ka qëllim për monopolizim.

Për shembull, një pjesë e madhe e edukimit moral në çdo fe bëhet një pjesë integrale e legjislacionit në çdo shtet të botës. Në disa shtete, kjo mund të përbëjë një pjesë të vogël; në të tjerë një pjesë relativisht më të madhe të ligjit. Ndëshkimet e këshilluara mund të jenë të buta apo të ashpra, por mos-aprovimet fetare kundër shumë krimeve që

janë penalizuar janë gjithmonë të gjurmueshme pa referencë në fe. Ndonëse ato mund të jenë në mosmarrëveshje me shumë ligje sekulare, pra, deri sa njerëzit u përkasin feve të ndryshme, ata rrallë zgjedhin të arrijnë në konfrontim me qeverisjen e vendosur për probleme të tilla.

Kjo aplikohet jo vetëm te myslimanët apo te krishterët, por po ashtu te të gjitha fetë e botës njëloj. Sigurisht, ligjet e fesë Hindu të *Manusmerti* janë në mospërputhje të plotë me sundimin sekular të qeverive politike në Indi. Por, në njëfarë mënyre, njerëzit duket se jetojnë në gjendje kompromisi.

Nëse ligji fetar kërkohet seriozisht kundër sistemeve politike mbizotëruese në vende të ndryshme, bota, sigurisht do të kthehet në një banjë gjaku. Por fatmirësisht për njeriun, nuk ndodh kështu.

Për sa i përket Islamit, këtu nuk ka problem të tillë, sepse parimi përfundimtar dhe i paepur i parashtruar nga Islami në lidhje me këtë është parim i drejtësisë absolute. Ky parim mbetet qendror dhe themelor ndaj të gjitha formave të qeverisjes që pretendojnë të jenë islamike në frymë.

Mjerisht! Kjo çështje shumë e rëndësishme e të kuptuarit të konceptit islamik të drejtimit të shtetit është pak e kuptuar nëse jo krejt, nga mendimtarët politikë në Islam. Ata nuk arrijnë të bëjnë dallimin ndërmjet aplikimit të ligjit të përgjithshëm në lidhje me krimet që janë universale në natyrë dhe pa

asnjë lidhje fetare dhe krime të tilla që janë specifike për pamaturira të caktuara të kësaj feje. Si pasojë, vetëm besimtarët e feve të tilla janë përgjegjës për ndjekje.

Këto dy kategori nuk janë të përcaktuara qartësisht. Ka një përmasë të lehtë të një zone gri ku krimet e zakonshme mund të kenë lidhje fetare apo morale si edhe seria e shkeljeve kundër normave të pranuarra njerëzore. Për shembull, akti i vjedhjes është një krim që varion në nivele të dënimit dhe ndëshkimit të parashkruar. Në mënyrë të ngjashme, është çështja e vrasjes, pija e alkoolit dhe prishja e rendit publik që janë pjesërisht apo tërësisht të ndaluara nga shumë fe. Disa fe kanë këshilluar ndëshkime

specifike për këto shkelje.

Pastaj shtrohet çështja se si një shtet duhet të shpëtojë nga krime të tilla. Kjo çështje çon më tej pyetjen nëse Islami jep një formulë krejt të qartë dhe të përcaktuar mirë për të adoptuar një qeverisje myslimane dhe një qeverisje jomyslimane. Nëse një qeverisje myslimane është përcaktuar si e tillë në Islam, atëherë çështje të tjera shumë të rëndësishme do të dalin, domethënë, vlefshmëria e çdo shteti që e mendon veten nën disa udhëzime specifike fetare dhe vendosjen e këtyre mësimave fetare mbi të gjithë qytetarët e tij, pavarësisht nëse ata i përkasin kësaj feje.

Fetë kanë për detyrë të tërheqin vëmendjen e organit ligjvënës ►



Hazret Kalifi IV r.a. duke mbajtur fjalimin e tij “Përgjigjja e Islamit ndaj çështjeve bashkëkohore”, në Sallën e Konferencës së Mbretëreshës Elisabetë II, në Londër më 24 shkurt, 1990.

për çështjet morale. Nuk është e nevojshme që gjithë legjislacioni të vendoset nën juridiksionin e feve.

Me kaq shumë sekte të ndryshme dhe nuanca të besimeve të ndryshme midis një sekti dhe një tjetri dhe një feje dhe një tjetre, rezultati do të jetë asgjë më shumë se një konfuzion total dhe një anarki. Marrim për shembull ndëshkimin për alkoolin. Ndonëse ai është i ndaluar në Kuranin e Shenjtë, nuk ka dënim të specifikuar nga vetë Kurani. Besimi është vendosur në disa tradita që janë sfiduar nga shkolla të ndryshme të jurisprudencës. Në një lokalitet apo vend, ndëshkimi do të jetë një gjë dhe krejt tjetër në një vend gjëkë. Mosnjohja e ligjit do të jetë e shfrenuar. Ajo që konsiderohet e vërtetë për Islamin, është gjithashtu e vërtetë për besimet e tjera. Ligji *Talmudik* do të ishte plotësisht jo praktik. E njëjta gjë mund të thuhet për Krishterimin.

Një besimtar i çdo feje mund të ushtrojë ritet e tij madje, edhe nën një ligj sekular. Ai mund të flasë të vërtetën pa ndonjë ligj shtetëror që ndërhyt në aftësinë e tij për të thënë të vërtetën. Ai mund të kryejë faljet e tij fetare adhurimit pa nevojën e një ligji specifik që të jetë bërë nga shteti për ta ndaluar atë të veprojë në mënyrë të tillë.

Kjo çështje gjithashtu mund të ekzaminohet nga një kënd tjetër interesant. Nëse Islami bie dakord me çështjen e një qeverisje islamike, në vendet ku myslimanët janë shumicë, atëherë në të njëjtën mënyrë të drejtësisë absolute, Islami duhet të lejojë të drejtën e qeverive

të tjera për të drejtuar vendet sipas porosive të fesë së shumicës. Si pasojë, Pakistani duhet të pranojë për fqinjin pranë, ligjin hindu për gjithë qytetarët indianë. Duke qenë kështu, do të ishte vërtetë një ditë tragjike për më shumë se njëqind milionë myslimanë të Indisë që do të humbnin të gjitha të drejtat e tyre për një mbijetesë të respektueshme në Indi. Serish, nëse India do të drejtohej nga Manusmarti, përse duhet që shteti i Izraelit të mohojë të drejtat që të drejtojnë çifutët po ashtu edhe paganët me anë të ligjit të *Talmudit*? Nëse ndodh kjo, jeta do të bëhet jashtëzakonisht e mjerë jo vetëm për popullin e Izraelit, por edhe për një numër të madh çifutësh vetë.

Por ky koncept i shteteve të ndryshme fetare në vende të ndryshme mund të ketë vetëm një vend të vlefshëm në Islam, nëse ai parashtron se në vendet me shumicë myslimane, *Sheriati* islamik duhet të mbizotërojë me forcën e ligjit. Kjo sërish do të krijonte një situatë në mënyrë universale kontradiktore, sepse nga njëra anë, në emër të drejtësisë absolute, të gjitha shtetet do të pajisen në të drejtën për të imponuar mbi popullin e tyre ligjin e shumicës fetare. Nga ana tjetër, çdo akt i pakicës fetare në vendet e botës, do të sillt nën rregullin e rreptë të një feje në të cilën ata nuk besojnë. Kjo do të ishte një fyerje ndaj vetë konceptit të drejtësisë absolute.

Kjo dilemë nuk është drejtuar kurrë as është bërë përpjekje të zgjidhet nga ithtarët e ligjit islamik në të

ashtuquajturat shtete myslimane. Sipas të kuptuarit tim të mësimëve të Islamit, të gjitha shtetet duhet të drejtohen në të njëjtin parim të drejtësisë absolute dhe kështu çdo shtet bëhet një shtet mysliman.

Në shikimin e këtyre argumenteve dhe konceptit thelbësor të Islamit “s’ka detyrim në çështjet e fesë”, feja nuk ka nevojë të jetë autoriteti mbizotërues legjislativ në punët politike të një shteti.

Drejtimi i shtetit islamik

Studimi im më ka bindur në mënyrë të qartë se Kurani i Shenjtë merret me subjektet e qeverisjes pa bërë ndonjë dallim, çfarëdo qoftë midis një shteti mysliman dhe një jomysliman.

Udhëzimet, sesi një shtet duhet të drejtohet, janë të përbashkëta për njerëzimin, ndonëse kryesisht është besimtarëve që u adresohet kjo në Kuranin e Shenjtë. Kurani i Shenjtë flet për drejtimin e shtetit njëllor të aplikueshëm për hindutë, budistët, konfucistët, të krishterët, çifutët etj.

Thelbi i këtij udhëzimi gjendet në ajetin e cituar më parë dhe ajete të tjera të ngjashme që ne do t’i citojmë tani.

“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre dhe pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht.” (En-Nisa 4:65)

“O besimtarë! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar

në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush ose kundër prindërve dhe të afërmeve tuaj. Nëse ai (kundër të cilit jepet dëshmia) është i pasur ose i varfër, Allahu kujdeset shumë më mirë për të. Mos ndiqni dëshirat tuaja të ulëta e të shtrembëroni drejtësinë! Nëse ju ngatërrojnë dëshminë ose i shmangeni asaj, vërtet që Allahu e di se çfarë bëni ju.” (En-Nisa 4:136)

Hadithet (thëniet) e Profetit të shenjtë të Islamit janë shumë të qarta në lidhje me këtë temë. Ai përfshin çdo drejtues dhe këdo që ka autoritet mbi një tjetër, në mënyrë që ai të trajtojë nënshtetasit e tij apo ata nën autoritetin e tij, si të ishin direkt përgjegjës ndaj Zotit. Por, duke qenë se këto diskutime tashmë janë përmendur më parë, ne nuk do t’i diskutojmë ato më tej.

Thelbi i këtij studimi është se Islami parashtron një qeverisje plotësisht neutrale qendrore në të cilën çështjet e drejtimit të shtetit janë të përbashkëta dhe njëllor të aplikueshme për të gjithë nënshtetasit e shtetit dhe ndryshimet fetare nuk lejohen të luajnë rol këtu.

Islami, sigurisht, i urdhëron myslimanët në mënyrë të theksuar që të ndjekin rregullin e ligjit në të gjitha punët e kësaj bote.

“O besimtarë! Binduni Allahut, binduni të Dërguarit dhe atyre që kanë autoritet mes jush. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, ia drejtoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Fundit. Kjo për ju është më mirë dhe shpjegimi më i qartë.” (En-Nisa 4:60)

Por, përsaupërkjet marrëdhënieve ndërmjet Zotit dhe njeriut, kjo

është një sferë ekskluzive e fesë dhe shteti nuk ka të drejtë të përzihet. Ka një liri të plotë të mendjes dhe zemrës në çështjet e besimit dhe shprehjes së besimit. Është e drejtë themelore e njeriut jo vetëm të besojë në diçka që atij i pëlqen, por edhe të adhurojë Zotin apo idhujt si të diktuar nga feja e tij apo besimi pagan.

Kështu që, sipas Islamit, feja nuk ka të drejtë të përzihet në sfera ekskluzive për shtetin, por as shteti nuk ka ndonjë të drejtë të përzihet në sfera përgjithësisht të ndara prej tyre. Të drejtat dhe përgjegjësitë janë kaq qartë të përcaktuara në Islam, sa që çdo çështje e një përplasjeje është e shmangur. Shumë vargje në lidhje me këtë temë janë cituar tashmë në pjesën që trajtojnë paqen fetare.

Fatkeqësisht, ka një tendencë midis shumë shteteve sekulare që nganjëherë të kalojnë kufijtë e tyre të sekularizimit. E njëjta është e vërtetë për shtetet teokratike apo shtetet e ndikuara padrejtësisht nga një hierarki fetare.

Ndonëse dikush mund të mos pajtohet me to, ai duhet të kuptojë në një shkallë, pikëpamjet e njëanshme të shteteve të drejtuara nga fanatikë fetarë. Por kur ai vëren një qëndrim të tillë të papjekur në të ashtuquajturit njerëz të përparuar dhe të kulturuar të vendeve sekulare, është e vështirë të besojë. Kjo nuk është e vetmja gjë e vështirë për të kuptuar sjelljen politike të njeriut.

Për aq sa politika mbetet e lidhur ngushtësisht ndaj interesit kombëtar

dhe kontribuon në filozofinë e tij, nuk ka gjë të tillë si moraliteti absolut. Për aq sa qëndrimet politike drejtohen nga paragjykimet kombëtare dhe e vërteta, ndershmëria, drejtësia dhe loja e ndershme janë hequr kudo që ato përplasen të kuptuara me interesin kombëtar dhe për aq kohë sa ky mbetet përcaktimi i besnikërisë për çdo shtet, sjellja politike e njeriut do të mbetet e dyshimtë, kontradiktore dhe ndonjëherë paradoksale.

Kurani i Shenjtë përmend përgjegjësitë e qeverisjes dhe të popullit. Disa nga këto përgjegjësi janë përmendur në pjesët e mëparshme të këtij leksioni – furnizimi i ushqimit, veshjes, strehimit dhe nevojat bazë të qytetarëve të tij; parimet e ndihmës ndërkombëtare; bashkëveprimi i tyre; të ketë drejtësi absolute; dhe ndjeshmëri ndaj problemeve të popullit, në mënyrë që ata mos të kenë nevojë që të ngrenë zërin në kërkim të të drejtave të tyre.

Në një sistem islamik të vërtetë të qeverisjes, është përgjegjësia e qeverisë të jetë syhapur, që populli mos të dojë t'u drejtohet grevave, konflikteve industriale, demonstratës, sabotimit apo synimit të ankimit, për të fituar të drejtat e tij. Le të kthehemi shkurtimisht te disa përgjegjësi të tjera.

Kurani i Shenjtë deklaron:

“Nëse ke frikë se ndonjë fis e thyen besën, edhe ti prishja marrëveshjen me të njëjtën mënyrë, sepse Allahu nuk i do ata që tradhetojnë.” (El-Anfal 8:59)

Do të thotë, ata që drejtojnë mund të mos drejtojnë në një mënyrë të

atillë që të nxitin çrregullim, kaos, vuajte dhe dhimbje, por duhet të punojnë me zell dhe me efektivitet në mënyrë që të vendosin paqe në çdo sferë të shoqërisë.

“A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen dhe ju bën juve trashëgimtarë në tokë?! Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër?! Sa pak që reflektoni!” (En-Neml 27:63)

Marrëdhëniet ndërkombëtare; parimi i drejtësisë absolute i zbatueshëm njëlloj për të gjithë

Realisht, sot politikanët dhe udhëheqësit lidhur me këtë, kanë nevojë për mësimet islamike. Islami është ajo fe, guri i themelit i së cilës në punët ndërkombëtare është drejtësia absolute. Siç është përmendur në Kuranin e Shenjtë:

“O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm për hir të Allahut dhe bëhuni dëshmuar me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësimit Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që bëni ju.” (El-Majdah 5:9)

Unë nuk mund të pretendoj të kem lexuar gjithçka rreth gjitha feve të botës, por as nuk jam tërësisht i paditur për mësimet e tyre. Gjatë studimeve të mia, megjithatë, nuk kam arritur të gjej një udhëzim të ngjashëm si ajeti në diskutim në shkrimet e tyre. Madje, edhe

përmendja e marrëdhënieve ndërkombëtare është e rrallë. Nëse një mësim i ngjashëm është gjetur edhe në një fe tjetër, atëherë më lejoni t'ju siguroj se Islami është në marrëveshje të plotë me këtë mësim, sepse këtu gjendet çelësi për paqen botërore.

Bota tërësisht është e shqetësuar sot në perspektivat e ardhme të paqes botërore. Ndryshimet e çastit dhe epokale në botën socialiste dhe përmirësimi i marrëdhënieve të superfuqive ofrojnë një rreze shprese. Bota është në një gjendje shpirtërore të ngazëllyer. Konsensusi i përgjithshëm i mendimit midis politikanëve udhëheqës duket të jetë jashtëzakonisht optimist, madje euforik, për përfundimin premtues të ndryshimeve revolucionare të çastit në sot jemi dëshmitarë.

Perëndimi, në veçanti, duket të ketë besim të tepruar dhe të jetë i ngazëllyer. Po bëhet përherë e më shumë e vështirë për amerikanët të ndrydhin ngazëllimin e tyre për atë, që ata mendojnë të jetë një fitore e madhe mbi hemisferën komuniste, një fitore e parë nga disa mbi të keqen dhe e së drejtës mbi të gabuarën.

Do të ishte jashtë rolit të analizoj në hollësi situatën aktuale gjeopolitike dhe përfundimin e saj. Ndoshta unë do të jem në gjendje t'ia kushtoj disa orë kësaj teme në Konferencën Vjetore të Xhematit Mysliman Ahmadia të Anglisë në fund të korrikut këtë vit (1990).

Roli i Organizatave të Kombeve të Bashkuara

Janë bërë shumë debate rreth perspektivave të ardhme të paqes botërore, të cilat u ndezën për shkak të ngjarjeve të fundit. Njëri prej tyre, në veçanti, kërkon të përmendet këtu. Ajo lidhet me rolin që Organizata e Kombeve të Bashkuara do të luajë për të qenë në gjendje për të siguruar dhe për të mbajtur (d.m.th bërë dhe mbajtur) paqen botërore me më shumë efektivitet se ndonjëherë më parë.

Me luftën e ftohtë midis dy supergjiganteve që pombaron, thuhet se ka një mundësi të madhe për të mbyllur të çarën midis pikëpamjeve të tyre deri sot të papajtueshme; më pak veto në sesionet e Këshillit të Sigurimit dhe vendime më të bashkuara sesi problemet globale duhet të zgjidhen. Kjo mund të paraqesë një këndvështrim krejt të ri për Këshillin e Sigurimit në të ardhmen.

E vetmja pengesë deri tani është rreziku i Kinës që luan jashtë grupit, por në shikimin e problemeve të mëdha ekonomike dhe politike, nuk është e pamundur për të bindur Kinën për avantazhet e marrëveshjes.

Nëse kjo ëndërr bëhet realitet apo jo, është tjetër gjë. Të marrim se Këshilli i Sigurimit si edhe Kombet e Bashkuara dalin si instrumenti politik më i fuqishëm për të ndikuar ngjarjet e globit dhe për të detyruar kombet më të vogla për t'iu nënshtruar vullnetit suprem të kombeve të botës, një skenar i

tillë nuk ishte i mundur para rënies së Murit të Berlinit. Por çështja mbetet, madje, ajo përvijohet më gjerë në horizontin politik më shumë se ndonjëherë, nëse Kombet e Bashkuara në rolin e tyre të ri të kombinimit të pushteteve ekzekutive dhe gjyqësore në proporcione të tilla të mëdha, do të jenë apo jo aktualisht në gjendje të arrijnë paqen botërore?

Unë lus të më falin, nëse mund të tingëllojë më pesimist se ç' duhet, por përgjigja ime ndaj kësaj pyetje është shumë mbrojtëse, 'Jo'. Çështja e luftës dhe paqes në botë nuk varet vetëm nga filli i marrëdhënieve të superfuqive. Është një çështje e thellë dhe komplekse me rrënjët e saj të ngulitura në filozofitë politike dhe qëndrimet morale të kombeve të botës.

Për më tepër, pabarazia ekonomike dhe zgjerimi i hendekut midis atyre që kanë dhe atyre që nuk kanë, detyrimisht luajnë një rol të rëndësishëm në ngjarjet e ardhshme të botës. Disa efekte tashmë janë diskutuar në pjesët e mëparshme të këtij fjalimi. Vetëm nëse parimi i drejtësisë absolute në marrëdhënien ekonomike midis vendeve të pranohet dhe të aderohet në mënyrë korrekte dhe praktikisht e pandershme të tregut që shfrytëzojnë burimet e të varfërve të jenë hequr dhe për të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara, paqja nuk mund të garantohet apo të projektohet për kombet e botës. Për atë kohë sa marrëdhëniet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara me shtetet e saj individuale nuk janë

të përcaktuara më qartë se sa tani, perspektivat e paqes botërore do të mbeten të ftohta.

Është e nevojshme të sajohen disa masa për të ndaluar qeveritë për të qenë të ashpra ndaj shtetasve të tyre. Ndonjë instrument duhet të bëhet i vlefshëm për Kombet e Bashkuara për të luftuar drejtësisht padrejtësinë sa herë që ajo triumfon. Deri atëherë, askush nuk mund të ëndërrojë paqe për botën.

Deri ku Kombet e Bashkuara mund të ndërhyjnë në të ashtuquajturat çështje të brendshme të një vendi? Është një pyetje shumë sensitive dhe akoma vitale për arritjen e paqes botërore. Por, nëse gjatë analizës së fundit, politika e Kombeve të Bashkuara nuk drejtohet nga parimi i drejtësisë absolute dhe aplikohen standarde të ndryshme ndaj kombeve të veçanta, atëherë sigurimi i sistemit të levave ndaj Organizatave të Kombeve të Bashkuara, për të ndërhyrë në çështjet e brendshme të një shteti, mund të krijojë më shumë probleme se sa mund të zgjidhë. Si pasojë, kjo çështje kërkon një studim të plotë, të qetë dhe tërësor.

Çfarë ka ndodhur deri tani është thjesht se Bashkimi Sovjetik dhe vendet e bllokut Lindor kanë qenë të detyruara të pranojnë dështimin e filozofive shkencore socialiste në përmirësimin e cilësisë së jetës në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet fqinje të Evropës Lindore. Kjo ka krijuar një konfuzion të madh.

Mjegulla duhet të pastrohet akoma para se ne të mund të shikojmë

formën e gjërave. Do të jetë një disfatë totale për socializmin shkencor i pasuar nga një kthim i çmendur në kapitalizëm në tërësinë e tij, apo do të ketë një eksperimentim të ri me ekonomi të përziera? Do të jetë një dobësim komplet i kontrollit të plotë qendror nga qeverisje totalitare apo kontrolli totalitar vetë do të thyhet në copa duke përfunduar në një shtet afër anarkisë? Apo, do të ketë një tranzicion gradual në një kontroll shtetëror totalitar në një sistem të ri të kompromentuar të dhënies dhe marrjes midis shtetit dhe individit kështu që, me kalimin e kohës, liritë civile janë aplikuar në mënyrë progresive dhe të drejtat themelore të njeriut janë restauruar?

Është e rëndësishme të presim përfundimin e një beteje të re ndërmjet ideve të Z. Gorbaçov të *perestrojka* dhe *glasnost* nga njëra anë dhe qëndrimin të rreptë ortodoks në hierarkinë komuniste. Për njohuritë e mia më të mira, shumë prej përfitimeve në shoqërinë pa klasa të BRSS-së janë ndarë në mënyrë të ndërsjellë nga hierarkia partiake, shërbimi civil dhe forcat mbrojtëse. Çështja vitale është, çfarë roli do të luajnë ato në këtë fazë kritike të lindjes të kundërrevolucionit pa gjak që tashti po merr formë?

Kjo dhe pyetje të ngjashme duhet të marrin përgjigje para se dikush të mund të parashikojë në mënyrë të arsyeshme impaktin e këtyre ndryshimeve në perspektiven e paqes së botës.

Thjesht një ulje tensioni midis ►
dy superfuqive në vetvete,

nuk sjell ndonjë shpresë për paqe. Përkundrazi, kjo evokon shumë fantazma të rreziqeve në pritë për vendet e Botës së Tretë në veçanti. Ishte mosbesimi që mbizotëronte midis dy superfuqive dhe xhelozia e tyre që, në fakt, siguroi një lloj çadre për kombet më të dobëta. Gjithashtu, ishte aftësia e kombeve më të dobëta për të ndryshuar krah dhe aleanca nga Perëndimi në Lindje apo në të kundërt që iu dha atyre një përmasë të vogël të manovrueshmërisë dhe pazarllëkut të pushtetit. Por nuk është më kështu. Çfarë shprese mund të presin tani këto vende më të dobëta për të mbijetuar në mënyrë të respektueshme si kombe të pavarura në të ardhmen?

Mendimi në këtë fazë devijon te OKB – një bastion i paqes, i vetmi pishtar i shpresës i vendosjes të rendit të ri botëror. Të paktën, dikush uron të jetë kështu. Megjithatë, në një ekzaminim më të afërt kritik, shfaqet një tablo plotësisht e errët, e mundimshme dhe madje kërcënuese.

Në ekuilibrin e ri të dalë të pushtetit, Kombet e Bashkuara nuk do të jenë praktikisht të drejtuara nga vetëm një superfuqi? Kjo nuk paraqet mundësi që kombet më të vogla dhe më të dobëta t'i shpëtojnë fatit të pashmangshëm të kafshëve të gjahut.

Kombet e Bashkuara aktuale kanë provuar sërish dhe sërish janë një organizatë e fuqishme që nuk punon për drejtësinë, por për qëllimet politike të atij kombi që ka fuqinë më të madhe të lobimit. Koncepti i së drejtës dhe të padrejtës nuk ka

luajtur ndonjëherë ndonjë rol në procesin e marrjes së vendimeve të Kombeve të Bashkuara në memorien tonë të kohëve të fundit, as edhe në të ardhmen e projektuar s' do të luajë një rol kuptimplotë. Politika dhe diplomacia janë të rrënjosura shumë thellë dhe të pazgjidhshme në tokën e politikave moderne për të lënë ndonjë hapësirë për drejtësi absolute, për të hedhur rrënjë dhe për të dhënë një mundësi të mirë të mbijetesës. Është fakt i fortë dhe i hidhur, që asnjë njeri që ka respekt për të vërtetën nuk mund të mohojë se ky institucion i madh dhe i tmerrshëm është katandisur në një arenë veprimtarish diplomatike të ndërlikuara, lobimi, marrëdhëniesh sekrete dhe luftëra pushtetesh, gjithçka e bërë në emër të paqes botërore.

Sipas Kuranit të Shenjtë, si pasojë, ajo që bota ka nevojë është një institut që i vë vetes detyrën e vendosjes së drejtësisë. Pa drejtësi absolute, paqja nuk është e bindshme. Dikush mund të zhvillojë luftëra në deklaratë solemne në emër të paqes, të ndrydhë vetëdijen dhe të mos pajtohet për qëllimin domethënës të vendosjes së paqes, por gjithçka që ai mund të arrijë është vdekje dhe jo paqe.

Mjerisht! Pak midis politikanëve të mëdhenj të botës e kuptojnë ndryshimin midis vdekjes dhe paqes.

Vdekja ka lindur nga padrejtësia, tirania dhe persekutimi nga të fuqishmit. Paqja është fëmija e drejtësisë.

Kurani i Shenjtë flet shpesh për paqen, por gjithmonë në lidhje me

drejtësinë. Paqja është e përmendur shpesh si kusht për sundimin e drejtësisë.

Në një situatë shpërthyesë në agresivitet dhe urrejtje aktive midis dy myslimanëve individë apo kombe, Kurani i Shenjtë ka këtë për të propozuar:

“Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata. Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhrat e Allahut. E, nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi dhe paanësi, sepse Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi. Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.” (El-Huxhurat 49:10-11)

Në ajetin e mësipërm, jomyslimanët nuk janë përmendur për arsyen e dukshme se ata nuk priten t'i nënshtrohen mësimëve të Kuranit. Por, ajeti shërben si një model i shkëlqyer për gjithë botën për ta ndjekur;

Kur sytë e botës janë kthyer te Kombet e Bashkuara dhe Këshilli Sigurimit me shpresën se kjo do të sigurojë një rol më të madh, më aktiv, më kuptimplotë, në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare dhe kështu të transformojë botën në një strehë më të sigurt dhe më të qetë, ka shumë pak fakte në kujtesën e kaluar të kryera nga Kombet e Bashkuara për t'iu dhënë besim këtyre mendimeve të dëshiruara. Një arenë botërore e lobimit, intrigës, veprimtarisë së dendur

diplomatike synon në formimin e grupeve të presionit dhe përpjekjeve për të arritur një avantazh mbi kundërshtarët aspak të vlefshëm, ku skrupujt nuk kanë rol për të luajtur dhe vetëdija njerëzore është hyrje e mbyllur, natyrisht mund të quhet një shtëpi e kombeve edhe pse në konflikt dhe rrëmujë. Por do të ishte një ironi ta quajë një shtëpi të tillë, një shtëpi të Kombeve të Bashkuara. Nëse ky është koncepti i bashkimit, unë për vete nuk do të zgjidhja më shumë rrezikun për të mbijetuar në një komunitet të Kombeve që janë të ndara, por të bashkuara në ndershmëri dhe drejtësi.

Dëshira për të grumbulluar pushtet për të shkatërruar kundërshtarët dhe ende zëri i mospajtimit është një çështje më vitale që çdo komb duhet ta adresojë dhe zgjidhë. Dikush habitet me ndjenjën e thellë të keqardhjes se si kombet anëtare të kësaj shtëpie augustiane do të vazhdojnë të mbyllin sytë dhe të mos pranojnë të hapin mendjet e tyre ndaj rreziqeve të qenësishme në mënyrën në të cilin çështjet e kombeve po drejtohen.

Paqja botërore varet në mënyrë të dyshimtë në një fije të një shprese të dobët se drejtësia do të mbizotërojë dhe se drejtësia do të bëhet.

Përktheu në gjuhën shqipe:

Çapajev Zera

JETA e Hazret Umerit^{r.a.} [581-644]



Allahu i Madhërisëm dërgoi të Dërguarin e Tij ^{savs} si bartës i lajmeve të gëzuara dhe si alarmues dhe e pajisi me një libër të përsosur, rreth të cilit u shpreh duke thënë:

Elif Lâm Râ. Unë jam Allah. Unë Shikoj. Ky është një Libër të cilin ta kemi shpallur ty (o Muhamed), me qëllim që t'i nxjerrësh njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd.

[Ibrahim 14:3]

Kuptimet semantike e parësore të këtij ajeti u vërtetuan dhjetëra herë gjatë jetës së të Dërguarit të Allahut ^{savs} me prurjen e ndryshimeve të mëdha shpirtërore në qenien e njerëzve të thjesht përmes shoqërimit të tij. Një revolucion i gjerë përmbysi gjithë Gadishullin Arab duke shkukur të gjitha ligësitë shekullore që e gërryenin përbrenda shoqërinë njerëzore, dhe në vend të saj vuri pastërtinë e lartësinë morale dhe shpirtërore. Pra, ardhja e Islamit rishkroi fatin e njerëzimit

dhe vuri gurthemelin e ndërgjegjes, fisnikërisë, devotshmërisë, dëlirësisë dhe virtytësisë në shkallën më të lartë. Tek sahabët e Profetit të shenjtë ^{savs} hasim shembujt më të shkëlqyeshëm të transformimit shpirtëror. Shfaqjen më të përkryer të këtij transformimi e gjejmë të Hazret Umer ibn el-Hattab ^{ra}.

Kur i Dërguari i Allahut ^{savs} shpalli se ishte profet i Zotit dhe filloi predikimin e fesë Islame, Umeri e kundërshtoi fort duke qëndruar krahu për krahu me Ebu Xhehlin. Në kohën kur Myslimanët përballeshin me

përndjekje, persekutim dhe tirani barbare nga ana e kundërshtarëve Kurejsh, i Dërguari i Allahut ^{savs} iu përgjërua Zotit me këtë lutje:

O Allah! Përforcoje Islamit me njërin nga këta dy: Me Amr ibn Hashamin (Ebu Xhehlin) ose me Umer bin el-Hattabin.¹

Ebu Xhehli mbante një urrejtje e armiqësi të thellë kundër Islamit dhe Profetit të shenjtë ^{savs}. Ai ishte njeri i moshuar dhe mendimet e tij kundër Islamit ishin mjaft

1. Tirmidhi, numri i hadithit 3682,

të palëkundura. Dëshira për të pasur pasuri dhe influencë e tërhiqte shumë. Për sa i përket Umerit, duke qenë luftëtar trim, gojëtar i shquar dhe arbitër i zgjuar në raste konflikti, ai i galvanizonte njerëzit. Por, si Ebu Xhehli edhe Umeri i ri ndiqte të njëjtën rrugë.

Jeta e hershme

Umeri lindi në Mekë në fisin e Benu Adit. Ky fis kishte rolin e ndërmjetësuesit në konfliktet brenda fiseve. Babai i tij Hattab bin Nufejl ishte i njohur për zgjuarsinë e tij, ndonëse ishte idhujtar i përbetuar dhe njeri i pamëshirshëm.

Në kohë në injorancës², analfabetizmi ishte shumë i përhapur në Arabi, por Umeri që në moshën rinore mësoi të lexonte dhe të shkruante. Sipas traditave të Kurejshëve, ai mësoi kalorësinë dhe mundjen që nga adoleshenca. Ai ishte shtatlartë dhe i fuqishëm fizikisht. Umeri^{ra} ishte gojëtar i lindur dhe i zgjuar me një personalitet të fortë. Ai u bë tregtar dhe bëri disa udhëtime drejt Romës e Persisë ku u takua me njerëz intelektualë madje edhe pati mundësi të shohë nga afër kulturën dhe jetën e tyre shoqërore.

Pranimi i Islamit

Kur Profet Muhammedi^{savs} u bëri thirrje njerëzve që ta pranojnë mesazhin e Islamit, për t'i kushtuar bindje, nënshtrim e fisnikëri vetëm Allahut, shumëkush e kundërshtoi, ndërsa një pakicë e pranuan këtë. I Dërguari i Allahut^{savs} ua ngjalli besimin dhe bindjen e jashtëzakonshme, sa që zemrat e tyre dëshmuan këtë, duke u betuar

2. Në terminologjinë Islame koha para Islamit njihet me termin "koha e injorancës".

para Profetit të shenjtë^{savs} se "babai e nëna sakrifikofshin për ty". Ata dorëzuan tërë qenien e tyre para Allahut. Sigurisht, që kjo do të shkaktonte pakënaqësi në mesin e prijësve të fuqishëm të fisit Kurejsh, përfshirë Ebu Xhehlin e Umer bin el-Hattabin. Ndikimi dhe përhapja e mesazhit të Muhammedit^{savs} sfidonte pozitën dhe autoritetin e prijësve. Kjo bëri që gjithë prijësit e fisit Kurejsh, të mblidheshin dhe të hartonin plane për ta ndaluar këtë ndryshim. Duke qenë më me zë ndër të gjithë ata, duhej që Ebu Xhehli e Umer bin El-Hattabi të kurdisnin intriga për të sulmuar mu te burimi i gjithë kësaj andralle. Umeri, i mbushur me tërë mllef e zemërim, u ngrit dhe u nis me shpatë të zhveshur drejt Profet Muhammedit^{savs} për ta vvarë atë dhe për ta mbyllur kapitullin e Islamit një herë e përgjithmonë. Rrugës ndeshi një të njohur, i cili e pyeti se ku po shkonte ai? Umeri iu përgjigj: "Unë po shkoj për të vvarë Muhammedin sepse ai ka përçarë fisin Kurejsh, ka çnderuar traditat tona dhe ka shkelur nderin e fesë të zotave tanë". Këmbësori i tha: "Më mirë shikoje shtëpinë tënde, sepse tashmë edhe motra jote Fatima është bërë fshehurazi myslimane". Me të dëgjuar këto fjalë, zemërimi i tij u rrit edhe më shumë, dhe vazhdoi rrugën me ngut për në shtëpinë e motrës. Kur Umeri iu afrua pragut të shtëpisë, Fatimeja dhe burri i saj Seid bin Zejd po dëgjonin këndimin e Kuranit nga Habab bin Ereti^{ra}. Kur Umeri trokiti në derë, motra e tij menjëherë fshehu fletët e Kuranit si dhe Hababin. Kur ajo ia çeli derën, Umeri e pyeti me zemërim të madh: "Kam dëgjuar se keni pranuar besimin e Muhammedit!". Me të

thënë këto fjalë, Umeri kapi kunatin e tij Seidin dhe duke e hedhur atë përdhe filloi ta rrihte. Fatimeja për të ndaluar Umerin hyri mes tyre, por Umeri i dha asaj një shuplakë të fortë. Goditja ishte aq e fortë sa që i shkaktoi gjakderdhje. Duke parë motrën e vet në këtë gjendje, Umeri u skuq nga turpi dhe filloi ta ngushëllonte. Umeri ia kërkoi fletët e Kuranit për t'i lexuar. Ato mbanin ajetet e para të Kuranit:

Tâ, Hâ. Tejjib , Hadi. O (Profet) i pastër dhe udhërrëfyes i përsosur. Ne nuk ta kemi shpallur Kuranin ty (o Muhamed), që të mundohesh, por ai është kujtesë për atë që i frikësohet (Allahut). Ai është zbritur nga Krijuesi i Tokës e i qiejve të lartë. I Gjithëmëshirshmi mbi Fron u ngrit.

[Tâ Hâ 20:2-6]

Sigurisht, Unë jam Allahu, s'ka zot tjetër përveç Meje, prandaj vetëm Mua më adhuro dhe kryej faljen për të më kujtuar Mua.

[Tâ Hâ 20:15]

Me të lexuar këto ajete, zemra e Umerit u mbush me lartësinë dhe madhësinë e Kuranit. Të gjitha dyshimet e luhatjet u zhdukën përnjëherë dhe ai u shpreh: "Sa të mahnitshme dhe madhështore janë këto fjalë." Me të thënë këto, zemra e tij sikurse dëshmoi se në të vërtetë vetëm Ai, i Cili ka dhënë këtë porosi, meriton të Adhurohet. Umeri, tashmë i iluminuar dhe ndriçuar shpirtërisht, tha "Më shpini te Muhammedi". I pushtuar nga emocionet, Umeri, akoma me shpatë të zhveshur, trokiti në derën e *Dare Erkemut*, ku ishte strehuar i Dërguari i Allahut^{savs} asokohe. Duke parë Umerin në këtë gjendje,

sahabët ngurronin t'ia hapnin derën. Atëherë Profeti i shenjtë^{savs} urdhëroi: "hapni derën". Dera u hap. Umeri me shpatë të zhveshur hyri brenda. I Dërguari i Allahut^{savs} iu afrua Umerit dhe duke shtrenguar mantelin e tij i tha: "O Umer me çfarë qëllimi ke ardhur këtu? Pasha Zotin! Unë shikoj se ti nuk je krijuar për ndëshkimin e Zotit". Umeri iu përgjigj: "O i Dërguari i Allahut! Unë kam ardhur për t'u bërë mysliman". Duke dëgjuar këto fjalë, Profeti i shenjtë^{savs} nga gëzimi ngriti një slogan të fortë "Allahu Ekber". Edhe sahabët e ndiqnin Profetin me slogane derisa zëri filloi të jehonte nga kodrat e Mekës.

Ardhja e Umerit^{ra} nuk ishte më pak se një fitore madhështore. Ai ishte njëzet e shtatë vjeç kur pranoi Islamit. Ishte shumë i gjatë aq sa dallohej kollaj në turmën e njerëzve. Ishte i shogët me fytyrë kuqërreme. Një luftëtar i pashembullt që shfaqte kulmin e guximit, trimërisë dhe zemërimit me një valë emocionesh. Një herë kur kujtonte ditën që kishte pranuar Islamit tha: "Atë natë kur isha bërë mysliman, mendova për armikun më të ashpër të të Dërguarit të Allahut^{savs} që të shkoja tek ai dhe t'i thosha se jam bërë mysliman. Më ra ndërmend *Ebu Xhehli*. Pra, mëngjesin tjetër vajta te shtëpia e tij dhe i rashë derës. Ai doli dhe më priti me fjalët 'Përsëndetjet më të përzemërta, o nip. Çfarë të solli këtu?' Unë iu përgjigja 'Kam ardhur që të të njoftoj ty se i besoj Allahut, të Dërguarit të Tij dhe konsideroj se ajo çfarë ka sjellë ai është e vërteta.' Ai përplasi derën dhe më tha 'Të mallkoftë Zoti ty dhe atë që ke sjellë'.

Ditën tjetër, Umeri^{ra} vajti në qendër të Mekës dhe

shpalli para të gjithëve se e kishte pranuar Islamin. Deri atëherë Islami ishte predikuar fshehurazi, sepse myslimanët i frikësoheshin përndjekjes, por që nga ajo ditë doli nëpër rrugë dhe më në fund zbriti në zemrën e Mekës, pra në Qabe. Abdullah ibn Masudi^{ra} shprehet: “Ne nuk mund të faleshim në Qabe, derisa Umeri u bë mysliman. Ai kundërshtoi kurejshët gjer sa kreu faljen dhe ne u falëm me të. Abdullah bin Umeri rrëfen: “Kur babai im u kthye në fenë Islame, ai pyeti: “Kush është më i miri për të bërë shpallje publike para Kurejshëve?” Iu përgjigja se ishte *Xhemil bin Ma'mar el-Xhumahi*. Ai shkoi tek ai ndërsa unë isha me të. Ndonëse isha në moshën fëmijërore, kuptova gjithçka që pashë. Ai vajti te Xhemili dhe e pyeti se a dinte që Umeri ishte bërë mysliman dhe kishte pranuar fenë e Muhamedit. Pasha Allahun, ai sapo kishte mbaruar së thëni se Xhemili u ngrit duke zvarritur mantelin e tij përtokë. Babai im e ndiqte atë, kurse unë babanë tim, derisa Xhemili qëndroi aty ku Kurejshët mblidheshin për takimet e tyre rreth Qabesë. Ai bërtiti me gjithë forcë ‘Umeri u tërhoq!’ Babai im gërthiti ‘Ky është gënjeshtar. Unë jam bërë mysliman dhe unë dëshmoj se s’ka zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij!’ Disa veta sulmuan babanë tim dhe kjo përlëshje vazhdoi derisa dielli arriti në zenit. Atëherë Umeri^{ra} u tha: “Bëni çfarë të doni. Pasha Allahun! Në se ju do të ishit treqind veta, ne prapë do të kishim luftuar për këtë çështje me të njëjtën këmbëngulje.” Pas pranimit të Islamit, Umeri^{ra} hoqi dorë nga gjithçka që pengonte afrimin e tij me Zotin dhe Profetin

e shenjtë^{savs}. Ai u largua nga errësira e injorancës dhe iu nënshtrua plotësisht Profetit të shenjtë^{savs}. Edhe Profeti iu afrua; ai e shoqëronte, i merrte këshillat dhe përdorte aftësitë e tij për misionin e Islamit.

Shpërngulja (Hixhreti) nga Meka

Në vitin 622 i Dërguari i Allahut^{savs} kishte vendosur që myslimanët të shpërnguleshin nga Meka për në Medinë, një qytet që ndodhej 340 km në veri të Mekës. Ebu Selmah Abdullah bin Ashali^{ra} ishte i pari që emigroi dhe pastaj myslimanët e tjerë filluan të largoheshin nga Meka. Hazret Ali bin Ebi Talibi^{ra} rrëfen se nuk ka njohur dikë tjetër që është shpërngulur sheshazi nga Meka, përveç Umerit^{ra}. Kur ai vendosi për t’u shpërngulur, mori shpatën e tij, rregulloi harkun e shigjetat dhe u nis drejt Qabesë me devenë e tij. Pas *tevaftit* dhe kryerjes së faljes, shpalli para të gjithëve se po shpërngulej dhe u nis.³

Kur i Dërguari i Allahut^{savs} mbërriti në Medinë, ai vendosi që të ndërtonte një xhami. Kështu edhe Umeri shkante çdo ditë nga Kuba në Medinë për të marrë pjesë në ndërtimin e saj. Për të rehabilituar emigrantët e Mekës, i Dërguari i Allahut^{savs} vendosi vëllazëri midis myslimanëve të Mekës dhe të Medinës, ku çdo emigrant apo *muhaxhir* bashkohej me vëllanë mysliman të Medinës apo me *ansarin*. Kjo vëllazëri ishte e pashembullt në historinë njerëzore, sepse fortësia dhe dashuria e ndërsjellët i tejkalonte edhe lidhjet

3 ‘Fat’hul bari’ vëll. 7 f. 261, cituar nga ‘Sehîh-ut-Tauthîk’ f. 31

e gjakut. Në këtë mënyrë, Umeri^{ra} u lidh me Itban bin Malikun. Duke qenë tregtar, Umeri^{ra} shumë shpejt filloi të merrej me tregti në Medinë, ndërsa kohën e lirë kalonte në shoqërinë e Profetit të shenjtë^{savs}. Pavarësisht se muhaxhirët u asimiluan shumë shpejt në Medinë, mallëngjimi për atdheun e tyre - Mekën, bëhej gjithnjë e më i fortë. Ata kujtonin të afërmit e tyre, të cilët i kishin lënë mbrapa, pasurinë e pronat, dhe përndjekjet e egra të Kurejshëve ndaj tyre. Në këtë kohë Kurejshët kishin filluar përgatitjet për luftë kundër myslimanëve.

Pjesëmarrja në betejë

Në vitin e dytë pas *hixhretit*, pra në vitin 623, kurejshët e Mekës përgatitën një ushtri të madhe për të shkatërruar e shpartalluar myslimanët. Atëherë 13 vjet pas themelimit të Islamit, Allahu e bëri të lejuar për myslimanët që të luftonin për vetëmbrojtje. Kjo ishte beteja e Bedrit në të cilën, përballë 1000 kurejshëve të pajisur dhe të armatosur mirë, qëndruan dhe fituan 313 myslimanë. Myslimanët, që deri atëherë kishin sakrifikuar të afërmit e pasurinë e tyre, tani fill pas thirrjes së Profetit^{savs}, iu betuan që do të jepnin edhe jetën për të mbrojtur Islamin. Fitorja në fushën e Bedrit shënoi një kapitull të ri në historinë e Islamit. Umeri^{ra} mori pjesë pothuajse në të gjitha betejat kryesore, si në Bedr, Uhud, Ahzab, Hejber, Hunejn, ndërsa për të përballuar shpenzimet e ekspeditës së *Tubukut*, Umeri^{ra} kontribuoi duke dhënë gjysmën e pasurisë. Ai nuk humbiste asnjë shans për të sakrifikuar pasurinë e tij në rrugën e Allahut.

Në luftën e *Uhudit* disa shigjetarë myslimanë braktisën pozitat e tyre, të cilat ua kishte caktuar vetë i Dërguari i Allahut^{savs}, në kërkim të plaçkave të luftës, duke rrezikuar edhe jetën e Profetit^{savs}. Duke përfituar nga rasti, një skuadër ushtarësh sulmuan ushtrinë myslimane duke iu shkaktuar dëme të mëdha. Në këtë moment kritik, Umeri^{ra} bashkë me Ebu Bekrin^{ra} dhe sahabët e tjerë formuan një vijë mbrojtëse rreth Profetit të shenjtë^{savs} i cili ishte plagosur dhe e shpurën në një vend të sigurt. Umeri^{ra} bashkë me sahabët e tjerë luftoi me armikun duke e zmbarsur plotësisht.

Pas betejës, kur të dyja palët grumbullonin të plagosurit e tyre dhe sahabët lidhnin plagët e Profetit të shenjtë^{savs}, *Ebu Sufjani*, nën perceptimin e shtrembëruar, mendoi se i Dërguari i Allahut^{savs} ishte vranë. Ai bërtiti me zë të lartë “*U’lu hubul*”, (“*O Hubul! Qofsh i lartësuar*”). Profeti i pyeti sahabët: “Pse nuk përgjigjeni?” Umeri^{ra} i tha: “Si të përgjigjemi?”. Profeti iu përgjigj: “Thuaj! *Allahu a’la ve exhel*”, (“*Lartësia e madhështia i takojnë vetëm Allahut*”). Atëherë Ebu Sufjani tha: “*Lenal U’zza vela U’zza lekum*”, (“*Ne kemi U’zza⁴ ndërsa ju nuk e keni*”). Atëherë i Dërguari i Allahut^{savs} i tha Umerit^{ra} që të përgjigjej: “*Allahu maulana vela maula lekum*”, (“*Allahu është përkrahësi ynë, ndërsa ju s’ keni asnjë përkrahës*”).

Vdekja e të Dërguarit të Allahut^{savs}

Sahabët e donin të Dërguarin e Allahut^{savs} më shumë se veten. Momenti më i vështirë, që ata

4. *U’zza* është emri i idhullit, të cilin e adhuronin *mekasit* (banorët e Mekës).

përjetuan, ishte kur Profeti i shenjtë savs u nda nga jeta. Ata kurrë nuk kishin menduar se i dashuri i tyre do të largohej prej tyre. Pikëllimi e brenga për vdekjen e Profetit savs ishte e papërballueshme. Sahabët gati-gati u trullosën nga dhimbja dhe mbetën pa mend. Edhe Umeri ra ishte i mendimit se i Dërguari i Allahut savs ishte gjallë, veçse ishte larguar përkohësisht dhe do të kthehej së shpejti për të ndëshkuar hipokritët. Madje Umeri ra ngriti shpatën e zhveshur dhe tha se ai do t'ia presë kokën atij, i cili guxon të shprehë se i Dërguari i Allahut savs ka ndërruar jetë. Atëherë Ebu Bekri ra iu drejtua sahabëve duke thënë se nëse dikush i besonte Profetit të shenjtë savs, le të besojë se ai ka ndërruar jetë, por nëse dikush beson Allahun, le të kuptojë se Allahu është i Gjallë dhe i Gjithëpranishëm. Pastaj recitoi këtë ajet:

Muhamedi nuk është veçse i Dërguar, para të cilit gjithë të dërguarit tjerë kanë vdekur. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa? Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi Allahut. Dhe Allahu me siguri do t'i shpërblejë falënderuesit.

[Ale-Imran 3:145]

Thuhet se atë moment, Umeri ra porsa dëgjoi fjalët e Ebu Bekrit, kuptoi se Profeti i shenjtë savs me të vërtetë ishte larguar përgjithmonë. Pikëllimi i humbjes ishte i tmerrshëm për Umerin ra, sepse e kishte dashur Profetin savs më shumë se çdo gjë tjetër. Me të dëgjuar këto fjalë ai u rrëzua përdhe nga trysnia e emocionit.⁵

5. Buhari, kitabul menakib

Kalifati i Umerit ra 634-644

Jeta e Hazret Umerit ra është një kapitull i rëndësishëm në historinë e Islamit. Çdo rresht i këtij kapitulli përmban ndryshime dhe fitore madhështore, saqë për t'i arritur këto, kombeve të ndryshme u duhen shekujt të tërë. Ndikimi i Kuranit të Shenjtë dhe trajnimi nga i Dërguari i Allahut savs i dhanë personalitetit të Umerit ra një ngjyrim të tillë që sot, pas shumë shekujve, periudha e kalifatit të tij vështrohet me respekt e nder në respektimin e drejtësisë, të drejtave dhe lirive njerëzore etj. Kishte punuar në ngritjen e dinjitetit të gjinisë femërore në shoqëri apo në nismat për mirëqenien e popullit, përpjekjet e tij në përhapjen e njëjesisë së Zotit dhe përkushtimin ndaj Tij. Njihen orvatjet e tij për arsimim e studim, hapja e shkollave e institucioneve për të përgatitur dijetarë, gjykatës dhe administratorë të denjë. Pra Hazret Umeri ra ndërtoi xhami e medrese në vendet ku ishte futur islami, dhe të cilat i shndërroi në qendra kryesore të arsimit, shkollimit dhe edukimit e të cilat më vonë u bënë vatrat themelore të qytetërimit Islam. Vetëm numri i xhamive, të cilat shërbenin si institucione kryesore të arsimit dhe njohjes së rregullave fetare, kishte arritur dymbëdhjetë mijë gjatë kalifatit të Umerit ra.⁶

Gjatë periudhës së tij Iraku, Persia, Siria, Egjipti, etj. u përfshinë në perandorinë myslimane. Qytetërimi Islam, të cilin i Dërguari i Allahut savs kishte mbjellë në shkretëtirën shkëmbore të Arabisë, tashmë

6. 'Feslul Hatab fi sirah Ibnul Hattab Amirul Mominin Umer bin el-Hattab' nga dr. Ali Muhammad es-Se-labi ëëë.slaaby.com

ishte shndërruar në një pemë të gjerë e të fuqishme, nën hijen e së cilës kombe, gjuhë dhe kultura të ndryshme formonin një përzierje jashtëzakonisht të bukur. Zakonet e ritet e injorancës u shkrinë dhe u zhdukën plotësisht, ndërsa civilizimi dhe kultura Islame lulëzoi e u përhap me hov të shpejtë në Arabi dhe jashtë saj. Sahabët, të cilët i kishte mësuar, edukuar dhe përgatitur vetë Profeti i shenjtë savs, kur u caktuan në vende të ndryshme sipas rangjeve shoqërore apo administrative, ata u bënë pishtarët e dijes, ndriçimit dhe iluminizmit. Shumë shpejt kombe të ndryshme filluan të bashkoheshin nën flamurin e Islamit, duke e përvetësuar kulturën Islame, moralin, virtytet, diturinë, artin, studimin e shkencës, etj. Ky ishte rasti i parë kur bota dëshmoi vëllazërinë e bashkësinë mbarënjëzore. Umeri ra bëri përpjekje të veçanta për të përhapur Kuranin dhe mësimet e tij. 'Si rezultat i përpjekjeve të Umerit ra, mësimi i Kuranit u bë shumë i njohur. Lexuesit e Kuranit ishin aq shumë sa nuk numëroheshin, ndërsa numri i hafizve⁷ kishte arritur në mijëra. Hazret Ebu Musa Esh'eri ra kishte shkruar në përgjigje të një letre se vetëm në ushtrinë time janë treqind hafizë.'⁸

Thuhet se Kalifi i myslimanëve, Umeri ra ishte një këmishë e cila ishte e arnuar në më shumë se 30 vende. Ushqimi ishte fare i thjeshtë. Edhe në atë kohë kur njerëzit pushonin, Umeri ra nga ndjenja e përgjegjesisë,

7. Hafiz: Hafizi quhet ai që ka mësuar përmendsh gjithë Kuranin.

8. Sejruss-Sahaba, vëll I, f. 147

rrinte i angazhuar në çështjet e Kalifatit. Mbante një qilim prej gjetheve të palmës ku shtrihej për të pushuar. Kur delegacionet vinin në Mekë, ata kërkonin kështjellën e Umerit ra, ndërsa atyre u jepej përgjigje se Umeri ra nuk kishte ndonjë kështjellë, por banonte në një shtëpi të thjeshtë.

Umeri ra u bë kalifi i dytë i të Dërguarit të Allahut savs pas vdekjes së Ebu Bekrit ra në Xhemadial thani 13 hixhri (gusht 634). Umeri ra i qëndroi besnik modelit të Profetit të shenjtë savs ndoqi besnikërisht sjelljet e paraardhësit të tij. Por, me guximin dhe forcën e tij karakteristike ai i nënshtroi perandoritë e mëdha persiane e bizantine.

Zgjerimi i perandorisë Islame

Myslimanët kishin bërë disa luftëra me ushtritë persiane dhe kishin fituar pjesën perëndimore të perandorisë. Tani perandori i ri Jezdgirdi kishte filluar përgatitjet për një betejë vendimtare për t'i zbrapsur myslimanët nga territori i tyre. Për të përforcuar ushtrinë myslimane, Hazret Umeri ra diskutoi me Shuranë (këshillin) dhe caktoi Sa'd bin Ebi Vekasin ra për udhëheqjen e ushtrisë. Kur ushtria u nis nga Medina, Hazret Umeri ra këshilloi Sa'din duke i thënë:

"Allahu të keqen nuk e prapëson me të keqen, por atë e prapëson me të mirën. Të gjithë, qoftë nga shtresa e lartë apo e ulët, janë të barabartë para Tij. Dijeni se sjellja e të Dërguarit të Allahut savs është e vetmja mënyrë për të vepruar. Ju po niseni për një mision historik ▶

dhe mund t'ia dilni mbanë vetëm duke ndjekur të vërtetën. Ngulitni virtyte të larta në veten tuaj si dhe në shokët tuaj.”

Lufta u zhvillua në fushën e Kadisisë, ishin 28000 ushtarë mysliman përballë 120000 ushtarëve persianë. Hazret Sa'di^{ra} merrte udhëzime të vazhdueshme nga kalifi dhe vepronte sipas tyre. Lufta zgjati katër ditë, në të cilën myslimanët treguan trimëri të pashoqe duke mposhtur armikun që ishte katërfish më i madh në numër. Kjo luftë ishte vendimtare në historinë islame, sepse jo vetëm që shkatërroi perandorinë Persiane, por gjithashtu i dha Islamit një vrull të fuqishëm. Në vitin 643 e gjithë Persia ra në sundimin e myslimanëve.

Përveç perandorisë persiane, në gusht të vitit 636 myslimanët nën udhëheqjen e Ebu Ubejdah ibni Xherrahut^{ra} fituan betejën e Jarmukut dhe kështu morën Sirinë nga perandoria Romake.

Pas fitores së Sirisë Halid bin Velidi^{ra} dhe Ebu Ubejdahu^{ra}, ia vunë rrethimin qytetit Jerusalem. Shumë shpejt banorët ranë dakord për të bërë marrëveshje me palën myslimane. Për të shkruar këtë marrëveshje kalifi i myslimanëve Hazret Umeri^{ra} vajti në Jerusalem dhe siguroi banorët se jeta e tyre dhe pronat e tyre do të jenë të sigurta. Kishat e sinagogat vazhduan shërbimet e tyre, ndërsa çdokush gëzonte lirinë fetare.

Në vitin 638 myslimanët fituan Egjiptin nga Romakët nën udhëheqjen e Amr bin el-Asit^{ra} ndërsa në vitin 640 Aleksandaria, qyteti i fundit në dorën e Romakëve

u bashkua me perandorinë Islame. Më 27 të Dhul Hixhasë të vitit 23 hixhri (7 nën. 644) periudha madhështore e kalifatit të Umerit mbërriti fundin e saj me vdekjen e tij në moshën 61 vjeçare. Një skllav persian me emër Lu Lu Firoze i ishte ankuar për keqtrajtim nga pronari i tij. Kalifi e hetoi këtë rast dhe gjeti se pronari nuk kishte vepruar ashtu, prandaj nuk e përfilli atë. Ditën tjetër kur Umeri^{ra} ishte në xhami për namaz, skllavi e sulmoi duke e goditur gjashtë herë me thikë. Hazret Umeri^{ra} ndërroi jetë nga plagët e rënda. Para se të vdiste, ai kishte caktuar një komision të përbërë nga sahabët e shquar për të caktuar kalifin e ardhshëm.

Pozita e Umerit^{ra}

Fuqia e Umerit^{ra} rridhte përmes dy elementeve të rëndësishme, pra nga frika e Allahut dhe dashuria për Profetin e shenjtë^{savs}. Ai trembej aq shumë nga përgjegjësia e kalifatit sa që nuk përdorte asgjë nga financat e shtetit. Madje ai nuk e merrte as vajin nga thesari publik për të ndezur fenerin në shtëpi. Ndihma financiare që ai merrte nga thesari, mezi i plotësonte nevojat elementare. Njëherë dikush i tha: “Ju duhet t'i shtoni të ardhurat tuaja.” Hazret Umeri iu përgjigj: “I Dërguari i Allahut^{savs} na ka lënë një model për të ndjekur dhe më duhet ta ndjek atë.”

Umeri^{ra} gjithmonë fliste të vërtetën. Një herë i Dërguari i Allahut^{savs} tha: “Umeri gjithmonë flet të vërtetën, pavarësisht të jetë e rëndë dhe pavarësisht nëse mbetet i vetmuar e pa përkrahje.” Pothuaj çdo natë ai dilte në rrugicat e Medinës për

të parë nga afër shqetësimet e qytetarëve, qëndronte në kufijtë e qytetit deri në orë të vona duke pritur korrierët që t'i sillnin lajmet, ndërsa po ky Umer^{ra} një pjesë të natës^{ra} ia kushtonte adhurimit të Allahut me përgjërime të ngashëryera.

Hazret Amru bin el-As rrëfen se unë e pyeta të Dërguarin e Allahut^{savs} ‘O i Dërguar i Allahut! Kush është më i dashur për ju nga njerëzit?’ Ai tha: Aishja. Unë i thashë ‘Po i Dërguari i Allahut! Prej burrave?’ Tha: babai i saj. Unë e pyeta: po pas tij? Tha ‘Umer bin el-Hattabi.’ Pastaj përmendi persona të tjerë.⁹

Kur Hazret Umeri^{ra} u sulmua në tentim për vrasje, ai e kuptoi nga plagët e rënda se nuk mund të jetojë më. Prandaj, thirri djalin e tij Abdullahun dhe i tha që të shkonte tek Aishja^{ra} dhe t'ia përcillte selamin e tij dhe t'i kërkonte leje për t'u varrosur bashkë me dy shokët e tij. Abdullahu^{ra} u paraqit para Aishes^{ra} dhe i tregoi mesazhin e Umerit^{ra}. Aishja^{ra} u përgjigj se atë vend e kishte caktuar për vete, por sot po i jepte epërsi Umerit mbi veten. Pra, kur Abdullahu u kthye me përgjigjen e Aishes dhe ia tregoi Umerit, gëzimi i tij ishte i pafund. Umeri tha: “Të gjitha lavdërimet i takojnë vetëm Allahut. Për mua nuk ka gjë më të rëndësishme se kjo”.

Ibne Abbasi^{ra} rrëfen se bashkë me ata që kishin ardhur për të përcjellë xhenazen e tij, ishte njëri që thoshte “O Umar! Allahu qoftë i kënaqur prej teje. Unë gjithmonë kam dashur që Ai të të shoqëronte ty me shokët e tu. Sepse gjithmonë e kam dëgjuar Profetin^{savs} duke thënë “Ebu Bekri,

9. El-Ehsanuu fi Sahih ibn Haban 15/309

Umeri dhe unë..., Ebu Bekri, Umeri dhe Unë bëmë këtë, apo Ebu Bekri, Umeri dhe Unë u nisëm ...”, prandaj edhe unë dëshiroja që Allahu të të bashkonte ty me miqtë e tu.” Ibne Abbasi^{ra} rrëfen kur e ktheva kokën për të parë se kush fliste, pashë se ai ishte Hazret Ali bin Ebi Talib^{ra}.

Thëniet e Hazret Umerit^{ra}

“Ruhuni nga teprica e pasurisë së kësaj bote që lehtëson jetën tuaj, ashtu siç i frikësoheni mosbindjes ndaj Allahut. Në gjykimin tim, duhet frikësuar më shumë nga paraja se sa mëkati, sepse paraja e shpie njeriun drejt shkatërrimit në mënyrë të pandjeshme duke përdorur çdo lloj joshjeje.”¹⁰

Hazret Mesihu i Premtuar^{alehiselam} shkruan duke treguar pozitën e lartë të Hazret Umerit^{ra}:

“Saddiku^{ra} dhe Faruku^{ra} janë prijës të shquar e të denjë të Allahut. Ata janë si male të larta. Ata ftuan banorët e qyteteve apo të vendeve të shkreta drejt së vërtetës, derisa zëri i tyre mbërriti deri në vendet më të largëta. Periudha e kalifatit të tyre është shënuar nga frytet e arritjes së Islamit dhe e pajisur me aromën e sukseseve e arritjeve. Ndonëse në periudhën fillestare të Ebu Bekrit^{ra} Islami ishte rrethuar nga sfidat e vështirësitë e shumta, madje, ushtritë keqdashëse po përgatiteshin për ta sulmuar këtë vargan të dobët, por duke parë besimin e Siddikut^{ra} Allahu i Plotfuqishëm erdhi vetë në ndihmë të tij dhe e nxori këtë thesar të çmuar nga gremina e rrezikut.”¹¹

Shahid Ahmad Butt

10. El Khulafa el-Rashidin nga dr. Ahman Zidan, f. 97. Islamic Inc. Publishing & distribucion, ISBN 977-265-221-8, Kajro, Egjipt

11. Sirrul-Khilafa, Rruhani Khezain vëll. 8

Veprimtari e shkëlqyer e vitit 2008-2009

Ngjarje besimshtytëse të emisionit në gjuhën arabe
“*El-Hiëarul Mubashar*” (Bisedë e drejtpërdrejtë) dhe
anëtarësimi i shumë arabëve fisnikë në Xhemat duke parë
vërtetësinë e tij nëpërmjet ëndrrave dhe udhëzime hyjnore

“*Bejte*” të reja (anëtarësimet të reja në Xhemat) nga e
gjithë bota dhe disa rrëfime interesante të tyre

Spitalet dhe Shkollat nën projektin “*Nusret Xhehan*”

“*Shoqëria e arkitektëve dhe e inxhinierëve ahmadianë*”
duke shërbyer në Afrikë



**Veprimtari në gjuhë
të ndryshme**

*Arabic Desk*¹ përveç librave dhe broshurave për revistën e tyre “*El-Takua*” botoi edhe një numër të veçantë për njëqindvjetorin e Kalifatit Ahmadia, cilësia e të cilit është shumë e mirë. Veç kësaj, para pesë viteve Xhemati Ahmadia i Kababirit kishte nxjerrë faqen e tyre të internetit që ka të gjithë librat e Xhematit në gjuhën arabe dhe shumë shkrime të tjera mbi tema të ndryshme. Sivjet, Xhemati ka nxjerrë edhe një faqe tjetër të internetit që quhet ëëë.ketabi.net. Këtu mund të blini çdo libër të botuar nga Xhemati ynë

1. Zyra që merret me veprimtarinë e Xhematit në gjuhën arabe.

në gjuhën arabe.

Në të njëjtën mënyrë punojnë edhe *Bangla Desk*, *Frëngjisht Desk*, *Kinez Desk*, dhe *Turqisht Desk*.

**Ngjarje besimshtytëse të
emisionit në gjuhën arabe**

“*El-Hivarul Mubashar*” (Bisedë e drejtpërdrejtë)



Në MTA 3 Al-Arabija (MTA në gjuhën arabe) transmeton një emision “*El-Hivarul Mubashar*” (Biseda e drejtpërdrejtë).

Shumë arabë po shikojnë këtë emision dhe nëpërmjet ëndrrave shumë nga ata po bëhen ahmadianë. Do të përmend këtu vetëm disa ngjarje të tilla.

BEKIMET
e Allahut të Lartësuar
mbi Xhematin Mysliman
AHMADIA

(pjesa II)

Fjalimi i Hazret Kalifit të Pestë të Mesihut të Premtuar, i mbajtur gjatë ditës së dytë të Xhelse Salan-ës së Xhematit Mysliman Ahmadia në Britaninë e Madhe, që u zhvillua në “Hadikatul Mahdi” të Anglisë, më 24, 25 dhe 26 korrik, 2009



Hazret Kafili V i Mesihut të Premtuar a.t.b.a. në emisionin e drejtpërdrejtë të MTA-së në gjuhën arabe "El-Hivarul Mubashar"

Prëfime besimnxitëse të disa arabëve ahmadianë

Zotëri Sherif Abdul Mumin, nga Algjeria, më shkroi dy ëndrrat e tij. Do t'ju tregojë një nga ato. Ai thotë:

"Unë jam duke qarë dhe ju kërkova se çfarë duhet të bëj. Ju më dhatë dy formularë të Bejtit (të betimit për t'u anëtarësuar në Xhemat). Kur u zgjova, hapa internetin dhe shkarkova dy formularë të Bejtit dhe ato ishin pikërisht ashtu siç kisha parë në ëndërr. Kështu që, unë pa u vonuar bëra Bejtin. Që nga ajo kohë unë ndiej një ndryshim të dukshëm në qenien time dhe vazhdimisht po përpiqem që të veproj sipas Kushteve të Bejtit."

Një poet arab, zotëri Maliki shkruan:

"Unë e kam njohur Xhematin me anë të kanalit MTA, atëherë kur ende nuk kishte filluar MTA në gjuhën arabe. Deri atëherë, për Kalifin e Katërt mendova se ishte përfaqësues i fesë budiste. Por, kur ai ndërroi jetë, ne e pamë xhenazen e tij në MTA dhe dëshmuam se po shfaqej drita e Muhammedit s.a.v.s. nga fytyra

e tij. Të gjithë njerëzit e shtëpisë sime thoshin se "Ah! Sikur të ishte mysliman ky njeri!" Nuk e di arsyen, por ne qamë shumë kur ndërroi jetë Kalifi i Katërt. Pastaj, një ditë, rastësisht gjetëm MTA-në në gjuhën arabe. Dhe që atëherë ne e numërojmë veten në Xhematin e Hazret Mesihut të Premtuar a.s. Gruaja ime u bë ahmadiane më përpara se unë, se kishte parë dy ëndrra. Në të parën ajo pa se Hazret Aliu (Kalifi i Katërt i Profetit Muhammed s.a.v.s.) po i jep disa dokumente bijës sime. Gruaja ime kur i pa ato, ishin formularët e Bejtit. Në ëndërrën e dytë ajo pa se dikush i kishte sjellë asaj një letër prej Hazret Mesihut të Premtuar a.s. në të cilën ishte shkruar: "Ai që hyn në shtëpinë time, është pjesëtar i familjes sime." Gruaja ime pa dhe ëndrra të tjera, pastaj edhe djali im pa ëndërr. Andaj, ne të gjithë pa u vonuar e bëmë Bejtin."

Ai tregon edhe një ëndërr tjetër. Duke m'u drejtuar mua, Ai thotë: "Në ëndërr ju pashë duke mbajtur një fjalim në një fushë ku përveç meje të gjithë ishin në këmbë. Unë duke parë

palton tuaj po thosha: Subhanallah! Si ka mundësi që keni veshur rrobat e Imam Mahdiut! Pas fjalimit ju erdhët te unë dhe vendosët dorën mbi kokën time dhe më thatë: Zemra jote ende nuk u bind. Dukesh se je i uritur, hajde me mua! Të të jap diçka për të ngrënë."

Ramez Ahmad Hadidi nga Siria më shkroi një letër shumë të gjatë. Ai thotë:

"Një herë të premtën unë po bëja Istigfar (kërkoja falje) për veten, anëtarët e familjes dhe për të gjithë myslimanët, dhe isha shumë i shqetësuar kur po mendova për gjendjen e mjerueshme të myslimanëve. Zoti i Lartësuar, në zëmër më mësoi një lutje të cilën e bëra nga thellësia e zemrës. Lutja ishte kjo: "O Zoti ynë! Dorëzoj çështjet tona Kalifit Tënd sa më shpejt." Që, në fakt, do të thoshte: "O Zoti ynë! Mblidhi të gjithë myslimanët sa më shpejt nën flamurin e Imam Mahdiut dhe mos na dorëzo ne tek armiqtë tanë." Pas faljes u ktheva në shtëpi dhe si zakonisht po shikoja kanale të ndryshme në televizor. Atëherë gjeta kanalën MTA që jepte emisionin "El-Hivarul Mubashar" (Biseda e drejtpërdrejtë) dhe po bëhej debat me të krishterët me anë të Biblës, gjë që më pëlqeu shumë. Më përpara unë shpesh thosha se pse dijetarët tanë nuk flasin rreth këtyre temave që të krishterët të informohen për madhësitin e fesë sonë. Atëherë falënderova Zotin duke menduar se ma plotësoi dëshirën time... Pastaj në vitin 2007, gjatë muajit të ramazanit, njëherë kur mbaroi ky emision, fala disa nafile dhe iu luta shumë Zotit. Ndërkohë, dëgjova një zë, që ishte kaq i mrekullueshëm sa që harrova brengën time. Fillova të ndiqja fjalët që dilnin nga ai zë. Ato ishin lutjet e një të dashuri të

Zotit që nuk kërkonin as botën materiale as ahiretin, por donin vetëm Zotin. Kur pushoi ky zë, u shfaq fotografia e Hazret Imam Mahdiut, të cilin unë nuk e njihja, por poshtë fotografisë ishte shkruar "Imam Mahdiu dhe Mesihu i Premtuar". Pastaj tri herë recitova "La haula vela kuvata illa bil-lah" dhe thashë se çdo gjë bie pas kulmimit të saj. mendoja (për ahmadianët) pavarësisht se kanë argumente të forta dhe po bëjnë përpjekje kaq të vyera, prapë se prapë pyesja veten? Kush janë këta njerëz? Sigurisht po gabohen rëndë!. Pastaj, mendova dhe u luta: "O Zot, na trego të vërtetën ashtu siç është ajo dhe na jep mundësi edhe për ta ndjekur, gjithashtu na trego të pavërtetën ashtu siç është ajo dhe na jep mundësi të largohemi prej saj." Më vonë, e fika televizorin dhe rashë në gjumë.

Atë natë më ndodhi diçka shumë e çuditshme. Në ëndërr pashë se më erdhi Imam Mahdiu dhe me ngulm më thoshte: "Unë jam Imam Mahdiu dhe Mesihu i Premtuar. Nëse ke diçka për të pyetur mund të më pyesësh, do të përgjigjem me argumente." Por unë e ktheva kokën. Por ai prapë doli para meje dhe më tha: "Unë betohem për nderin dhe madhësitin e Zotit se unë jam Imam Mahdiu dhe Mesihu i Premtuar." Por unë prapë e ktheva kokën. Kështu u bë shtatë herë dhe çdoherë ai dilte para meje dhe më thoshte të njëjtat fjalë. Herën e shtatë, zëri i tij ishte shumë i ashpër. Sikur ai ishte bubullima, vetëtima dhe stuhi. Kësaj radhe, ndikimin e tij e ndjeva edhe nga brenda edhe nga jashtë. Pastaj me shumë dashuri duke më kapur mua si prind, më tha: "Unë shtatë herë të kam thënë duke u betuar për nderin dhe madhësitin e Zotit se unë jam Imam Mahdiu dhe Mesihu i Premtuar." ▶

Askujt nuk i kam thënë deri tani kaq herë në këtë mënyrë. Ti e di shumë mirë se pse unë bëra betimin shtatë herë.” Pastaj ai u largua. Që atëherë fillova të studioja librat e Xhematit që ishin në internet dhe vazhdova të lutesha shumë. Dhe përfundimisht bëra Bejtin për t’u anëtarësuar në Xhematin Ahmadian. Pas disa ditësh, pasi që u ktheva nga falja e sabahut dhe rashë në krevat, ende pa fjetur mirë, pashë se jam ulur në Xhenet, në krah të djathtë të Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s. Nuk kishte asnjë pengesë midis meje dhe tij. Ai vuri dorën e tij të bekuar mbi supin tim dhe duke buzëqeshur më tha: “Urime, që u bëre ahmadian!””

Një zonjë Ehed Elberaki nga Siria shkruan:

“Unë pashë në ëndërr që Profeti Muhammed s.a.v.s. erdhi në Damask. Dhe disa miq pakistanezë po gatuanin oriz dhe ushqime të tjera në tenxhere të mëdha që më vonë do t’i çonte në fshatin tim, pasi edhe Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s. atje do të shkonte. Pastaj një njeri me emrin Saleh i thoshte tim eti se Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s. do të vijë në emisionin “El-Hivarul Mubashar” (Biseda e drejtpërdrejtë) dhe të gjithë arabët duke iu bindur thënies së Profetit s.a.v.s. do të bëjnë Bejtin (betimin për t’u anëtarësuar në Xhemat).” Në letrën e saj ajo gjithashtu thotë: “Kam përshtypje se shpejt do të shikojmë pamje të tilla.” Insha Allah.

Samei Lamahi Sahibi Nga Maroku shkruan:

“Hazret Mesihu i Premtuar a.s. më kapi me dorën e tij të bekuar dhe pastaj dëgjova një zë shumë të ëmbël dhe shumë

të dashur. Nuk mund të përshkruaj dot ëmbëlsinë e atij zëri. Ai më tha: “Samei, mos ki frikë! E vërteta është me ty dhe unë jam me ty.””

Një zonjë Aisha Abul Kerim Sahiba nga Kababiri shkruan:

“Unë gjendem para xhamisë me disa njerëz të Kabibirit. Atje në një dhomë janë mbledhur shumë njerëz që papritur dalin jashtë. Shumica prej tyre ishin gra. M’u duk se ishin arabët e qytetit Sekhnin. Duke dalë nga dhoma ata gëzoheshin për ardhjen e Hazret Mesihut të Premtuar. Ata kanë disa letra në të cilat janë shkruar ca poema të tij. Në ëndërr kisha përshtypje se ata donin të dëgjonin për Mesihun e Premtuar. Ata ishin të bindur, por ende nuk kishin bërë Bejtin. Unë u them: Ku i keni librat? Duhet të keni libra për të lexuar. Pastaj në zemër ndjeva se do të fillojë përhapja e mesazhit të Hazret Mesihut të Premtuar në një mënyrë të re dhe do të hapen rrugë të reja. Ne duhet të lexojmë sa më shumë librat e tij, saqë t’i informojmë edhe arabët e këtij vendi.”

Zotëri Tamim Abu Dekka Sahibi nga Jordania duke treguar për një mik të tij të cilit po i bënte tablig (po i tregonte për Xhematin), shkruan:

“Unë i thashë: “Drejtoju Zotit dhe kërko të të udhëzojë!” Atë natë ai iu lut shumë Zotit. Para faljes së sabahut kur ai ka qenë në gjendje midis gjumit e zgjimit dëgjoji: “Ai është Imam Mahdiu dhe Mesihu i Premtuar.” Ai tha: Dua të dëgjoj këto fjalë edhe një herë. Më thuhet: “A nuk e beson ti?” Unë u përgjigja ashtu siç u përgjigj Hazret Ibrahim i a.s.: “Dua për qetësinë e zemrës.” Pastaj kur u zgjova unë isha plotësisht i bindur.”

Nga emisionet në gjuhën arabe po përfitojnë shumë njerëz dhe myslimanët gjejnë guximin. Zotëri Ahmad Hasan Sahibi nga Italia shkruan:

“Emisioni që keni transmetuar rreth moshës së Hazret Ajshes r.a. ishte shumë i dobishëm. Pasi keni treguar hulumtimin tuaj, tani edhe ne ecim me kokën lart. Gjithashtu, për madhështinë e Profetit Muhammed s.a.v.s. siç e keni shpjeguar ju, duke e dëgjuar atë ne ndiejmë krenari që jemi myslimanë.”

Një poet kombëtar i Irakut mori vesh për Xhematin nëpërmjet internetit. Askush nuk dinte si ai ishte ahmadian. Ai në faqen e tij të internetit dha poemat arabe të Hazret Mesihut të Premtuar dhe rreth Kalifëve të tij. Kur anëtarët e Xhematit e panë faqen e tij të internetit morën vesh se ai është ahmadian. Ja, kështu sjellin fruta faqet tona të internetit.

Zotëri Aziz Abdul Mexhidi nga Zvicra shkruan:

“Me origjinë, jam nga Mjanmari. Caktimi i Zotit, para dy vjetësh e gjysmë më solli në Zvicër. Këtu për herë të parë u informova për Xhematin Ahmadian. Gjuhën arabe mund ta flas shumë mirë. Më kanë pëlqyer shumë emisionet në gjuhën arabe të kanalit MTA ku flitet me logjikë dhe argumente. Kam gjetur përgjigjet e shumë pyetjeve që kisha. Jam plotësisht i bindur se Xhemati Ahmadian është po ai Xhemat i shpëtuar ndër sektet e tjera dhe i ndihmuar nga Zoti i Lartësuar. Ju kërkoj me shumë modesti që të pranoni anëtarësimin tim në këtë Xhemat.”

Zotëri Sad El-Fedli nga Kuvajti shkruan:

“Unë s’jam ahmadian, por haptazi pohoj se ju jeni në radhën e parë për ta mbrojtur fenë Islame. Dhe pavarësisht se nuk jam ahmadian, mendoj se ne të gjithë duhet të bashkohemi me ju për ta mbrojtur Islamin.”

Zotëri Ismail Adnani banor i Norvegjisë, ndjek emisionet e kanalit MTA në gjuhën arabe. Ai thotë:

“Jam sufi dhe më pëlqen shumë sufizmi. Nëpërmjet kanalit MTA unë dua t’u them të gjithë sufive të botës: Hajdeni dhe bëhuni anëtarë të Xhematit të Mirza Ghulam Ahmadi, Mesihut të Premtuar a.s. Sepse të gjitha veprat dhe thëniet e tij të gjitha pasqyrojnë nivelet më të larta të taseufit (të sufizmit) dhe janë thelbi i fesë. Lexojeni shpjegimin e tij për ajetin “Allahu është drita e qiejve dhe e tokës. Drita e Tij shëmbëllen me një kamare në të cilën ndodhet një llambë...” dhe shikoni sesi ai jep shpjegimin e kamares ndërsa dijetarët e tjerë nuk e arritën.”

Zotëri Shemsuddin Siddik Usmani nga Kurdistani shkruan:

“Afërsisht para njëzet vitesh kisha parë Hazret Mirza Ghulam Ahmadin, Mesihun e Premtuar, që zbriste nga hëna në tokë. Tani kur e pashë MTA-në u binda se zbritja e tij nga hëna do të thoshte ardhja e tij nëpërmjet kanalit MTA. Tani dua të bëhem ahmadian, ju lutem më pranoni mua.”

Pra, me bekimin e Zotit, me anë të kanalit MTA po bëhen shumë njerëz ahmadianë, sidomos në vendet arabe. ▶

“Vakf-e-Nau”²

Tani do t’ju tregoj raportin e “Vakf-e-Nau-së”:

Me bekimin e Zotit, sivjet në “Vakf-e-Nau” janë shtuar 1945 fëmijë dhe gjithsej ata janë 39081. Nga këta, djem janë 25013, ndërsa rreth 14000 janë vajza.

“Shoqëria e arkitektëve dhe e inxhinierëve ahmadianë”

“Shoqëria e arkitektëve dhe e inxhinierëve ahmadianë” ka punuar shumë në vendet e Afrikës. Atyre u mundësuan dritat, ujin me sa më pak shpenzime dhe përdorin edhe energjinë diellore.

Në veri të Ganës në 12 vende të ndryshme kanë vendosur sistemin e energjisë diellore, që prodhon drita për xhaminë dhe u mundëson ahmadianëve që të shikojnë MTA-në. Të njëjtën gjë e kanë bërë edhe në 10 vende të ndryshme në Burkina Fasos. Ka shumë vende të tilla ku njerëzit për herë të parë kanë parë dritat dhe njëkohësisht edhe MTA-në. Ju nuk mund ta imagjinoni dot gëzimin e tyre. Kështu kanë bërë në Gambi, Sera Leone, Tanzani, Uganda dhe Kongo, ku në secilin nga këto shtete kanë vendosur mbi 10 vende të ndryshme; p.sh. në Mali 12 vende, në 15 vende në Benin dhe 5 sisteme diellore në Togo. Gjithsej ata kanë vendosur 105 sisteme diellore. Veç kësaj, ata shpërndanë

2 “Vakf-e-Nau” bëhet fjalë për ata fëmijë që sipas praktikës së të ëmës së Hazret Merjemes (nëna e Isait a.s.), prindërit e tyre i kanë dedikuar para lindjes së tyre në rrugën e Allahut.

1500 lente diellore. Inxhinierë të rinj të Xhematit të Anglisë, me bekimin e Zotit po punojnë shumë. Shkojnë nëpër vendet e largëta të Afrikës dhe u sjellin ujë të pijshëm, duke punuar për ditë të tëra në vapë për të hapur pompa. Sivjet ata kanë hapur 165 pompa dhe deri tani gjithsej kanë hapur 357 sosh. 65 prej tyre në Benin, 158 në Burkina Faso, 27 në Ganë, 22 në Gambia, 34 në Mali dhe 51 në Bregun e Fildishtë. Këta inxhinierë po ndihmojnë shumë edhe për projektet e xhamive dhe të shtëpive të misionit të Xhematit atje në Afrikë.

Dëgjoni çfarë ndodhi me ta duke punuar në Benin (në Afrikë). Ata thonë:

“Ne morëm një kamion dhe shkuaam atje e filluam punën tonë duke gërmuar tokën për ujë, por nuk dilte ujë fare. Atje kishte qenë një pompë dhe ne vendosëm ta hiqnim atë dhe të vëmë një të re. Toka ishte kaq e fortë saqë pompa e vjetër nuk nxirrte ujë që prej 15 vitesh. Poshtë kishte ndryshuar krejt ngjyra e dheut. Ne filluam të gërmojmë me kompresor. Zakonisht me anë të tij nga dy - tre orë del patjetër ndonjë rezultat i mirë. Por atje as pas katër orësh nuk pamë gjë. Pas pesë orësh doli baltë po me një erë shumë të keqe. Era e saj ishte vërtet kaq e keqe saqë edhe banorët e fshatit u larguan. Por ne aty ishim duke punuar me vendosmëri se ishim të bindur se Zoti do të na ndihmonte. Pas edhe dy orësh papritur doli një ujë i pastër me furi. Kompresori deri atëherë ishte i ndezur vazhdimisht. Kur pamë ujin ne u gëzuam pa masë. Edhe banorët e fshatit erdhën dhe filluan të festonin nga gëzimi. Të gjithë kërcenin, të vegjël e të mëdhenj.

Ata të gjithë e falënderonin Xhematin me përzemërsi.”

“Në një fshat tjetër kur vendosëm një pompë çdokush ishte i përbotur dhe me gjithë zemër falënderonin Xhematin. Ata ishin aq të gëzuar sa dukej sikur të ishte ndonjë festë. Një plakë tha: Kurdoherë që unë do të pi ujë nga kjo pompë do të lutem për Xhematin Ahmadianë. Kryeplaku i fshatit tha se ai dhe gjithë banorët e fshatit i janë mirënjohës Xhematit dhe Kalifit të tij.”

Ka shumë punë të tilla që ka bërë shoqëria e arkitektëve dhe e inxhinierëve ahmadianë. Organizata humanitare e Xhematit “Humanity First”, (Humanizmi më së pari) gjithashtu ka punuar shumë në këto vende.

Amiri (Kryetari i Xhematit) i Burkina Faso-së thotë se sivjet ata kanë organizuar ngritjen e katër spital - kampeve klinike për ndërhyrje në sy dhe kanë bërë 241 operacione për katarakt dhe gjithsej kanë bërë 1190 operacione falas. Këta të sëmurë, kur fillojnë të shohin sërish, nuk pushojnë së falënderuari. Operacione në sytë janë bërë edhe në Nigeri. Kemi dhënë ndihma financiare jetimëve dhe të varfërve. Xhemati ka shkuar edhe nëpër burgje për të parë gjendjen e të burgosurve dhe i ndihmoi sipas mundësive.

Spitalet dhe Shkollat nën projektin “Nusret Xhehan”

Nën projektin Nusret Xhehan punojnë 36 spitale në 12 vende të Afrikës, në të cilat 38 nga mjekët tanë janë të zënë duke shërbyer. Veç kësaj, në 12 vende kemi 521 shkolla të mesme, nëntë-vjeçare dhe kopshte. Sivjet në Shianda të Keniasë, filloi të funksionoi spitali ynë i ri.

Nën projektin Nusret Xhehan punojnë 36 spitale në 12 vende të Afrikës, në të cilat 38 nga mjekët tanë janë të zënë duke shërbyer. Veç kësaj, në 12 vende kemi 521 shkolla të mesme, nëntë-vjeçare dhe kopshte. Sivjet në Shianda të Keniasë, filloi të funksionoi spitali ynë i ri. Ky spital ka 18 dhoma dhe salla që kanë nga 20 krevate secila. Gjithashtu në Prako sivjet është përruar spitali ynë që ka 60 krevate.

Ky spital ka 18 dhoma dhe salla që kanë nga 20 krevate secila. Gjithashtu në Prako sivjet është përruar spitali ynë që ka 60 krevate. Po bëhen shumë punë të tjera humanitare në vendet Afrikane. Qeveritë dhe njerëzit kanë përshtypje shumë të mira për Xhematin atje dhe të gjithë e falënderojnë

Xhematin.

Tahir Heart Institute (Spitali i Zembrës “Tahir”), Rabvah, Pakistan

Lidhur me këtë spital, dua të bëj thirrje për të gjithë mjekët ahmadianë, sidomos kardiologët, kirurgët dhe ata që bëjnë anestezi, që dëshirojnë të dedikojnë jetën e tyre, të vijnë dhe të shërbejnë në këtë spital. Edhe ata që nuk duan të dedikojnë jetën e tyre, të bëjnë sakrificë e të vijnë

dhe të shërbejnë përkohësisht në këtë spital. Me bekimin e Zotit, Spitali i zemrës "Tahir" po bën një shërbim të jashtëzakonshëm. Ai ka reputacion tek ahmadianët, ashtu si edhe te joahmadianët. Atje kurohen pacientë me shumë pak mundësi shërimi, rezultate këto që i kanë çuditur edhe mjekët e tjerë. Që kur ka filluar ky spital, d.m.th. para 18 muajsh e deri më tani janë vizituar 65 mijë pacientë; 7500 procedura janë bërë, madje 1750 procedura ndërkombëtare; 500 engjoplaste dhe 125 operacione bajpase. Por ka shumë nevojë për mjekë si dhe staf para-medicional. Megjithëse, ajo e dyta disi mund të zëvendësohet duke bërë trajnime të herëpashershme. Por dua t'u bëj një thirrje mjekëve ahmadianë, qoftë atyre që jetojnë në Perëndim, qoftë atyre pakistanezë.

Ata që jetojnë në Perëndim të dedikojnë nga koha e tyre të paktën tre muaj për të shërbyer, ndërsa ata nga Pakistani të dedikojnë të paktën për tre deri në gjashtë vjet. Momentalisht spitali është aq i ngarkuar sa që 14 apo 15 mjekët që shërbejnë aty, edhe në ditët e zakonshme, qëndrojnë në spital nga mëngjesi deri në orën tetë të darkës. Ndërkohë kur vazhdojnë procedurat, ata shërbejnë edhe deri në orën 2 të natës. Është një bekim shumë i madh i Zotit të Lartësuar

që nëpërmjet këtij spitali në Rabvah, Xhemati po bën një shërbim të jashtëzakonshëm humanitar. Kështu që po të vijnë mjekët për të shërbyer këtu, do të fitojnë edhe përvojë në fushën e tyre dhe gjithashtu do të fitojnë pëlqimin e Allahut, i cili duhet të jetë qëllimi i të gjithë mjekëve ahmadianë.

Kontaktet me ahmadianët e rinj

Unë pata thënë para disa vitesh që të krijojmë përsëri kontakte me 70% të atyre ahmadianëve të rinj, të cilët për shkak të mungesës së lidhjes me Xhematin, humbën. Me bekimin e Zotit, sivjet Gana ka përpunuar më shumë duke kontaktuar 51 mijë ahmadianë të rinj. Pasi që kisha bërë këtë thirrje, pra gjatë tetë viteve të mëparshme, Gana ka arritur deri te 818000 ahmadianë të rinj. Edhe Nigeria ka bërë punë të madhe sivjet, duke kontaktuar 95118 ahmadianë të rinj. Në Burkina Faso kanë kontaktuar 16 mijë nga ata. Kështu, ata që kishin humbur, po kthehen përsëri në miliona.

"Bejtet" e reja (Anëtarësimet e reja në Xhemat) dhe disa rrëfime interesante të tyre

Me bekimin e Zotit të Madhërishëm, sivjet 416010 njerëz, nga 111 shtete të botës, janë bërë ahmadianë, ata u përkasin 366 kom-

Me bekimin e Zotit të Madhërishëm, sivjet 416010 njerëz, nga 111 shtete të botës, janë bërë ahmadianë, ata u përkasin 366 kombësive të ndryshme.

bësive të ndryshme. Elhemdulilah, në krahasim me vitin e kaluar, janë më shumë. 145000 janë anëtarësuar në Nigeria; Gana ka bërë 38900 anëtarësime; 76990 në Mali; 26000 janë bërë ahmadianë në Burkina Faso; edhe në Bregun e Fildishtë janë bërë 20047 ahmadianë; 14165 në Benin; 4000 në Ugandë; 2654 në Kenia; 36178 në Sera Leone; 1063 në Etiopia; 2357 janë bërë në Indi.

Zotëri Rafi Ahmadi, misionari i Xhematit në Ugandë, shkruan:

"Një mik nga India e Jugut që ishte nën tablig, kur u bind me argumente rreth vdekjes së Hazret Isait dhe ardhjes së Imam Mahdiut, më tha: "Dua të shikoj ndonjë shenjë të qartë për vërtetësinë e Xhematit." Unë i thashë: "Lutu dhe kërkoji Zotit, Ai do të të ndihmojë." Pas disa ditësh ai u bë gati për t'u bërë ahmadian. Kur e pyeta se pse po bëhesh, ai më tha: "Në ëndërr pashë gjyshin tim, ndjesë pastë. Në tavolinën e tij ishte fotografia e Hazret Mesihut të Premtuar a.s. Pastaj kam parë dhe një ëndërr tjetër. Unë po shkoja në një vend të shkretë. Rrugës më takoi një grua. Unë i kërkoja rrugën që shkon për në xhami. Ajo më mori me vete dhe ne filluam të ecim. Gjatë rrugës kaluam para një xhamie, por ajo nuk hyri brenda. Kaluam edhe pak rrugë ku ishte një xhami tjetër. Atje,

kur po futesha brenda, pashë një tabelë ku ishte shkruar: Xhamia e Xhematit Mysliman Ahmadia." Pas këtyre dy ëndrrave, ai u bë ahmadian.

Misionari i Xhematit në Francë shkruan:

"Nurul Islami, i biri i Izudin Kushtit, që është 13 vjeç sheh në ëndërr se ai doli jashtë shtëpisë dhe pa Hazret Isain duke zbritur nga qielli. Një nur (dritë) e kishte rrethuar. Në mëngjes ai ia tregoi të atit ëndrrën e tij. Babait i shkoi mendja te Xhemati Ahmadia. Ai nisi hulumtimin për Xhematin nëpërmjet internetit. Një ditë, kur ata të dy po shikonin në internet, panë fotografinë e Hazret Mesihut të Premtuar a.s. Djali i i tij brohoriti duke thënë: "Këtë njeri e kisha parë në ëndërr." Pastaj ata të dy janë bërë ahmadianë."

S shumë njerëz bëhen ahmadianë, thjesht duke parë nivelin e moralit të anëtarëve të Xhematit. Përndjekjet që bëhen kundër anëtarëve të Xhematit nga kundërshtarët tanë, gjithashtu bëhen shkak të vendosmërisë në besimin e ahmadianëve të rinj.

Ka shumë ngjarje të tilla që njerëzit janë udhëzuar nëpërmjet ëndrrave.

Zotëri Gogoxhalaso Parenoso shkruan:

"Unë i lutesha Zotit: O Zot, myslimanët janë ndarë në kaq shumë sekte. Ti Vetë më trego cilin sekt ta ndjek? Një herë në ëndërr pashë: Unë shkova në një shtëpi të misionit të Xhematit Ahmadia, ku një njeri i ditur po udhëhiqte namazin. Unë pyeta dikë se kush është ky ▶

person? Njerëzit më thanë se ky është Kalifi i Zotit. Kur dëgjova këtë, edhe unë u bashkova me të në namaz. Pastaj kur u zgjova, menjëherë shkova në qendrën e Xhematit Ahmadian dhe bëra Bejtin.”

Një shtetas zviceran u bë ahmadian duke parë ëndërr. Ai kishte marrë pjesë edhe në konferencën që u bë në vitin 1987, kur Hazret Kalifi i Katërt kishte mbajtur fjalimin e tij të famshëm në Universitetin e Zurichut mbi temën “Revelation Rationality Knowledge and Truth”. Pas kësaj ngjarje, ai shumë herë kishte takuar Hazret Mesihun e Premtuar a.s. në ëndërr. Ai filloi ta studionte Xhematin, por me kalimin e kohës, u shkëput kontakti me Xhematin. Sivjet ky zotëri erdhi në xhaminë tonë dhe tregoi se prapë ai ka parë shumë herë Mesihun e Premtuar a.s. në ëndërr. Ai tha: Mesihu i Premtuar a.s. më thirri mua kaq shumë herë, sa nuk kisha rrugë tjetër veçse të vija në këtë xhami. Unë jam nxënës i tij, e dua shumë atë.” Ai kishte në dorë edhe librat e Mesihut të Premtuar a.s. që ai i kishte shkarkuar nga interneti.

Shumë njerëz bëhen ahmadianë, thjesht duke parë nivelin e moralit të anëtarëve të Xhematit. Përndjekjet që bëhen kundër anëtarëve të Xhematit nga kundërshtarët tanë, gjithashtu bëhen shkak të vendosmërisë në besimin e ahmadianëve të rinj. Ka shumë ngjarje lidhur edhe me këtë. Pastaj kemi shumë ngjarje për plotësimin e lutjeve që tregojnë ndihmën e veçantë prej Zotit.

Amiri (Kryetari) i Xhematit në Kinshasa Kongo shkruan:

Një ahmadian i sapoanëtarësuar, zotëri Isa, ishte nisur një herë për të bërë tablig (përhapjen e mesazhit) rreth Xhematit. Ishte po në atë qytet, por larg nga shtëpia e tij. Ai thotë: Gjatë bisedave nuk ndjeu se kishte kaluar shumë kohë. Ishte ora 9 e natës. Gruaja e tij dhe vajza e tij një vjeçare, gjithashtu ishin bashkë me të. Kur ai u nis për në shtëpi, filloi një shi i rrëmbyeshëm. Kishin marrë një taksì që u prish gjatë rrugës. U detyruan të dilnin jashtë. Nuk kishin as çadër e as ndonjë rrobë të paktën për ta mbuluar vajzën. Shtëpia ende ishte shumë larg. Ai nisi të lutej. Ai thotë: “Sa shumë po lutesha, shiu në vend të pakësohej, po binte akoma me më shumë furi. S’kishim ç’të bënim veçse të ecnim me këmbë. Ora kishte vajtur 11. Nuk kalonte asnjë taksì në rrugë. Në këtë gjendje, pas disa minutash erdhi një makinë nga mbrapa dhe u ndal pranë nesh. Në makinë ishin dy njerëz dhe na pyetën: Ku po shkon në këtë kohë? Futuni brenda! Ne iu bindëm verbërisht. Ata na pyetën vetëm adresën tonë të shtëpisë. Veç kësaj, rrugës kishin ndalur makinën te një ushqimore dhe na thanë: Është ftohtë dhe jeni të lagur. Zbrisni dhe merrni sheqer, çaj dhe gjëra të tjera. Ne prapë iu bindëm dhe u futëm në makinë për të vazhduar më tej. Në një vend tjetër uji po tejkalohte rrugën. Të gjitha makinat ishin ndalur atje. Askush nuk guxonte të kalonte. Por këta njerëz e nganë makinën e tyre edhe atje dhe na sollën deri te shtëpia jonë. Nuk i njoh dhe as ata nuk më treguan emrat e tyre. Dhe mbi të gjitha, në shtëpinë time në të vërtetë nuk kishte as sheqer e as çaj. Vetëm Zoti e di mirë se si e dinin ata për këto gjëra.”

Një ahmadian i ri nga Shqipëria, Markelian Shparthi duke treguar një ëndërr të tij, shkruan:

“Mbas lajmërimit të lëshuar nga ju për thënien e Durudit (t’i dërgosh paqe dhe bekime Profetit Muhammed s.a.v.s.) para se të flemë, unë e kam recituar çdo natë. Dhe si rezultat i kësaj pata një shpërblim shumë të madh. Në një nga netët e fillimit të shkurtit kam qenë i mërzitur nga ana shpirtërore për arsye të shkollës. Më ndodhi diçka që më habiti shumë, por njëkohësisht edhe më gëzoi. Pashë një ëndërr ku unë isha një nga luftëtarët dhe miqtë më të mirë të Profet Muhammedit s.a.v.s. Ajo fillon me një beteje që po zhvillohej në ato momente dhe unë pashë armiq të tanë të largoheshin me kuajt e tyre mbas një kodre. Ne u gëzuam shumë për këtë dhe siç ishim të lodhur, u ulëm në një dhomë, të lyer me të bardha dhe me të kaltër, në një shtëpi. Profeti Muhammed s.a.v.s. më tha që të shkoja në kuzhinë të pyesja nëse ishte bërë gati dreka. Kur vajta në kuzhinë pyeta një grua dhe ajo më tha që dreka nuk ishte bërë ende dhe kishte vetëm makarona. Vajta te dhoma ku ishte ulur Profeti Muhammed s.a.v.s., babai im, një kushëriri im dhe disa njerëz të tjerë rreth një tryeze drejtkëndëshe të gjatë, me dru me ngjyrë të verdhë të hapur. Unë i thash Profetit Muhammed s.a.v.s. që dreka nuk ishte gati dhe kishte vetëm makarona. Ai tha: “Mirë le të hamë ato.”

Unë deri në atë moment ndjehesha në një gjendje shpirtërore shumë të lartë, sikur të kisha një afërsi të madhe dhe një miqësi shumë të mirë me të. Deri tani unë pavarësisht se isha bashkë me të, nuk e kisha parë fytyrën e Profetit Muhammed

s.a.v.s. Dhe kësaj radhe duke e vështruar për një moment pashë fytyrën e Kalifit të Mesihut të Premtuar.”

Ka shumë ngjarje të tjera që tregojnë sesi përfundojnë ata që krijojnë pengesa në rrugën e Xhematit.

Amiri (Kryetari i Xhematit) i Provincës Asam dhe Bangal (Indi) thotë:

“Dijetarët e Indisë kishin bërë një mbledhje kundër nesh ku kishin marrë pjesë rreth 60 mijë njerëz. Ata shpërndanë literaturë kundër Xhematit dhe e shanë atë. Ndërkohë filloi një shi i rrëmbyeshëm me aq furi sa që u rrëzua skena e mbledhjes. Tre persona vdiqën aty për aty, ndërsa dy të tjerë vdiqën gjatë rrugës.”

Amiri i Beninit shkruan:

“Në zonën Dasa njerëzit janë shumë kundër Xhematit. Një njeri, që ishte prijës i atyre hoxhallarëve të cilët ishin kundërshtarë të përbetuar të Xhematit, planifikoi të bënte një mbledhje të të gjithë hoxhallarëve dhe të vendosej se Xhemati Ahmadian duhej të çrrënjosej krejtësisht nga ajo zonë. Kështu që, ai filloi fushatën e tij duke i kërcënuar ahmadianët. Edhe joahmadianët i kërcënonte nëse ata nuk do të merrnin pjesë në atë mbledhje. Ahmadianët e asaj zone ishin shumë të shqetësuar. Ata më kishin shkruar edhe mua për lutje. Vetëm para dy vitesh, shumica e këtyre fshatrave janë bërë ahmadianë. Pastaj të gjithë atje dëshmuuan fuqinë e Zotit, vetëm një ditë para se të bëhej mbledhja. Ai ishte duke qëndruar në buzë të rrugës, ndërkohë erdhi një makinë me shpejtësi, u përplas

me të dhe i vrau këmbën. Për tre muaj ai kishte mbajtur këmbën me allçi. Pas kësaj ngjarjeje edhe mbledhja u anulua. Pastaj edhe joahmadianët thoshin se ai e pësoi për shkak të propagandës së tij kundër Xhematit.”

Zotëri Arshad Mahmudi nga Kirgistani shkruan:

“ParadyvjetegjysmëkurXhematipohaste shumë kundërshtime gjatë regjistrimit të tij, gjithashtu vetë unë kisha frikë se nuk do të merrja vizë për të qëndruar aty. Atëherë pashë

një natë në ëndërr që unë në dorën e majtë kisha kapur, pa asnjë frikë, dy gjarpërinj të vegjël dhe në të djathtë kisha

shishe me ilaç. Në ëndërr më thuhet se nëse të pickojnë gjarpërinjtë, fute gishtin në këtë shishe dhe nuk do të helmohesh nga ata. Nëse prapë nuk të bën mirë, atëherë merri një ilaç tjetër Kalifit të Pestë të Mesihut të Premtuar, se ai ka ilaç për të shëruar helmën e çdo gjarpri. Elhemedulilah, pas kësaj ëndrre, unë u qetësova. Pastaj edhe problemet e vizës u zgjidhën mrekullisht.”

Nga Raxhori (India) shkruan:

“Kundërshtarët tanë vendosën ta rrëzonin xhaminë e Xhematit që po ndërtohej në Raxhori. Në mbledhje kur po diskutonin dhe votonin për këtë, një person që quhet Xhebarr u çua në këmbë dhe tha: “Kur ahmadianët nuk na bëjnë asnjë dëm, atëherë pse duhet ta rrëzojmë xhaminë e tyre?” Me të thënë këtë, shumë

njerëz filluan ta mbështesnin idenë e tij dhe kështu njerëzit u shpërndanë pa vendosur kundër Xhematit.”

NëDiamondHarbour,përsërinëIndi, Xhematin e kundërshtuan ashpër. Ahmadianët e atjeshëm më shkruan edhe mua për lutje. Përgjigjen që u dhashë atyre ishte: “Allahu t’i kthejë mbrapsht planet e armiqve!” Të njëjtën ditë kundërshtarët e Xhematit u zunë me njëri-tjetrin për diçka. Midis tyre u fut një sherr kaq i keq sa që shtatëmbëdhjetë nga ata u



plagosën rëndë dhe u shtruan në spital. Në këtë mënyrë kundërshtimi i tyre mori fund.

Amiri i Xhematit të Liberisë shkruan:

“Vitin e kaluar kishim blerë tokë në një vend të bukur në Kryeqytetin Morovia. Çmimi i asaj toke ishte 50 mijë dollarë amerikanë. Me anë të një avokati kishim bërë procedurën e regjistrimit në mënyrë të suksesshme. Pastaj, vetëm pas disa ditësh, morëm një lajmërim nga gjykata se ai që na kishte shitur tokën, nuk e kishte të drejtën ligjore që ta shiste atë, dhe se pronari i vërtetë e ka hedhur në gjyq. Ne u shqetësua shumë se kishim dhënë një shumë të madhe nga parat e Xhematit. Pastaj mësuam se gjyqtarit, që do të vendoste këtë çështje, pala e kundërt i kishte dhënë një ryshfet të madh.”

Amir Sahibi edhe mua më kishte shkruar për lutje dhe më tregoi gjithë

gjendjen. Sipas fatit të vendosur nga Zoti, gjyqtari u detyrua të largohej nga vendi. Dhe erdhi një gjyqtar tjetër në vend të tij. Një herë, ky i dyti, ishte sëmure dhe erdhi në spitalin e Xhematit për t’u mjekuar. Ai i tha doktorit: “Në tavolinën time kam një dosje të Xhematit tuaj që kam lexuar. Dikush po ju shqetëson qëllimisht. I thoni avokatit që ta ndjekë procesin gjyqësor dhe ta mbarojë deri sa të jem i pranishëm në këtë gjyq.” Jo vetëm kaq, një ditë te Amir Sahibi i Xhematit erdhën edhe disa njerëz të palës kundërshtare që kishin një hall dhe ishin të shqetësuar, ata thanë se duan të tërheqin apelin e tyre. Në këtë mënyrë Zoti i largoi të gjitha pengesat.

Amiri i Xhematit të Burkina Faso-së shkruan:

Në zonën Gjijini, një ahmadian Songalu Turabre ishte larguar pak nga Xhemati. Para disa kohësh, vajza e tij u sëmure kaq shumë sa që pas të gjitha mjekimeve, doktorët i thanë se ajo nuk do të shpëtonte. Atë ditë ai ka qenë shumë i shqetësuar. Ai thotë:

“Një ditë, m’u kujtua se misionari i Xhematit shpesh thotë t’i shkruajmë letër Kalifit të Pestë, sepse lutjet e tij pranohen shpesh. Unë, momentalisht nuk munda t’i dërgoj dot letrën, por iu luta Zotit që të më tregonte ndonjë shenjë që unë të gjeja

kënaqësi për këtë gjë. Ndërkohë më mori gjumi. Në ëndërr pashë Kalifin e Pestë të Mesihut të Premtuar dhe në gjuhën time më tregoi për një bimë ‘Gababale’ e cila gjendet vetëm në zonën tonë. Pastaj ai më tha: “Silli gjethet e saj, zieji ato, laje vajzën me to dhe pastaj jepja lëngun e tyre për të pirë.” Pas kësaj ëndrre të çuditshme unë u zgjova dhe bëra ashtu siç më ishte treguar. Madhështia e Zotit bëri që po atë natë vajza ime të shërohej dhe është shëndosh e mirë deri më sot.”

Bota po vuan nga kriza ekonomike, ndërsa Xhemati Ahmadiania, me bekimin e Zotit të Lartësuar, po përparon gjithnjë e më shumë në sakrificat financiare. Sakrificat financiare që dhanë ahmadianët këtë vit janë vërtetë të pashembullta.

Është një grua në Afrikë që është e krishtere, por dëgjon emisionet tona në radio me shumë qejf. Ajo thotë për Kalifin e Mesihut të Premtuar se ai është rob i Zotit, të cilin e dëgjon Zoti. Djali i saj shtatëmbëdhjetë vjeçar u plagos rëndë në një aksident. Ai u shtrua në Spitalin e qytetit Kidgu. Nëna e tij filloi t’i lutej Zotit duke i thënë që Ai ta

shëronte djalin për hir të Xhematit dhe Kalifatit Ahmadiania. Çuditërisht djali i saj u shërua.

Ka shumë ngjarje të tilla në të cilat edhe të tjerët d.m.th. joahmadianët kanë dëshmuar vërtetësinë e Xhematit dhe Kalifatit Ahmadiania.

Sakrificat financiare

Bota po vuan nga kriza ekonomike, ndërsa Xhemati Ahmadiania, me bekimin e Zotit të Lartësuar, po përparon gjithnjë e më shumë në sakrificat financiare. Sakrificat finan-

ciare që dhanë ahmadianët këtë vit janë vërtetë të pashembullta.

Sistemi i "Vasijetit"³

Në vitin 2004, numri i anëtarëve të Xhematit që kanë hyrë në sistemin

e "Vasijetit" ka qenë 38183 anëtarë. Atë kohë kisha shprehur dëshirën që të bëhen të paktën 100 mijë vasijet-bërës në Xhemat deri në njëqindvjetorin e parë të Kalifatit Ahmadi. Allahu i Lartësuar bëri mirësi dhe tani me bekimin e Tij kemi 105377 vasijet-bërës në Xhemat. Deri tani, me bekimin e

veçantë të Zotit, sistemi i "vasijetit" ka filluar në 98 vende të botës. Më shumë nga vasijet-bërësit janë në Pakistan, pastaj në Gjermani, Indonezi, Kanada dhe në vendin e pestë është Anglia.

Zotëri Xhavid Iqbal Nasir (Javaid Iqbal Nasir), misionari i Xhematit Ahmadi të Kosovës shkruan:

3. Bëhet fjalë për ata që kanë bërë testamentin për hir të Zotit, që të paktën 1/10 e të ardhurave të tyre t'i shkojë Xhematit

"Në Xhematin tonë në Kosovë është një ahmadian që quhet Rexhep Hasani, i cili është vasijet-bërës dhe gjithashtu shërben si sekretar i financave në Xhemat. Ai punonte në një spital, por një kohë të gjatë ishte në kërkim të një pune të re,

por nuk gjepte dot. Ai vendosi të bënte "vasijetin". Ende pa e plotësuar formularin, ai kishte filluar të paguante kontributin e "vasijetit". Pikërisht atëherë ai u punësua në qytetin e tij, madje gjeti një punë që i pëlqente. Ai shpesh e përmend se në të vërtetë ky ishte bekimi i "vasijetit" dhe pranimi i lutjes së Kalifit të Mesihut të Premtuar. Edhe një gjë të veçantë që tregon ai, është fakti se para së të bënte "vasijetin",

kur ai akoma ishte i punësuar në punën e parë, kur shkante të merrte rrogën në bankë, llogaria e tij shpesh ishte gati pa para. Por, pas bërjes së "vasijetit", ai gjithmonë ka para të bërëqetshme në llogarinë e tij."

Pra, kjo është sakrifica që Xhemati po jep, dhe ahmadianët e dinë shumë mirë se vetëm duke bërë sakrifica në rrugën e Zotit dhe duke sjellë një ndryshim thelbësor në qeniet

tona, ne mund të gjejmë afrinë e Zotit dhe mund të përparojmë edhe shpirtërisht dhe materialisht.

Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

"Në librin tim "Berahin-e-Ahmadia" është përmendur kjo profeci: "Ata dëshirojnë të fikin dritën e Allahut me gojët e tyre, por Allahu e përsos dritën e Vet, edhe nëse e urrejnë (këtë gjë) jobsimtarët." Kjo profeci është bërë atëherë kur unë s'kisha asnjë kundërshtar, madje askush nuk dinte as emrin tim. Por sipas këtij paralajmërimi, Zoti më dalloi në të gjithë botën dhe mijëra e mijëra më pranuan. Pastaj filloi një kundërshtim kaq i ashpër saqë, kundërshtarët shkuan në Mekë dhe në Medinë, dhe duke u treguar atyre gënjeshtria rreth meje, lëshuan vendimet se jam "qafir" (jomysliman) dhe në të gjithë botën lajmëruan për "mosbesimin" tim, madje nxorën vendimet për vrasjen time, ata nxitën autoritarë të ndryshëm që të bënin diçka kundër meje,

larguan njerëz të thjeshtë nga unë dhe nga Xhemati im dhe kanë bërë çmos për të më zhdukur mua. Por sipas profecisë së Zotit, të gjithë këta hoxhallarë dhe ndjekësit e tyre, dështuan plotësisht. Mjerisht! Sa të verbër janë kundërshtarët e mi, që nuk e shikojnë madhësinë e këtyre paralajmërimeve se në ç'kohë ishin bërë dhe me çfarë madhësie e me çfarë fuqie janë plotësuar! A është kjo punë e dikujt tjetër përveç Zotit? Nëse është, sillmani ndonjë shembull! Ata nuk mendojnë se nëse kjo do të ishte punë e njeriut, pse do të dështonin ata? Kush është ai që i dështoi ata? Ai Zot që është me mua."

Allahu i Lartësuar na tregoftë gjithmonë përparimin e Xhematit dhe na mundësoftë të sjellim një ndryshim shpirtëror e thelbësor në qeniet tona. Amin

Selam alejkum ve rrahmatullah!

Allahu ^{svt} thotë në Kuranin e Shenjtë:

Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat e jo në gjynahe dhe armiqësi! Frikësojuni Allahut, sepse Ai dënon ashpër.

(El-Maidah 5:3)

Ju jeni populli më i mirë i dalë për hir të njerëzimit.

(Ale-Imran 3:111)

Mos harroni që të bëheni bamirës midis jush! Vërtet Allahu e sheh mirë se çfarë bëni.

(El-Bakarah 2:238)

I Dërguari i Allahut, profet Muhammedi ^{savs} ka thënë:

Pas besimit te Zoti, virtyti më i lartë është mëshira ndaj njerëzve. Shpenzoni për ata që janë në nevojë dhe dijeni se dora që jep është më e ndershme se ajo që kërkon.

Xhemati Mysliman Ahmadia, që përfaqëson mësimet e vërteta dhe parimet e bukura të Islamit, ka qëndruar gjithmonë në krye të përpjekjeve për shërbimet njerëzore. Qoftë ndërtimi i spitaleve, ofrimi i shërbimit shëndetësor apo hapja e shkollave, kolegjeve e institucioneve profesionale për shtresa të ulëta në vende të ndryshme të botës, Xhemati është gjithmonë i pranishëm. Në Afrikë, Xhemati ka shënuar arritje të mëdha në zbatimin e disa projekteve për të sjellë drita dhe ujë të pijshëm në zonat e var-

fra e të pazhvilluara të Afrikës. Me moton universale *“Dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd”*, Xhemati bën përpjekje të veçanta për të përhapur paqen dhe vëllazërinë mbarënjëzore duke përforcuar solidaritetin, barazinë dhe dinjitetin njerëzor midis komuniteteve të ndryshme përtej kufijve gjeografikë, kombëtarë apo fetarë.

Me qëllim për të arritur këtë synim madhështor, përpos përpjekjeve në fusha të ndryshme, xhemati gjithmonë orvatet t’i përkrahë shoqëritë në nevojë sidomos gjatë kohërave të vështira të

HUMANIZMI NË RADHË TË PARË



Humanity First
Organizata humanitare
e Xhematit Mysliman
Ahmadia dhe ndihma e saj
në zonat e përmbytura
të Shkodrës

fatkeqësive natyrore. Për këtë arsye, Xhemati ka themeluar një organizatë humanitare "Humanity First" ("Humanizmi në radhë të parë"). Ashtu siç tregon emri, organizata ofron shërbimet e saj për të zbutur vuajtjet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore apo konfliktet njerëzore, duke përkrahur paqen, mirëkuptimin dhe duke përforcuar aftësinë njerëzore për t'i shërbyer vetes.

Xhemati Mysliman Ahmadi në Shqipëri gjithashtu ka bërë një sërë orvatjesh në këtë drejtim. P.sh. gjatë luftës së Kosovës, kur qindra mijëra shqiptarë u strehuan në Shqipëri, Xhemati, pavarësisht nga mundësitë e kufizuara, ofroi shërbime të shquara mjekësore e humanitare. Xhemati gjithashtu dha një kontribut të konsiderueshëm si ndihmë ndaj njerëzve të prekur nga fatkeqësia në Gërdec në 2008. Në përputhje me mësimet të shkëlqyeshme të Islamit, Xhemati gjithashtu u ka ofruar shërbimet e tij humanitare banorëve të zonave të përmbytura të Shqipërisë Veriore.

Situata në Shkodër ishte e paprecedentë ku ujërat përmbytën fshatra të tëra. Sipas udhëzimeve nga qendra e Humanity First-it në Gjermani, Xhemati kontaktoi me drejtorinë e Emergjencës së Përgjithshme Civile pranë Ministrisë së Brendshme, për të mësuar nevojat urgjente të njerëzve të prekur si dhe me kryetarin e komunitetit të kulteve, të cilët na orientuan se ku mund të jepnim ndihmë.

Pasi që u grumbulluan të dhënat e nevojshme, u përgatitën pako ushqimore për 100 familje. Këto pako ishin përbërë nga vaj gatimi, orizi, sheqeri, makarona, fasulja dhe mielli etj. Misioni i parë me material ndihme u nis për zonën e Shkodrës më 11 janar 2010.

Në Shkodër, pas udhëzimit nga zyra e prefekturës, ky material u shpërnda në fshatin Vukatanë të komunës Gur i Zi. Meqenëse banorët ishin njoftuar përpara, edhe shpërndarja e ndihmës përfundoi në mënyrë normale. Materiali u shpërnda sipas listës së përgatitur nga kryeplaku.

Misioni i dytë u nis për në Shkodër më 16 janar 2010. Këtë herë, Xhemati shpuri ndihmë materiale e përbërë nga 150 batanije për njerëz të evakuar në komunën e Bushatit. Materiali iu dorëzua kryetarit të komunës për fshatrat që ishin prekur veçanërisht nga përmbytjet.

Më 19 janar 2010 dr. A. Shakoor Khan përfaqësuesi i organizatës "Humanity First" të Gjermanisë vizitoi zonën e Shkodrës për të parë nga afër situatën pas përmbytjeve. Gjatë kësaj vizite njëditore z. Khan u takua me z. Arben Qesaraj, drejtorin e Drejtorisë së Emergjencës Civile dhe z. Mehdi, përfaqësuesin e prefekturës së Shkodrës. Atij iu paraqit situata e krijuar nga përmbytjet dhe masat që janë marrë nga organet përkatëse. Dr. Khani ua tregoi projektet e realizuara të organizatës 'Humanity First' në vende të ndryshme të botës. Dr. Khani gjithashtu vizitoi komunën Guri i Zi ku e priti z. Broz Marku, kryetari i komunës.

Në saj të Zotit të Madhërishëm, Xhemati ynë gjithmonë qëndron i gatshëm për të qenë krah njerëzve që vuajnë apo përfshihen në fatkeqësi. Lusim Zotin që mos të ketë asnjëherë fatkeqësi të tilla. Amin.

Gjithashtu, i lutemi Zotit që t'ua lehtësojë njerëzve mundimet e vuajtjet të shkaktuara nga kjo fatkeqësi dhe t'i ndihmojë ata edhe më fuqimisht. Amin.



Shahid Ahmad Butt duke blerë ushqime: vaj, sheqer, fasule, makarona, oriz etj.



Vullnetarë duke shpërndarë ushqime nëpër pako



Banorët e fshatit Vukatanë, ndihmojnë për shkarkimin e materialit ushqimor



Kryeplaku z. Behri Usmani duke shpërndarë pako ushqimore midis familjeve të prekura të fshatit Vukatanë

UDHËTIMI I PARË MË 11 JANAR 2010

U shpërndanë 100 pako ushqimore midis familjeve të prekura nga përmbytjet në fshatin Vukatanë të komunës Gurit të Zi, Shkodër.



Pjesëtarët e grupit të 'Humanity First' bashkë me z. Maxhid Cungu, Prefekt i Shkodrës



Dr. A. S. Aslam Khan me z. Arben Qesaraj, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencës Civile



Nga e djathta: z. Broz Marku, Kryetari i Komunës Gur i Zi, dr. A. S. Aslam Khan & z. Gëzim Sulejmani, jurist i komunës.

UDHËTIMI I DYTË MË 16 JANAR 2010

U shpërndanë 150
batanije për
njerëz të evakuar
në komunën e
Bushatit.



Banorët e Bushatit duke shkarkuar batanijet nga furgoni



Vullnetari i Humanity First, z. Artan Shllaku duke shpërndarë batanijet midis familjeve të Bushatit



Samad Ahmad Ghori me zv/ kryetarin i Komunës së Bushatit

نَحْمَدُهُ وَنُصَلِّي عَلَى رَسُولِهِ الْكَرِيمِ وَعَلَى عِيَالِهِ الْمُسَبِّحِينَ الْمُسْتَغْوِينَ
خدا کے فضل اور رحم کے ساتھ
هوالتناصر



لندن

یارے عزیز شاہد احمدی صاحب مبلغ سلسلہ البانیہ
السلام علیکم ورحمۃ اللہ وبرکاتہ
آپ کا نیک سہارا ہے کہ شمالی البانیہ میں شدید بارش اور بربادی
کا وجہ سے سیلاب کی صورتحال کا سامنا ہے اور دوڑے ہوئے علاقے
Lezha اور Shkodra کے نچلے علاقے اور دیہات بانی
نزد میں آگے ہیں۔ اللہ تعالیٰ فضل فرمائے۔ اللہ جانی نعمات
سے محفوظ رکھے۔

والسلام
خاکسار
ماسرور

7-11239
14.1.10

خليفة المسيح الخامس

Xhemati Mysliman Ahmadia beson fuqimisht në pranimin e lutjeve. Sipas praktikës së anëtarëve të tij, z. Shahid Ahmad Butti, President i Xhematit Mysliman Ahmadia të Shqipërisë më datën 10 janar 2010, i dërgoi një letër Hazret Kalifit të Pestë të Mesihut të Premtuar, *Allahu e ndihmoftë fuqimisht*, që ai t'i lutet Zotit për përmirësimin e situatës alarmante të Shkodrës e të Lezhës. Më poshtë po paraqesim përgjigjen e tij, që i dha Presidentit të Xhematit Ahmadia të Shqipërisë.

*Në emër të Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit
Lavdërojmë Allahun, i dërgojmë salavat të Dërguarit të Tij fisnik,
gjithashtu robit të Tij, Mesihut të Premtuar
Me bekimin e mëshirën e Zotit
Ai është Ndihmëtari*

*Shumë i dashur Shahid Ahmad Butt, Misionar i Xhematit
në Shqipëri*

Es-selamalejkum ve rahmatullah ve barakatuhu

Mora faksin tuaj dhe lexova që një pjesë e veriut të Shqipërisë për shkak të reshjeve të mëdha të shiut e të borës gjendet në situatë përmbytjeje dhe që zonat e ulëta të dy rretheve të mëdha: të Lezhës dhe asaj të Shkodrës janë në ujë. Allahu i Madhërishëm i mëshiroftë. Allahu u mbrojtë nga humbja njerëzore.

Vessalam

Sinqerisht

(Nënshkrimi i Mirza Masroor Ahmadit)

Kalif i Pestë i Mesihut të Premtuar

Shpjegime dhe shkurtime

Ajeti (vargu) "Bismillah ..." (Në emër të Zotit...) që i referohet Kuranit të Shenjtë konsiderohet si ajeti i parë i çdo kapitulli (sure). Në disa tekste, nuk shënohet si ajet i parë, dhe lexuesi duhet të ketë parasysh se ajeti i cituar në revistën Vërtetësia, në tekste të tjera do të gjendet në një ajet më parë sesa numri i cituar.

s.a.v.s.: *Sal-lallahu alejhi ue selam*

(Paqja e bekimi i Allahut qofshin mbi Profetin e shenjtë), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s.

a.s.: *Alehis selam* (Paqja qoftë mbi të), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë Profeti të Allahut xh.sh.

r.a.: *Redi Allahu anhu/anha/anhum* (Allahu qoftë i kënaqur me të), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë sahabi të Profetit të shenjtë s.a.v.s. ose të Mesihut të Premtuar a.s.

r.t.a.: *Rahmatullah alejhe* (Allahu e mëshiroftë), shkruhet e lexohet kur përmenden emrat e muslimanëve të shquar e të devotshëm.

a.b.a.: *Ajjadahullahu t'ala bi nasrihil aziz* (Allahu e ndihmoftë atë me ndihmën e Tij të fuqishme), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i Kalifit të tanishëm të Mesihut të Premtuar a.s.

Të nderuar lexues,

Redaksia e Vërtetësisë do t'ju lutej që në adresën e mëposhtme të shfaqni mendimin tuaj për çështjet që ju interesojnë.
Zoti ju shperbleftë!

 E-mail:	 Post:	 Celularë:
vertetesia@gmail.com	Xhemati Mysliman Ahmadia i Shqipërisë, Autostrada Tiranë- Durrës, Km. 1, Kutia Postare 8176, Tiranë, Shqipëri	Tel: +355(0)682974992, 0692994966, 0672168054, Fax: +355(0)48302523

Shkarkoni revistën në pdf tek: www.alislam.al/vertetesia.html

Faqja web: www.alislam.al

Frekuencat në satelit

Sateliti	Pozicioni	Frekuencat
Hotbird 7A	13' Lindje	10722 MHz
Diametri min. i antenës	Polarizmi	Symbol Rate
1 metër	Horizontal	29900 Mbps
FEC	Video PID	Arabisht
3/4	1004	1604
Anglisht	Frëngjisht	Urdu
1304	1404	1204
Gjermanisht		
	1504	

"Unë do të çoj
mesazhin tënd
deri në
skajet e botës"

(Shpallja Hyjnore
për Mesihun e Premtuar a.s.)

mta

REACHING THE CORNERS OF THE EARTH
Duke arritur skajet e botës



mta

MUSLIM TV AHMADIYYA

Duke transmetuar
mesazhin e paqes,
harmonisë dhe dashurisë
në të gjitha anët e botës



Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit www.mta.tv

Perlat e urtësisë nga fe të ndryshme

“Nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues”.

(Kurani i Shenjët 35:25)

“Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij”.

(Kurani i Shenjët 2:286)

Kurani i Madhërishëm

“Ata që nuk besojnë, veprat e tyre janë si mirazhi në shkretëtirë e të cilin i etshmi e kujton për ujë, por, kur arrin tek ai vend, nuk gjen asgjë, por e gjen Zotin, që ia paguan llogarinë e tij të plotë, se Allahu është i shpejtë në llogari. Ose janë si errësirat në detin e thellë, që mbulohen nga dallgët që ngrihen njëra mbi tjetrën, duke pasur sipër tyre retë: shtresa errësire njëra mbi tjetrën, aq sa kur e nxjerr dorën e vet, njeriu pothuajse nuk e sheh fare atë. Ai, të cilit Allahu nuk i jep dritë, nuk do të gjejë më dritë”. *(En-Nur 24:40-41)*

Dhjata e Vjetër (Bibla)

“Zotit i përket toka dhe të gjitha gjërat që janë mbi të, bota dhe banorët e saj”. *(Psalmet 24:1)*

Shintoizmi

“Qoftë edhe në një gjethe të një peme ose në majë të një fije bari shfaqet vetvetiu Ai Zot mbresëlënës”. *(Urabe-no-Kanekuni)*

Sikizmi

“Bota është një kopsht, Zoti është kopshtari i tij, që i ushqen të gjithë, pa përjashtim”. *(Adi Granth, Majh Ashtpadi I, m. 3)*